

BANKA E SHQIPËRISË

TREGU I KËMBIMIT VALUTOR NË SHQIPËRI 2000

Analizë vrojtimi

Teuta Baleta
Dr. Evelina Çeliku[?]

QERSHOR 2001

[?] Zj. Teuta Baleta është Drejtore e Departamentit të Kërkimeve. Dr. Evelina Çeliku është kryespecialiste në Zyrën e Ekonomisë së Brendshme, Sektori Ekonomisë, Departamenti Kërkimeve.

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga : Banka e Shqipërisë, Sheshi “Skënderbej”, Nr.1, Tiranë.
Tel : 235-542; 222-152; 222-153; 222-156;
Faks : 235 542; 223-558

Për informacione lidhur me këtë publikim, lutemi kontaktoni zj. Adriana Meko,
Zyra e Publikimeve, Departamenti Kërkimeve.
Shtypur në Shtypshkronjën e Bankës së Shqipërisë.
Tirazhi : 800 kopje

RECENSENTË:

1. Klodion Shehu, Nëndrejtor, Departamenti Operacioneve Monetare.
2. Kliti Ceca, Nëndrejtor, Departamenti Teknologjisë dhe Informacionit.

Opinionet e shprehura në këtë analizë vrojtimi janë mendime personale të autorëve dhe jo qëndrime zyrtare të Bankës së Shqipërisë, pavarësisht nga pozicionet e tyre.

Abstrakt

Në Shqipëri zbatohet regjimi i kursit të lirë luhatës të këmbimit. Banka e Shqipërisë shet e blen valutë vetëm për qëllim të reduktimit të lëvizjeve spekulative në treg. Megjithatë, niveli i lartë i importeve dhe ndikimi i konsiderueshëm që ka lëvizja e kursit të këmbimit ndaj ecurisë së inflacionit, rrit interesin për këtë tregues.

Por cilin kurs këmbimi duhet të ndjekim më ngushtësisht, lek/usd apo lek/euro? A janë të dyja këto monedha të rëndësishme dhe në ç'raporte? Cila është monedha e huaj që përdoret më tepër për kursimet? Cila është monedha e huaj që orienton vendimmarrjen?

Këto pyetje janë ngritur nga specialistë të Bankës së Shqipërisë në diskutimet e tyre. Gjetja e përgjigjeve për to u bë mjaft e rëndësishme me daljen e euro-s dhe vendin që ajo pretendon të ketë në tregjet botërore.

Përmbajtja:

Hyrje	11
I. Qëllimi i vrojtimit	11
II. Metodologjia e vrojtimit	12
II.1. Përcaktimi i vëllimit të zgjedhjes, i përbërjes së saj sipas grupeve dhe i shpërndarjes gjeografike	12
II.2. Hartimi i pyetësorëve	15
II.3. Trajnimi i intervistuesve	16
II.4. Vrojtimi pilot	16
II.5. Intervistimi	17
II.1. Kodimi, kontrolli, pastrimi dhe hedhja e të dhënave	17
II.7. Përpunimi dhe analiza e të dhënave	17
Kapitulli I: Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit për bankat	18
I.1. Informacion i përgjithshëm	18
I.2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme"	18
I.3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor"	22
I.4. Pyetjet e rubrikës C " Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë"	26
I.5. Konkluzione	28
Pyetësori për bankat	31
Kapitulli II: Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit për zyrat e këmbimit valutor	35
II.1. Informacion i përgjithshëm	35
II.2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme"	35
II.3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor"	41
II.4. Pyetjet e rubrikës C " Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë"	46
II.5. Konkluzione	49
Pyetësori për zyrat e këmbimit valutor	51
Kapitulli III: Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit për kambistët e lirë	55
III.1. Informacion i përgjithshëm	55
III.2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme"	56
III.3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor"	62
III.4. Pyetjet e rubrikës C " Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë"	68
III.5. Çështje të tjera	71
III.6. Konkluzione	71

Pyetëtori për kambistët	74
Kapitulli IV: Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit për bizneset	79
IV.1. Informacion i përgjithshëm	79
IV.2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme"	79
IV.3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor"	89
IV.4. Pyetjet e rubrikës C " Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë"	95
IV.5. Konkluzione	99
Pyetëtori për bizneset	102
Kapitulli V: Rezultatet e dala nga përpunimi i informacionit të pyetësorit për qytetarët	107
V.1. Informacion i përgjithshëm	107
V.2. Përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e anketës për qytetarët	108
V.3. Çështje të tjera	121
V.4. Konkluzione	121
Pyetëtori për qytetarët	124
Kapitulli VI: Konkluzione dhe probleme	127
VI.1. Gjeografia e transaksioneve	127
VI.2. Qëndrimi ndaj monedhave të huaja	127
VI.3. Preferenca ndaj operatorit për kryerjen e këmbimeve valutore	130
VI.4. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore	131
VI.5. Aktiviteti i zyrave të këmbimit valutor	132
VI.6. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e Bankës së Shqipërisë	132
VI.7. Opinioni mbi euron	134
Tabelat	
TABELA 1: Struktura e zgjedhjes sipas operatorëve të tregut valutor	12
TABELA 2: Struktura e grupit të qytetarëve	14
TABELA 3: Shpërndarja e intervistimeve sipas rretheve për bizneset	15
TABELA 4: Shpërndarja gjeografike e transaksioneve valutore	19
TABELA 5: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore	19
TABELA 6: Shpërndarja e bankave sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore	19
TABELA 7: Shpërndarja e bankave sipas vlerës mesatare të një transaksioni	20
TABELA 8: Vëllimi total mesatar i transaksioneve në njësinë e kohës	21
TABELA 9: Arsyet për zgjedhjen e operatorëve	22
TABELA 10: Shpërndarja e bankave sipas valutave më të qëndrueshme	23
TABELA 11: Shpërndarja sipas valutave orientuese	23
TABELA 12: Arsyet kundër tregut jozyrtar të këmbimeve valutore	24

TABELA 13: Evolucion i raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	24
TABELA 14: Evolucion i vlerësimit të raportit të transaksioneve të zyrave të këmbimit valutor	25
TABELA 15: Evolucion i preferencës për valutat	26
TABELA 16: Shpërndarja gjeografike e transaksioneve valutore	35
TABELA 17: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore	36
TABELA 18: Shpërndarja e zyrave sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore	36
TABELA 19: Shpërndarja e zyrave sipas vlerës mesatare të një transaksioni	37
TABELA 20: Struktura e shpërndarjes së zyrave sipas grupimit për vlerën mesatare të një transaksioni	38
TABELA 21: Vlerat mesatare për një transaksion sipas grupeve	38
TABELA 22: Vëllimi total mesatar i transaksioneve sipas grupeve në usd	39
TABELA 23: Arsyeja për zgjedhjen e operatorëve	41
TABELA 24: Shpërndarja e operatorëve sipas arsyes së zgjedhjes	41
TABELA 25: Shpërndarja e zyrave sipas opinionit për monedhën më të qëndrueshme	42
TABELA 26: Shpërndarja e zyrave për opinionin mbi monedhën orientuese	42
TABELA 27: Arsyet për nevojën e tregut jozyrtar	43
TABELA 28: Evolucion i vlerësimit të raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	44
TABELA 29: Evolucion i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrat e këmbimit valutor	45
TABELA 30: Evolucion i preferencës për valutat	46
TABELA 31: Shpërndarja e kambistëve sipas përvojës në aktivitetin e kambizmit	56
TABELA 32: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore	57
TABELA 33: Shpërndarja e kambistëve sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore	57
TABELA 34: Shpërndarja e kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni	58
TABELA 35: Grupimi i kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni	59
TABELA 36: Vlerat mesatare të një transaksioni	60
TABELA 37: Vëllimi total mesatar i transaksioneve sipas grupeve në usd	60
TABELA 38: Shpërndarja e kambistëve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave	61
TABELA 39: Shpërndarja e preferencave për kursim sipas monedhave	61
TABELA 40: Shpërndarja sipas valutave më të qëndrueshme	63
TABELA 41: Shpërndarja sipas valutave orientuese	64
TABELA 42: Arsyet pro ekzistencës së tregut jozyrtar	64
TABELA 43: Evolucion i raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	66
TABELA 44: Evolucion i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të zyrave të këmbimit valutor	66
TABELA 45: Evolucion i preferencës për valutat	67
TABELA 46: Shpërndarja e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike	80

TABELA 47: Shpërndarja e transaksioneve sipas shteteve	81
TABELA 48: Pësha e aktiviteteve ekonomike sipas çdo shteti	81
TABELA 49: Pësha e çdo shteti sipas aktivitetit	82
TABELA 50: Shkalla e përdorimit të monedhave	82
TABELA 51: Përdorimi i secilës monedhë sipas aktiviteteve ekonomike	83
TABELA 52: Përdorimi i secilës monedhë sipas shteteve	83
TABELA 53: Shpërndarja e bizneseve sipas numrit të transaksioneve	84
TABELA 54: Shpërndarja e bizneseve sipas vlerës mesatare të një transaksioni	85
TABELA 55: Kombinimi i rezultateve për numrin e transaksioneve dhe vlerën e një transaksioni në njësinë e kohës	85
TABELA 56: Shpërndarja e bizneseve sipas transaksioneve dhe vlerës mesatare të një transaksioni	86
TABELA 57: Vëllimi mesatar i një transaksioni për secilin grup transaksionesh	86
TABELA 58: Shkalla e përdorimit të monedhave në kursim	87
TABELA 59: Shpërndarja e aktiviteteve ekonomike sipas secilës monedhë të kursyer	87
TABELA 60: Shpërndarja e bizneseve sipas operatorëve të preferuar	88
TABELA 61: Shpërndarja e bizneseve sipas opinionit mbi monedhën më të qëndrueshme	90
TABELA 62: Shpërndarja e bizneseve sipas monedhës orientuese	91
TABELA 63: Arsyet e preferencës për tregun jozyrtar të këmbimit valutor	92
TABELA 64: Shpërndarja e opinioneve të bizneseve për faktorin që përcakton kursin e këmbimit në tregun jozyrtar të këmbimeve valutore	92
TABELA 65: Evolucion i vlerësimit të raportit të vëllimit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	93
TABELA 66: Evolucion i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrtarët e këmbimit valutor	93
TABELA 67: Evolucion i preferencave për monedhat e huaja	94
TABELA 68: Struktura e përgjigjeve sipas monedhës me të cilën duhet të kryhen shit-blerjet valutore	98
TABELA 69: Shpërndarja e të ardhurave mesatare mujore	108
TABELA 70: Shpërndarja e familjeve sipas grupeve të të ardhurave mesatare mujore	110
TABELA 71: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave mujore	111
TABELA 72: niveli mesatar i kursimit të të ardhurave mesatare mujore	112
TABELA 73: Shpërndarja e të ardhurave në valutë sipas monedhave	113
TABELA 74: Shpërndarja e dërgesave të emigrantëve sipas llojit të monedhave	114
TABELA 75: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të të ardhurave nga emigrantët	115
TABELA 76: Shpërndarja e familjeve sipas të ardhurave mujore dhe atyre nga emigracioni	116
TABELA 77: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave nga emigrantët	116
TABELA 78: Krahësimi i sjelljes së qytetarëve kundrejt nivelit të kursimit të të ardhurave	117
TABELA 79: Shpërndarja e preferencave për kursim sipas monedhave	118
TABELA 80: Shpërndarja e familjeve sipas niveleve të preferencave për	119

depozita bankare	
TABELA 81: Shpërndarja e rasteve sipas arsyes së preferencës për depozita bankare	119
TABELA 82: Shpërndarja e rasteve sipas arsyes së preferencës për operatorët në këmbimet valutore	120
TABELA 83: Evolucion i preferencave për monedhat e huaja	120
TABELA 84: Shpërndarja e transaksioneve sipas shteteve	127
TABELA 85: Shkalla e përdorimit të monedhave me të cilat kryhen transaksionet valutore	128
TABELA 86: Shpërndarja e përgjigjeve sipas monedhave të qëndrueshme dhe orientuese	128
TABELA 87: Evolucion i preferencave për monedhat e huaja	129
TABELA 88: Shpërndarja e përgjigjeve sipas monedhave më të përshtatshme për të kryer shit-blerjet valutore	130
TABELA 89: Evolucion i vëllimit të transaksioneve në tregun jozyrtar në raport me vëllimin e tyre në banka	131
TABELA 90: Evolucion i vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrat e këmbimit valutor	132

Grafikët

GRAFIKU 1: Shpërndarja e bankave sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore	20
GRAFIKU 2: Shpërndarja e bankave sipas vlerës mesatare të një transaksioni	21
GRAFIKU 3: Ecuria e raportit të transaksioneve të tregut jozyrtar me bankat	25
GRAFIKU 4: Ecuria e peshës së zyrave të këmbimit valutor	25
GRAFIKU 5: Shpërndarja e zyrave sipas vlerës mesatare të një transaksioni	37
GRAFIKU 6: Shpërndarja e zyrave sipas vlerës mesatare të një transaksioni me vlerë mesatare deri në 500 usd	38
GRAFIKU 7: Ecuria e raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	44
GRAFIKU 8: Ecuria e transaksioneve për zyrat	45
GRAFIKU 9: Ecuria e preferencës për valutat	46
GRAFIKU 10: Shpërndarja e kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni në usd	59
GRAFIKU 11: Shpërndarja e kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni deri në 10 mijë usd	59
GRAFIKU 12: Ecuria e raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	66
GRAFIKU 13: Ecuria e transaksioneve për zyrat	67
GRAFIKU 14: Ecuria e preferencave për valutat	68
GRAFIKU 15: Ecuria e raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave	93
GRAFIKU 16: Ecuria e transaksioneve për zyrat	94
GRAFIKU 17: Ecuria e preferencave për valutat	95
GRAFIKU 18: Shpërndarja e familjeve sipas të ardhurave mesatare mujore	110
GRAFIKU 19: Shpërndarja e familjeve sipas të ardhurave mesatare mujore deri në 100 mijë lekë	111

GRAFIKU 20: Ecuria e preferencave për valutat	121
---	-----

Box

BOX 1: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për bankat në njësinë e kohës	20
BOX 2: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për zyrat në njësinë e kohës	36
BOX 3: Llogaritja e intervalit të besimit të vëllimit mesatar vjetor të transaksioneve për të gjitha zyrat e këmbimit valutor	39
BOX 4: Përgjithësime	40
BOX 5: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për kambistët në njësinë e kohës	58
BOX 6: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për bizneset në njësinë e kohës	85
BOX 7: "A ndikon baza e konvertimit të lekut me monedhat e huaja në zhvillimin e prodhimit?"	96
BOX 8: Llogaritja e koeficientit mesatar të kursimit të të ardhurave nga emigracioni, për nevoja të rivlerësimit të tij në bilancin e pagesave	117

HYRJE

I. Qëllimi i vrojtimit

Kursi i këmbimit përbën një tregues *çmim të parasë*. Ai është një raport, dy përbërësit e të cilit janë para. Si i tillë ai gjendet dhe njehsohet në universin e tregut të këmbimeve valutore.

Përse përdoret termi univers? Sepse deri diku, në kushtet e vendit tonë, nuk mund të përcaktohet me saktësi ky treg, ai është aq i gjerë, sa krijon përshtypjen e një hapësire pa kufij, për më tepër ai është ende i pamatshëm.

A mund të studiohet kursi i këmbimit brenda këtij universi?

Procesi i studimit të kursit të këmbimit është i vështirë si për shkak të shtrirjes së tregut nga pikëpamja organizative dhe gjeografike, ashtu edhe për shkak të nivelit të ulët të njohjes së strukturimit të brendshëm të tij. Një hap i parë drejt njohjes së këtij universi janë vrojtimit me zgjedhje përfaqësuese. Në përpjekjen e parë tonën, jemi munduar të vjelim opinione nga grupe të ndryshme të tij, lidhur me kursin e këmbimit. Në këtë hapësirë të gjerë, është kursi i këmbimit, ai që konkretizon marrëdhëniet më domethënëse ndërmjet lojtarëve në treg. Themi lojtarë, sepse në fund të fundit kemi të bëjmë me një lojë në përfundim të së cilës do të ketë fitimtarë apo të humbur, përse jo edhe një rezultat të bardhë. Ndërhyrja e rastësisë, mund të rrisë apo të ulë probabilitetin e fitores për njerin apo tjetrin lojtar. A duhet pranuar një lojë e tillë, pa një arbitër që të njohë mirë rregullat e lojës dhe t'i zbatojë po aq mirë ato? A mundet që rastësia të administrohet në maksimum për të mënjanuar kaosin në një lojë e cila zhvillohet jo në një tavolinë shahu (ku dy lojtarë njohin shumë mirë rregullat), por në një pafundësi marrëdhëniesh dhe interesash? Në fakt, ka kohë që roli i arbitrit apo i rregullatorit në këtë lojë të vështirë ndjehet gjithnjë e më shumë. Problemi qëndron në arritjen e një roli sa më efektiv, operativ dhe parashikues. Rregullat dhe ligjet në fuqi, të zbatuara nga Banka e Shqipërisë, e luajnë tashmë këtë rol të vështirë, por jo të paarrtshëm.

Duke patur një rol të rëndësishëm në politikëbërje dhe një regjim *luhatës të lirë*, kursi i këmbimit përbën akoma një pikë të fortë të cilën duhet ta vlerësojmë me shumë kujdes. Mbi ç'bazë vendosen vlerat e tij? Cilat janë monedhat¹ që ndikojnë më fuqishëm vlerat e tij? Këtyre pyetjeve dhe të tjerave do të mundohemi t'u japim përgjigje në analizën e këtij vrojtimi.

¹ Gjatë gjithë analizës nënfishat e euros, janë trajtuar në veçanti. Kjo për faktin se publiku ende nuk është edukuar me kuptimin e vërtetë që ka euro, si një monedhë që përfshin njëkohësisht, markën gjermane, liritën italiane si edhe dhrahminë greke. Mungesa fizike e kësaj monedhe vështirëson perceptimin e saj.

II. Metodologjia e vrojtimit

Metoda e përdorur gjatë vrojtimit ishte intervistimi, me qëllim që të insistohej në marrjen e përgjigjeve sa më të plota dhe të sakta, nga ana e anketuesve.

Vrojtimi përkoi fazat në vijim:

1. përcaktimi i vëllimit të zgjedhjes, i përbërjes së saj sipas grupeve dhe i shpërndarjes gjeografike;
2. hartimi i pyetësorëve;
3. trajnimi i intervistuesve;
4. vrojtimi pilot;
5. intervistimi;
6. kodimi, kontrolli, pastrimi dhe hedhja e të dhënave;
7. përpunimi dhe analiza e të dhënave.

II. 1. Përcaktimi i vëllimit të zgjedhjes, i përbërjes së saj sipas grupeve dhe i shpërndarjes gjeografike.

Vrojtimi, u organizua i gjerë si në vëllim ashtu edhe në shtrirje gjeografike. Vetë vëllimi i tij përmbante grupe të ndryshme operatorësh të tregut, tashmë të pranishëm dhe aktivë në tregun valutor. Për më tepër që pa këto grupe nuk mund të kuptohet edhe vetë aktiviteti i këtij tregu. Në total u përgatitën për intervistim 334 anketa. U tërhoqën opinione dhe mendime nga grupi i:

- bankave;
- zyrave të këmbimit valutor (ZKV);
- kambistëve të lirë;
- bizneseve më të mëdha dhe të mëdha;
- qytetarëve apo individëve.

Tabela 1: Struktura e zgjedhjes sipas operatorëve të tregut valutor.

Grupi	Numri i anketave	Struktura (në %)
Banka	13	3.9
ZKV	21	6.3
Biznese	150	44.9
Kambistë	50	15.0
Individë	100	29.9
Totali	334	100.0

Në këtë zgjedhje u krye një vrojtim i përgjithshëm për **grupin e bankave dhe atë të zyrave të këmbimit valutor.**

Për grupet e tjera u krye një vrojtim me zgjedhje, e cila u synua të ishte sa më përfaqësuese.

Në grupin e bizneseve u synua intervistimi jo vetëm i bizneseve më të mëdha (100 prej tyre), por edhe i një pjese të bizneseve të mëdha². Ato u zgjodhën nga baza e të dhënave ekzistuese që disponon INSTAT, nga specialistë dhe metodologjistë të po këtij instituti.

Një operator shumë i rëndësishëm, që vepron në tregun valutator tek ne është edhe **grupi i kambistëve të lirë**. Ata përfaqësojnë tregun valutator jozyrtar, i cili për nga pesha konsiderohet të kryejë një aktivitet të lartë. Ndërkohë që kursi i këmbimit, është realisht elementi “jetëdhënës” i veprimtarisë së këtij operatori. Rezultatet e tij mund të konsiderohen si vlerësime paraprake rreth tregut jozyrtar valutator, i cili është ende i paeksploruar, si nga pikëpamja e volumit dhe e peshës, që ai zë në totalin e tregut valutator ashtu edhe nga pikëpamja e veprimtarisë dhe e cilësisë së organizimit të këtij tregu. Kështu çdo studim i ri, me informacione rreth tij, do të paraqiste mjaft interes.

Për këto arsye dhe për të patur një përfaqësueshmëri reale në vrojtim, ky grup zuri një vend të konsiderueshëm në strukturën e zgjedhjes.

Grupi i qytetarëve apo i individëve ishte gjithashtu objekt i këtij vrojtimi. Duke e trajtuar këtë grup si një operator të rëndësishëm në treg, mendimet dhe opinionet e tij, u tërhoqën nga 100 persona. Kjo zgjedhje konsiderohet e mjaftueshme për vjelje opinionesh, për më tepër që për probleme më teknike, pyetësi për individët u konceptua më i thjeshtë.

Individët u përzgjedhën nga baza e të dhënave të anketës së Nivelit të Jetesës pranë familjeve dhe metodologjia e saj u hartua dhe u realizua nga njësi përkatese, pranë INSTAT. U synua që zgjedhja të ishte sa më përfaqësuese dhe në të, të merrnin pjesë të gjitha llojet e familjeve sipas dy tipareve kryesore të cilat karakterizojnë kryesisht situatën ekonomiko-sociale të tyre:

- madhësisë (numrit të pjesëtarëve në familje);
- shkallës së punësimit.

Pra, nuk u synua intervistimi i grupeve të veçanta, sepse ai do të shkaktonte marrjen e një informacioni tepër asimetrik (nëse do të zgjidheshin vetëm familje të vogla me nivel punësimi të lartë, atëherë do të kishte një mbivlerësim të të gjitha të dhënave, krahasuar me nivelin mesatar). Për të shmangur problemin e asimetrisë së informacionit u intervistuan grupe të ndryshme, me pesha të përcaktuara nga metodologjistët e INSTAT-it. Gjatë përpunimit kjo përzgjedhje mundëson ruajtjen e një niveli mesatar më domethënës, pra konkluzione më të bazuara. Gjatë intervistimit u përgjigjën kryefamiljarët.

² Sipas klasifikimit të zyrës së tatimeve.

Tabela 2: Struktura e grupit të qytetarëve.

Treguesi	Struktura (në %)
Pensionistë	20
Të papunë	20
Me të ardhura nga aktivitet privat	40
Me të ardhura buxhetore	20
Totali	100

II. 1. 1. Shtirja gjeografike e vrojtimit.

Vrojtimi mbi grupin e bankave, të zyrave të këmbimit valutor, të kambistëve dhe të qytetarëve u krye vetëm në qytetin e Tiranës.

Arsyeja për një shtrirje të tillë gjeografike për grupin e bankave dhe të zyrave të këmbimit valutor, lidhet me faktin se këto dy grupe operatorësh, që në fakt përbëjnë tregun zyrtar të këmbimeve valutore, kryejnë aktivitetin më të madh valutor në Tiranë. Ndërkohë që vetë qendra e administrimit të tyre ndodhet në kryeqytet.

Të dy grupet, ai i kambistëve dhe ai i qytetarëve, u përzgjedhën në Tiranë për dy arsye kryesore:

së pari, sepse qëllimi i vrojtimit lidhet kryesisht me vjeljen dhe përpunimin e opinionëve për sjelljen e operatorëve përballë kursit të këmbimit dhe monedhave kryesore që ndikojnë vlerat e tij. Shpërndarja gjeografike nuk gjykohet të zbulojë aspekte të spikatura të këtyre opinionëve;

së dyti, preferenca për Tiranën krijon thjeshtësi veprimi në procesin e intervistimit, gjithmonë, duke patur parasysh se një zgjedhje e tillë nuk çënon qëllimin e vrojtimit;

Nëse do të gjykonim për përparësitë e veçanta që paraqesin këta operatorë (kambistët dhe qytetarët) që zhvillojnë aktivitetin e tyre në kryeqytet do të theksonim këto tipare dalluese:

Për aktivitetin e kambizmit, apo tregun jozyrtar të këmbimeve valutore, nga konsiderata paraprake, vlerësohet të jetë më i organizuar dhe më i përqëndruar në Tiranë. Si i tillë, opinionet e këtij operatori për problemet e ngritura në pyetësorin përkatës, vlerësohet të jenë më të qënësishme dhe më të bazuara. Ndërkohë që ky operator vihet për herë të parë përballë një pyetësores të tillë, duke i shërbyer në të ardhmen, organizimit të studimeve dhe analizave më të detajuara të tregut jozyrtar.

Për qytetarët, meqenëse u përcaktua që ata do të zgjidheshin nga baza e të dhënave të anketës së “Nivelet të Jetesës”, e cila është realizuar vetëm për zonat urbane, edhe vërtetimi do të tërhiqte opinione nga kjo pjesë e popullsisë, pra nga popullsia qytetare.

Për grupin e bizneseve, u synua që zgjedhja të kishte një gjeografi edhe më të gjerë. Bizneset u përzgjedhën në rrethet: Durrës, Fier dhe Korçë, nisur nga fakti që, një pjesë e bizneseve të mëdha zhvillojnë aktivitetin e tyre në rrethet e lartpërmendur. Në përcaktimin e kësaj gjeografie, shërbyen edhe informacionet e marra, nga specialistë, pranë INSTAT.

Tabela 3: Shpërndarja e intervistimeve sipas rretheve për bizneset.

Rrethet	Numri i intervistave*	Struktura (në %)
Tiranë	100	66.7
Durrës	30	20.0
Fier	10	6.65
Korçë	10	6.65
Totali	150	100.0

* Shënim: Totali i bizneseve të intervistuar u parashikua 150. Në fakt, 12 të tilla refuzuan të përgjigjen.

II.2. Hartimi i pyetësorëve³

Vjelja e informacionit u konceptua të arrihej nga intervistat, që u mundësuan nga pyetësorë të veçantë për operatorë të veçantë. Në përgjithësi, të gjithë pyetësorët u konceptuan në tre rubrika kryesore⁴:

- A. Informacione të përgjithshme;
- B. Opinione për organizimin e tregut valutor;
- C. Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë;

Në këtë mënyrë, qëllimi për të cilin u organizua vërtetimi, do të realizohej kryesisht nga të dhënat e pjesës së dytë dhe të tretë. Megjithatë, çdo pyetësor përmban edhe pyetje specifike sipas operatorit që i drejtohet.

Pyetjet u ndërtuan të drejtpërdrejta dhe të thjeshta. Në këtë mënyrë ato sigurojnë një shkallë më të lartë përgjigjesh, një cilësi më të lartë të dhënash (gabime më të vogla) dhe punë më eficiente gjatë intervistimit. Pra rritet mundësia për një informacion më real.

Në të shumtën e rasteve ato janë cilësore. Në një numër të kufizuar rastesh ato janë sasiore. Në rastet e pyetjeve që kërkonin përgjigje sasiore apo cilësore u paraqitën alternativat e mundshme në një seri të rradhitur të dhënash, ku u kërkuar zgjedhja apo zgjedhjet e mundshme.

³ Në fund të secilit kapitull gjendet pyetësori përkatës i çdo grupi.

⁴ Pyetësori për qytetarët nuk e ka pjesën e tretë.

Një kategori tjetër pyetjesh në pyetësorë, është edhe dhënia e arsyeve për zgjedhjet e mundshme të kryera nga të intervistuarit apo e gjykimeve për probleme të ndryshme. Kjo kategori pyetjesh është konsideruar shumë e rëndësishme për të plotësuar opinionet e të intervistuarve. Për këtë arsye, gjatë fazës së trajnimit të intervistuesve u theksua insistimi i tyre në marrjen e përgjigjeve sa më të plota.

Gjatë hartimit të pyetësorëve specialistët e Bankës së Shqipërisë bashkëpunuan edhe me specialistë të INSTAT.

II. 3. Trajnimi i intervistuesve.

Trajnimi i intervistuesve u realizua kryesisht nga INSTAT. Për t'i shërbyer sa më mirë qëllimit të marrjes së një informacioni të padeformuar, në këtë fazë mori pjesë edhe grupi organizues i këtij vrojtimi nga Departamenti i Kërkimeve në Bankën e Shqipërisë. U zhvilluan takime për sqarimin e problemeve teknike që pyetësi kërkonte të zgjidhte, si edhe çështje të terminologjisë për të cilat vetë anketuesit duhet të ishin të qartë. Mund të rradhisim disa prej tyre:

- kuptimi i termit transaksion;
- kuptimi i vlerës mesatare të një transaksioni në njësinë e kohës në dollarë amerikanë;
- shpjegimi i regjimit aktual të kursit të këmbimit tek ne etj..

U kërkua që të insistohet në marrjen e përgjigjeve sa më të plota.

Për probleme që mund të lindnin në hapat e parë të plotësimit të tij, u kërkua sinjalizimi i menjëhershëm për të reflektuar në kohë.

II. 4. Vrojtimi pilot.

Kjo fazë u konsiderua shumë delikate, për shkak të mungesës së një vrojtimi paraprak për kursin e këmbimit. Ajo synoi në testimin e pyetësorëve dhe në reflektimin e problemeve, që do të dilnin prej tyre gjatë fazës së intervistës, të përpunimit dhe analizës së të dhënave.

Kjo fazë u realizua nga specialistë të Departamentit të Kërkimeve. Vëllimi prej 20 pyetësorësh të shpërndarë sipas operatorëve që veprojnë në tregun valutor (5 kambistë, 10 qytetarë, 1 bankë, 1 ZKV, 3 biznese), shërbeu si testim për gjithë fazat e vrojtimit në vijim. U reflektuan probleme që lidheshin si me formën ashtu edhe me përmbajtjen e pyetësorëve, me synim thjeshtimin e tyre.

Disa prej problemeve mbi të cilat u reflektua rradhiten më poshtë:

- pakësimi i kategorisë së pyetjeve që kërkonin dhënie arsyesh apo shpjegimesh;
- përcaktimi dhe saktësimi i intervaleve numerike për numrin e transaksioneve të kryera nga operatorët;

- përcaktimi, për operatorë të ndryshëm, i njësive kohore të ndryshme, në varësi të aktivitetit të tyre;
- dhënia e vlerës së transaksionit mesatar në një valutë të vetme, në dollarë amerikanë;
- thjeshtimi i pyetësorëve për qytetarët;
- thjeshtimi i pyetjeve;
- dhënia e të gjitha alternativave të mundshme për zgjedhje etj..

II. 5. Intervistimi.

Kjo fazë u realizua nga anketues të INSTAT-it, gjatë periudhës kohore 15 dhjetor 2000 – 15 janar 2001. Qëllimi i kësaj faze ishte grumbullimi i informacionit maksimal dhe niveli sa më i lartë i përgjigjeve si nga ana sasiore (nivel i ulët i jopërgjigjeve) ashtu edhe nga ana cilësore (përgjigje të kuptimta dhe harmonike përgjatë pyetjeve dhe rubrikave të pyetësorëve). Parimi i ruajtjes së konfidencialitetit të informacionit u mbajt parasysht gjatë gjithë fazave të vrojtimit, por në veçanti në fazën e intervistimit.

II. 6. Kodimi, kontrolli, pastrimi dhe hedhja e të dhënave.

Pyetësorët u pastraun dhe u rregulluan për të ulur numrin e pyetjeve dhe të pyetësorëve të papërpunueshëm. Hedhja e të dhënave u krye në mënyrë sistematike sipas grupeve të intervistuar.

II. 7. Përpunimi dhe analiza e të dhënave.

Në këtë fazë, secili grup u analizua fillimisht më vete. Përpunimi u krye në mënyrë sistematike për secilën rubrikë dhe pyetje të pyetësorëve. Në këtë pjesë nuk mungojnë edhe kombinimet e informacioneve brenda grupit apo operatorit. Në përfundim të përpunimit të secilit pyetësor (për secilin grup të intervistuar) janë nxjerrë konkluzionet, që nënvizojnë aspektet më të spikatura të analizës lidhur me qëllimin kryesor të vrojtimit.

Një kombinim final i të gjitha informacioneve për të gjithë operatorët e tregut valutës (grupet), ka nënvizuar konkluzionet kryesore të analizës së këtij vrojtimi. Gjithashtu, në këtë pjesë të analizës janë evidentuar problemet dhe propozimet për të ardhmen.

KAPITULLI I: REZULTATET E DALA NGA PËRPUNIMI I INFORMACIONIT TË PYETËSORIT PËR BANKAT

I. 1. Informacion i përgjithshëm.

Në procesin e vrojtimit u zgjodhën për intervistim të gjitha bankat që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri, 13. Intervistave iu përgjigjën 12 prej tyre ose 92.3 për qind e tyre. Personat e intervistuar janë punonjës pranë njësive që merren me aktivitetin e këmbimit valutor në këto banka. Kjo kërkesë synonte vjeljen e informacioneve sa më të sakta dhe me nivel të lartë profesional.

Niveli i përgjigjeve konsiderohet shumë i mirë. Madje po kaq i lartë është niveli i përgjigjeve edhe për pyetje të veçanta. Në pyetjet ku janë të renditura variantet e përgjigjeve vërehet që ky tregues është po 92.3 për qind. Përsa i përket pyetjeve të lira niveli më i ulët i përgjigjeve është rreth 67 për qind, pra përsëri mjaft i kënaqshëm. Në përgjithësi kemi një rritje të dukshme në shkallën e përgjigjeve nga sistemi bankar krahasuar me vitin 1999, vit në të cilin vrojtimit të kryer iu përgjigjën vetëm 54.5 për qind e bankave⁵. Ky nivel i lartë përgjigjeje siguron edhe arritjen e konkluzioneve të vlefshme. Po ashtu, siç do të trajtohet më poshtë, në përgjithësi përgjigjet janë dhënë në harmoni me njëra-tjetrën dhe në mënyrë të logjikshme.

I. 2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme".

Rubrika A përbëhet nga 6 pyetje dhe synon të marrë informacion të përgjithshëm mbi monedhën/monedhat me të cilën/cilat kryhen transaksionet, vlerësime sasiore mbi numrin e transaksioneve dhe vlerën mesatare të transaksioneve si dhe operatorin/operatorët më të preferuar për të kryer veprime.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së parë ka rezultuar:

Pyetja 1, ka për qëllim të identifikojë shtetin, me të cilin kryhen më shpesh transaksionet valutore të bankave. Për këtë arsye, pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton që **vendi me të cilin kryhen më shpesh transaksionet valutore është Italia**. Për këtë shtet japin përgjigje 6 nga 12 bankat e pyetura. Vendi i dytë në renditje është Greqia për të cilin përgjigjen 5 banka. Në përputhje me pritshmërinë është fakti që asnjë nga bankat me kapital grek nuk deklaroi të kryejë transaksione valutore me Italinë.

⁵ Shih Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vrojtimi) botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 34.

Tabela 4: Shpërndarja gjeografike e transaksioneve valutore.

Shteti	Përgjigjet (në %)*
Italia	50.0
Greqia	41.7
Turqia	0.0
Gjermania	16.7
Bullgaria	8.3
Maqedonia	0.0
Të tjerë**	16.7

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

**Ndërsa për shtete të tjera janë përgjigjur dy banka dhe në të dy rastet identifikohet Austria.

Pyetja 2, ka për qëllim të identifikojë valutën me të cilën operohet më shpesh nga bankat. Për këtë arsye edhe pyetja 2 lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton që **më shpesh transaksionet kryhen në dy valuta: në dollarë amerikanë dhe në lireta italiane**. Për secilën nga këto valuta japin përgjigje 6 nga 12 bankat e pyetura.

Tabela 5: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	50.0
Lireta italiane	50.0
Marka gjermane	16.7
Dhrahmia greke	33.3
Të tjera	0.0

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.


Pyetja 3, është një pyetje që kërkon të marrë informacion sasior mbi numrin mesatar në një ditë të transaksioneve të kryera nga secila bankë. Ofrohen për përgjigje gjashtë alternativa, por lejohet zgjedhja vetëm e njerës. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur një numër mesatar të transaksioneve valutore të kryera nga sistemi bankar në një njësi të caktuar kohe.

Tabela 6: Shpërndarja e bankave sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	Frekuenca kumulative rritëse
Deri në 10	0.0	0.0
10-20	33.3	33.3
20-30	16.7	50.0
30-40	25.0	75.0
40-50	8.3	83.3
Mbi 50	16.7	100.0
Totali	100.0	

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12.

Nga përgjigjet rezulton se **më shpesh kryhen 10-20 transaksione në ditë**. Megjithatë, rreth 75 për qind e bankave kryejnë mesatarisht në një ditë deri në 40 transaksione ndërsa gjysma e tyre deri në 30.



Box 1: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për bankat në njësinë e kohës.

I. Në një ditë numri mesatar i transaksioneve është rreth 34.

II. Në një muaj numri mesatar i transaksioneve është rreth 752 (numri i ditëve të punës në një muaj është marrë 22).

III. Në një vit numri mesatar i transaksioneve është rreth 9023 (numri i ditëve të punës në një vit është marrë 264).


Pyetja 4, si edhe pyetja 3 kërkon të marrë informacion sasior mbi vlerën mesatare të një transaksioni të shprehur në dollarë amerikanë. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur vlerën mesatare të një transaksioni valutor të sistemit bankar. Vlerat e dhëna nga bankat variojnë në intervalin 30 - 55 mijë dollarë amerikanë për një transaksion.

Tabela 7: Shpërndarja e bankave sipas vlerës mesatare të një transaksioni.

Dollarë amerikane	Përgjigjet (në %)*
30 000	16.7
35 000	8.3
40 000	0.0
45 000	25.0
50 000	41.7
55 000	8.3
Totali	100.0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12.

Vërehet që **gati gjysma e bankave kryejnë transaksione me vlerë mesatare 50 mijë dollarë amerikanë**. Ndërsa 66.7 për qind e bankave kryejnë transaksione me vlerë nga 45 deri në 50 mijë dollarë amerikanë.



Për të llogaritur vlerën mesatare të një transaksioni për të gjitha bankat në një ditë përdoret mesatarja e ponderuar. Kjo llogaritet duke ponderuar çdo vlerë të transaksionit me rastet (në përqindje) e përgjigjeve në secilën prej tyre. Nga llogaritjet rezulton që **vlera mesatare për një transaksion është 44 580 dollarë amerikanë**.

Për nevoja të analizës dhe të kuptimit që marrin transaksionet e kryera në shuma të caktuara, është bërë një rigrupim i të dhënave të tabelës më sipër. Vlerat grupohen në dy intervale: deri në 50 mijë dhe mbi 50 mijë dollarë. Nga ky grupim rezulton që shifra 50 mijë dollarë merr vlerën e medianës për shkak se ndan përgjigjet në dy pjesë të barabarta. E thënë me fjalë të tjera, gjysma e bankave (50 për qind) kryen transaksione me vlerë deri në 50 mijë dhe gjysma tjetër mbi këtë vlerë. Vërehet që vlera mesatare e llogaritur për një transaksion nga vlera mediane ndryshon me rreth 5 mijë dollarë amerikanë.

Kombinimi i rezultateve të përgjigjeve të dhëna për pyetjet 3 dhe 4 siguron një informacion rreth vëllimit total të transaksioneve që kryen sistemi bankar në njësinë e kohës, si më poshtë.

Tabela 8: Vëllimi total mesatar i transaksioneve në njësinë e kohës.

Treguesi	Në ditë	Në muaj	Në vit
Në milionë dollarë amerikanë	1.5	33.5	402.2

Vërehet që sipas deklarimeve, për një vit sistemi bankar shqiptar realizon një volum transaksionesh valutore prej afër 402 milionë dollarë amerikanë.

Pyetja 5, kërkon të zbulojë se cili/cilët operator/operatorë preferohen për të kryer veprimtari valutore. Nga përgjigjet rezulton që 16.7 për qind e bankave punojnë me banka, 25 për qind me zyra këmbimi valutor dhe pjesa që mbetet (58.3 për qind) i kombinonjë operatorët. Në përgjithësi kombinimi është bankë dhe zyra këmbimi valutor. Në asnjë rast bankat nuk janë përgjigjur se veprojnë me tregun jozyrtar. Megjithatë, vlerësohet që një pjesë e këtij aktiviteti mund të zhvillohet edhe me këtë treg, pasi mund të jetë i nënkuptuar në alternativën "kombinohen operatorët".

Pyetja 6, kërkon të dijë arsyet që çojnë bankat në kryerjen e transaksioneve me operatorët e tyre të preferuar. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 9 banka (75 për qind e të pyeturve) dhe në 100 për qind të rasteve del si arsye "siguria që ofron operatori". Pra, **kushti i parë në zgjedhjen e një operatori për një bankë është "siguria"**. Ndërsa për rastet kur preferohet kryerja e transaksioneve me zyra këmbimi valutor veprimi arsyetohet me ofrimin e një kursi më të favorshëm.

Tabela 9: Arsyet për zgjedhjen e operatorëve.

Arsyja	Numri i përgjigjeve (raste)*
Siguri më e lartë	9
Kurs i favorshëm	2

Shënim: * Në disa raste janë dhënë më shumë se një arsye.

I. 3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor".

Rubrika B përbëhet nga 9 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi organizimin e tregut valutor në vend, si është ecuria e tij dhe si kanë ndryshuar raportet në rëndësinë që kanë operatorë apo valuta të ndryshme në këtë treg në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999. Kjo rubrikë përmban dhe dy pyetjet thelbësore që në fakt përbëjnë dhe qëllimin e vrojtimit (pyetjet 7 dhe 8) që kanë të bëjnë me identifikimin e monedhës më të qëndrueshme⁶ dhe të monedhës orientuese për vendimet ekonomike të bankave.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së dytë ka rezultuar:

Pyetja 7, kërkon që bankat të identifikojnë monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Ofrohen pesë alternativa domethënë monedha dhe lejohet zgjedhja e më shumë se një prej tyre.

⁶ Për qëllime të këtij vrojtimi me termin "monedhë e qëndrueshme" nënkuptohet "monedhë e fortë" dhe jo monedhë me më pak luhajtje.

Tabela 10: Shpërndarja e bankave sipas valutave më të qëndrueshme.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	100.0
Lireta italiane	0.0
Marka gjermane	0.0
Dhrahmia greke	8.3
Të tjera	0.0

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Përgjigjet e bankave paraqesin një opinion mjaft të konsoliduar. **Të 12 bankat konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën më të qëndrueshme.**

Pyetja 8, kërkon që bankat të identifikojnë monedhën orientuese për të marrë vendime. Ofrohen po pesë alternativa, domethënë monedha, dhe lejohet zgjedhja e më shumë se një prej tyre.

Tabela 11: Shpërndarja sipas valutave orientuese.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	100.0
Lireta italiane	8.3
Marka gjermane	0.0
Dhrahmia greke	0.0
Të tjera	0.0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e bankave të përgjigjura, 12. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Përgjigjet e bankave përsëri paraqesin një opinion mjaft të konsoliduar. **Të 12 bankat konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën orientuese për vendimmarrjen e tyre.** Ky konkluzion është në harmoni me atë të pyetjes 7. Dollari konsiderohet monedhë e qëndrueshme dhe si i tillë ofron dhe monedhën orientuese për vendimet që marrin bankat në zhvillimin e aktivitetit të tyre valutë. Kjo i ndihmon për të marrë vendime të suksesshme dhe për të shmangur rreziqet.

Pyetja 9 dhe katër pyetjet vijuese, përqendrohen në marrjen e informacionit mbi tregun jozyrtar të këmbimeve valutore. Pyetja është e thjeshtë dhe kërkon të dijë nga bankat nëse e konsiderojnë, për kushtet e Shqipërisë, ekzistencën e tregut jozyrtar të këmbimeve valutore të nevojshëm apo jo. **Shumica e bankave (75 për qind e tyre) e konsiderojnë tregun të panevojshëm**, ndërsa pjesa tjetër (25 për qind) e konsiderojnë të nevojshëm. Ky rezultat, krijon idenë se është i drejtë komenti i bërë në pyetjen 5 dhe ndoshta një pjesë e bankave veprojnë me tregun jozyrtar.

Pyetja 10, kërkon të dijë arsyet për përgjigjet e dhëna nga bankat në pyetjen më sipër dhe i janë përgjigjur 11 banka.

Bankat që shprehen se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore nuk është i nevojshëm japin këto arsye:

Tabela 12: Arsytet kundër tregut jozyrtar të këmbimeve valutore.

Arsyeja	Numri i përgjigjeve (raste)
Jep informacion të gabuar mbi lëvizjen e parasë	4
Është treg i pasigurt	2
Pengon zhvillimin e tregut ndërbankar dhe të ushtrimit të rolit të bankës qendrore	2

Bankat që shprehen se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore është i nevojshëm e arsyetojnë me faktin e të qenurit treg i organizuar mirë.


Pyetja 11, kërkon të dijë mbi ç'bazë përcaktohet kursi i këmbimit në tregun jozyrtar sipas opinionit të bankave. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 10 banka dhe **të gjitha shprehen se kursi përcaktohet në bazë të kërkesës dhe të ofertës për valutë**. Kjo do të thotë që tregu jozyrtar nuk i referohet kurseve të përcaktuara në tregun zyrtar (banka qendrore, bankat tregtare apo zyrat e këmbimit valutore).

Pyetja 12 dhe 13 janë identike. Ato kërkojnë të dinë raportin e vëllimit të transaksioneve që kryhen në tregun jozyrtar me atë të bankave për vitet 1999 dhe 2000. Analizimi i këtyre dy pyetjeve siguron edhe vlerësimin e zhvillimit të këtyre dy tregjeve.

Tabela 13: Evolucionin e raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Më i madh	8.3	33.3
Më i vogël	50.0	33.3
Nuk ka ndryshuar	25.0	16.7
Nuk e di	16.7	16.7

Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë se **situata, sipas opinionit të bankave, është përkeqësuar**. Rezulton që, nëse në vitin 1999 rreth gjysma e bankave mendojnë se vëllimi i transaksioneve të kryera në tregun joformal është më i vogël se në tregun bankar, në vitin 2000 ky tregues reduktohet me 16.7 pikë përqindjeje duke rritur me 25 pikë përqindjeje numrin e bankave që mendojnë se është më i madh.




Pyetja 14, është e ngjashme me pyetjet 12 dhe 13, pasi kërkon të dijë si është ecuria e vëllimit të transaksioneve që kryhen nga zyrat e këmbimeve valutore për vitin 1999 dhe për vitin 2000. Analizimi i këtyre dy pyetjeve siguron edhe vlerësimin e peshës së këtij operatori në treg sipas opinionit të bankave.

Tabela 14: Evolucionin e vlerësimit të raportit të transaksioneve të zyrate të këmbimit valutore.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Në rritje	83.3	50.0
Në rënie	8.35	16.7
Nuk ka ndryshuar	8.35	25.0
Nuk e di	0.0	8.3

Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë **se situata, sipas opinionit të bankave, edhe për këtë operator është përkeqësuar**. Për vitin 1999 bankat kanë një opinion të konsoliduar që pesha e zyrate të këmbimit valutore ka arritur në rritje. Por, për vitin 2000 vetëm gjysma e tyre e pohon këtë fakt.



Ky konkluzion i kombinuar dhe me konkluzionet e pyetjeve 12 dhe 13 jep sinjale shqetësuese për bankën qendrore. Bankat e nivelit të dytë mendojnë që po bie pesha e operatorëve zyrtarë në tregun e këmbimeve valutore në zgjerim (rritje) të peshës së tregut jozyrtar.

Pyetja 15, është e ngjashme me tri pyetjet e mësipërme, pasi kërkon të dijë valutën më të preferuar për këmbime valutore për vitin 1999 dhe për vitin 2000.

Tabela 15: Evolucion i preferencës për valutat.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	
	1999	2000
Dollari amerikan	100.0	91.7
Lireta italiane	25.0	25.0
Marka gjermane	0.0	8.3
Dhrahmia greke	0.0	0.0

Shënim: *Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Sipas opinionit të bankave, dollari amerikan në të dy vitet mbetet monedhë e preferuar, madje për këtë kemi një mendim unik të bankave. Megjithatë, duhet vërejtur që për vitin 2000 më pak banka janë shprehur për preferencën e dollarit, terren të cilin e ka fituar euro (lireta italiane dhe marka gjermane).

I. 4. Pyetjet e rubrikës C "Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë".

Rubrika C përbëhet nga 9 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi politikën valutore të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe përshtatshmërinë e regjimit të kursit të këmbimit që zbatohet në Shqipëri. Banka e Shqipërisë është e interesuar që të dijë se si perceptohet nga operatorët politika e saj. Përgjigjet e dhëna janë një bazë e mirë për të gjykuar mbi vlefshmërinë e kësaj politike.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së tretë ka rezultuar:

Pyetja 16, kërkon të zbulojë se si konsiderohet regjimi aktual i kursit të këmbimit nga një prej operatorëve më të rëndësishëm dhe më profesionalë të tregut valutor shqiptar, bankat tregtare. Rezulton se **mbi gjysma e bankave (58.3 për qind) shprehen se ky regjim krijon përparësi në punën e tyre**, 25 për qind përgjigjen se nuk krijon përparësi dhe pjesa tjetër, 16.7 për qind, nuk ka dhënë opinion.

Pyetja 17, nisur nga rëndësia që ka regjimi i kursit të këmbimit, kërkon arsyen se përse bankat e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo këtë regjim. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur vetëm 8 banka ose 80 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Bankat që e konsiderojnë të përshtatshëm këtë regjim arsyetojnë me momentin në të cilin kalon zhvillimi në vend, moment për të cilin është më e nevojshme që kurset të lihen të luhaten. Një bankë shprehet se regjimi aktual krijon mundësi pune.

Vërehet se bankat që e konsiderojnë të papërshtatshëm regjimin aktual të kursit të këmbimit japin një arsye të vetme: "Banka e Shqipërisë në vendosjen e këtij regjimi nuk merr parasysh nevojat e bankave".

Pyetja 18, kërkon të dijë përshtatshmërinë e transaksioneve të shit-blerjes së valutës nga ana e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor dhe i janë përgjigjur 12 banka. **Shumica e bankave (75 për qind e tyre) shprehen se Banka e Shqipërisë vepron në treg në momentin e përshtatshëm**, 16.7 për qind shprehen se ajo nuk vepron në momentin e përshtatshëm dhe pjesa tjetër (8.3 për qind) nuk jep opinion.

Pyetja 19, është e ngjashme me pyetjen 17 dhe kërkon arsyen se përse bankat e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo momentin e kryerjes së shit-blerjeve valutore nga ana e Bankës së Shqipërisë. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 9 banka ose 81.8 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Bankat që e konsiderojnë të përshtatshëm momentin e veprimit të Bankës së Shqipërisë konvergojnë në mendimin që Banka e Shqipërisë i kryen shit-blerjet në tregun valutor për të rregulluar kursin, kur ai ka kaluar në nivele të papranueshme (7 banka). Një bankë shprehet se këto shit-blerje bëhen për të konverguar me zhvillimet në tregjet valutore ndërkombëtare.

Vërehet se bankat që e konsiderojnë të papërshtatshëm këtë moment shprehen se Banka e Shqipërisë "nuk rregullon tregun" (një bankë).

Pyetja 20, kërkon të dijë nëse Banka e Shqipërisë arrin, sipas mendimit të bankave tregtare, të realizojë qëllimin me anë të shit-blerjeve që kryen. **Shumica e bankave (66.7 për qind e tyre) shprehen se po**, 16.7 për qind shprehen se jo dhe pjesa tjetër (po 16.7 për qind) nuk jep opinion.

Përgjigjet e pyetjes 20 korrelojnë dukshëm me përgjigjet e dhëna për pyetjen 18. Nga verifikimi i pyetësorëve të veçantë shohim se janë të njëjtat banka që shprehen se Banka e Shqipërisë nuk vepron në momentin e duhur dhe kur ajo e bën këtë, nuk ia arrin qëllimit.

Nga ana tjetër, janë po të njëjtat banka që shprehen se Banka e Shqipërisë vepron në momentin e duhur dhe ia arrin qëllimit nëpërmjet shit-blerjeve valutore që bën.

Nga pikëpamja jonë, ky është një tjetër tregues i cilësisë së mirë të plotësimit të pyetësorëve.

Pyetja 21, është një pyetje cilësore dhe kërkon arsyen për përgjigjen e dhënë nga bankat në pyetjen 20. Insistohet në të tilla pyetje për shkak të natyrës delikate të veprimeve në tregun valutor. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 8 banka ose 80 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Bankat që mendojnë se Banka e Shqipërisë e arrin qëllimin e saj shprehen, në shumicën e rasteve, se këto shit-blerje e kthejnë kursin në kufij normalë (5 banka). Një bankë shprehet se veprimet e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, bëhen në përputhje me tregun ndërkombëtar dhe një tjetër shprehet se "gjatë këtij viti (do me thënë viti 2000) Banka e Shqipërisë ka kryer rreth tre herë shit-blerje të tilla dhe ka patur efekt).

Vërehet se bankat që mendojnë se Banka e Shqipërisë nuk ia arrin qëllimit me shit-blerjet në tregun valutor, e arsyetojnë me faktin që ajo nuk cakton kufij normalë brenda të cilëve të luhaten kurset.

Pyetja 22, kërkon të dijë opinionin e bankave mbi monedhën që ata e konsiderojnë më të përshtatshme për të vepruar në treg duke ofruar katër alternativa përgjigjeje: dollari amerikan, lireta italiane, marka gjermane, dhrahmia greke. Pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Edhe në këtë pyetje **mendimi i bankave është i konsoliduar. Të gjitha bankat (12), përgjigjen se monedha më e përshtatshme për të ndërhyrë në treg është dollari amerikan** dhe vetëm një bankë është shprehur edhe për dhrahminë greke.

Pyetja 23, kërkon të dijë se cilat duhet të jenë, sipas mendimit të bankave, arsyet në bazë të të cilave Banka e Shqipërisë të veprojë në tregun valutor. Përsëri hasim me një **mendim unik të bankave. Të gjitha bankat (12) përgjigjen se qëllimi i Bankës së Shqipërisë për të vepruar në treg duhet të jetë ruajtja e kursit stabël.**

Pyetja 24, kërkon të dijë opinionin e bankave mbi peshën që ka monedha europiane, euro, dhe si ka ecur ajo duke krahasuar vitin 2000 me vitin 1999. **Shumica e bankave, 83.3 për qind, shprehen se nuk mendojnë që euro si monedhë është fuqizuar⁷ në tregun shqiptar gjatë vitit 2000** në raport me vitin 1999, ndërsa 16.7 për qind mendojnë se po.

I. 5. Konkluzione.

Bankat tregtare që veprojnë në Shqipëri janë një ndër operatorët më profesionalë të tregut valutor dhe që pritet të jetë dhe ndër më agresivët. Siç u vërejt më sipër nga analizimi i rezultateve të vrojtimit, ky operator jep informacion mjaft interesant dhe përgjithësisht janë verifikuar pritshmëritë apo arsyetimet e bëra nga punonjës të Bankës së Shqipërisë.

⁷ Për qëllime të këtij vrojtimi me shprehjen "fuqizim i euro-s" nënkuptohet rritja e peshës së saj në volumin e transaksioneve apo në aktivitetin ekonomik të vendit.

1. 5.1. Gjeografia e transaksioneve.

Bankat tregtare i kryejnë transaksionet valutore përgjithësisht me Italinë dhe Greqinë (91.7 për qind të rasteve). Në këtë mënyrë modeli është i ngjashëm me atë të partnerëve të tregtisë së jashtme dhe të shpërndarjes së emigrantëve shqiptarë (Italia dhe Greqia përfaqësojnë dy partnerët kryesorë tregtarë dhe dy vendet ku janë vendosur kryesisht emigrantët shqiptarë). Gjithashtu, prej bankave të këtyre dy vendeve janë çelur në Shqipëri në formë dege apo filiali pesë banka që përfaqësojnë 13.3 për qind të aktivitetit gjithsej të sistemit bankar dhe 34.9 për qind të aktivitetit valutor të sistemit bankar⁸.

1. 5. 2. Monedha e huaj më e preferuar.

Pavarësisht nga shpërndarja gjeografike, transaksionet kryhen më së shumti në dollarë amerikanë dhe në lireta italiane, ndërsa dhrahmia greke renditet e treta. Ndërkohë, prirjet drejtohen kah dollari amerikan i cili konsiderohet si monedhë e qëndrueshme dhe e preferuar për transaksionet valutore. Preferenca për dy vitet e fundit (1999 - 2000) për këtë monedhë mbetet e fortë. Mbi të gjitha, dollari amerikan paraqitet si monedhë orientuese për vendimmarrje, madje konsiderohet prej bankave si monedha më e përshtatshme për shit-blerje në tregun valutor nga ana e Bankës së Shqipërisë. Për këto çështje, mendimi i bankave është i konsoliduar.

Përsa i përket monedhës europiane, euro, bankat mendojnë se ajo nuk është fuqizuar në dy vitet e fundit në tregun shqiptar.

1. 5. 3. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore.

Si e vlerësojnë bankat tregun jozyrtar? Cili është raporti i operatorëve zyrtarë me ata jozyrtarë. Shumica e bankave shprehet se tregu jozyrtar është i panevojshëm. Madje asnjë bankë nuk deklaroi shprehimisht që punon me tregun jozyrtar.

Aktiviteti valutor në këtë treg rezulton të jetë rritur në peshë në raport me bankat. Nga arsyetimet e bankave, rezulton që ky treg në veprimet e tij orientohet nga tregjet ndërkombëtare duke i dhënë një pavarësi relative dhe nënkupton që operatorët zyrtarë nuk kanë ndikim të ndjeshëm në orientimin e tij.

1. 5. 4. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e bankës qendrore.

Në përgjithësi, shumica e bankave, e konsiderojnë të vlefshëm e të përshtatshëm regjimin e kursit të këmbimit, politikën valutore dhe veprimet në tregun valutor të Bankës së Shqipërisë. Bankat mendojnë se Banka e Shqipërisë vepron në momentin e duhur si edhe arrin qëllimin për të cilin ajo vepron në këtë

⁸ Të dhënat i referohen fundit të vitit 2000.

treg. Për më tepër bankat tregtare sugjerojnë që transaksionet valutore në këtë treg duhen bërë në dollarë amerikanë dhe për të stabilizuar kursin e këmbimit.

1. 5. 5. Aktiviteti valutor i bankave tregtare.

Informacioni i paraqitur sugjeron që bankat tregtare kryejnë rreth 34 transaksione në ditë me vlerë mesatare 44.6 mijë dollarë amerikanë. Kjo do të thotë që në një vit sistemi bankar qarkullon për qëllime të këmbimeve valutore rreth 400 milionë dollarë amerikanë.

Në përfundim konkludohet që bankat tregtare konsiderojnë dollarin amerikan si monedhë të qëndrueshme dhe orientuese në vendimet e tyre dhe mendojnë që euro nuk e ka fuqizuar peshën e saj në tregun shqiptar.

Pyetësoni për bankat.

A. Informacione të përgjithshme.

Pyetja 1. Cili është vendi kryesor i huaj me të cilin ju kryeni shumicën e transaksioneve? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

- Italia 1
- Greqia 2
- Turqia 3
- Gjermania 4
- Bullgaria 5
- Maqedonia 6
- Të tjera 8

Specifikoni _____ !_!

Pyetja 2. Cila është monedha me të cilën operoni më shpesh? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

- Dollari amerikan 1
- Lireta italiane 2
- Marka gjermane 3
- Dhrahmia greke 4
- Leku 5
- Të tjera 6

Specifikoni _____ !_!

Pyetja 3. Sa transaksione valutore në ditë kryeni mesatarisht?

- Deri 10 1
- 10-20 2
- 20-30 3
- 30-40 4
- 40-50 5
- 50 e lart 6

Pyetja 4. Sa është vlera mesatare për çdo transaksion në dollarë? _____

Pyetja 5: Preferoni të këmbeni paratë tuaja: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

- Në bankë? 1
- Në ZKV? 2
- Në tregun informal (kambistë të lirë)? 3
- Kombinim i varianteve të mësipërme? 4

Pyetja 6.Jepni arsyen/t për zgjedhjen e bërë në pyetjen 5:

_____ !_!

B. Opinione për organizimin e tregut valutor.

Pyetja 7. Cila mendoni se është valuta më e qëndrueshme tek ne ? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Te tjera	5	Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 8. Cila monedhë e huaj përbën pikën orientuese në aktivitetin tuaj? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 9. A e vlerësoni të nevojshëm tregun jozyrtar të këmbimive valutore?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 10. Nëse keni zgjedhur 1 apo 2, jepni arsyen e zgjedhjes në pyetjen 9.

_____ !_!

Pyetja 11. Cili është, sipas mendimit tuaj, kursi mbi të cilin bazohet vendosja e kurseve të këmbimit në tregun jozyrtar të këmbimeve valutore?

_____ !_!

Pyetja 12. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryenit në tregun jozyrtar në vitin 1999, krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Më i madh?	1
Më i vogël?	2
Nuk ka ndryshuar?	3
Nuk e di?	4

Pyetja 13. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryeni aktualisht në tregun jozyrtar (në vitin 2000), krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Më i madh?	1
Më i vogël?	2
Nuk ka ndryshuar?	3
Nuk e di?	4

Pyetja 14. Mendoni se pjesa e tregut të këmbimeve valutore e zotëruar nga ZKV, në këto dy vitet e fundit ka ardhur: (Për secilin moment kohor zgjidhni vetëm një mundësi.)

viti 1999		viti 2000	
në rritje?	1	në rritje?	1
në rënie?	2	në rënie?	2
nuk ka ndryshuar?	3	nuk ka ndryshuar?	3
nuk e di?	4	nuk e di?	4

Pyetja 15. Cila është valuta me të cilën ju keni preferuar të operoni dhe preferoni aktualisht të operoni më shpesh? (Për secilin moment kohor mund të zgjidhni më shumë se një nga valutat e mëposhtme.)

viti 1999		viti 2000	
Dollari amerikan	1	Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2	Lireta italiane	2
Marka gjermane	3	Marka gjermane	3
Drahamia greke	4	Drahamia greke	4

C. Opinione për disa aspekte të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

Pyetja 16. A ju krijon përparësi në punën tuaj regjimi aktual i kursit të këmbimit? (Të jepet një sqarim për këtë regjim.)

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 17. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 16.

!_!

Pyetja 18. A mendoni se shit-blerjet valutore të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor për ndryshimin e kursit të këmbimit, kryhen në momentin e përshtatshëm?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 19. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 18.

!_!

Pyetja 20. A mendoni se nga këto transaksione ajo ia arrin qëllimit?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 21. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 20.

!_!

Pyetja 22. Cila do të ishte, sipas mendimit tuaj, monedha më e përshtatshme për të kryer transaksione në treg? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4

Pyetja 23. Për ç'qëllim duhet të veprojë në treg Banka e Shqipërisë?

Zhvlerësim	1
Vlerësim	2
Ruajtje të një kursi stabël	3
Pa opinion	4

Pyetja 24. Mendoni se euro është fuqizuar në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999?

Po	1
Jo	2
Nuk ka ndryshuar	3
Nuk e di	4

Faleminderit për bashkëpunimin!

KAPITULLI II: REZULTATET E DALA NGA PËRPUNIMI I INFORMACIONIT TË PYETËSORIT PËR ZYRAT E KËMBIMIT VALUTOR.

II. 1. Informacion i përgjithshëm.

Në procesin e vrojtimit u zgjodhën për intervistim të gjitha zyrat e këmbimit valutor që zhvillojnë aktivitet në Shqipëri, 21. Intervistave iu përgjigjën vetëm 18 prej tyre, ose 87.5 për qind e të pyeturve gjithsej. Niveli i përgjigjeve konsiderohet shumë i mirë. Madje po kaq i lartë është niveli i përgjigjeve edhe për pyetje të veçanta, sidomos në ato ku janë të renditura alternativat e përgjigjeve. Ndërsa, për pyetjet e lira niveli më i ulët i përgjigjeve është rreth 60 për qind, pra përsëri konsiderohet i kënaqshëm. Në përgjithësi kemi një rritje të dukshme në shkallën e përgjigjeve nga zyrat e këmbimit valutor që krahasuar me vitin 1999, vit në të cilin vrojtimit të kryer iu përgjigjën vetëm katër ose 26.7⁹ për qind e tyre (për thjeshtësi në vijim do t'u referohemi thjesht si zyrave). Ky nivel i lartë përgjigjesh siguron edhe arritjen e konkluzioneve të vlefshme. Po ashtu, siç do të trajtohet më poshtë, në përgjithësi, përgjigjet janë të kuptimta dhe ndjekin një rrjedhë logjike.

II. 2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme".

Rubrika A përbëhet nga 6 pyetje dhe synon të marrë informacion të përgjithshëm mbi monedhën/monedhat me të cilën/cilat kryhen transaksionet, vlerësime sasiore mbi numrin e transaksioneve dhe vlerën mesatare të transaksioneve si dhe operatorin/operatorët më të preferuar për të kryer veprime.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së parë ka rezultuar:

Pyetja 1, ka për qëllim të identifikojë vendin, i cili haset më shpesh sipas mendimit të zyrave në këmbimet valutore të tyre. Për këtë arsye pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton që, **vendi me të cilin zyrat mendojnë se kryhen më shpesh transaksione valutore është Italia**. Për këtë shtet japin përgjigje 5 nga 21 zyrat e pyetura. Vendi i dytë në renditje është Greqia për të cilën përgjigjen 3 zyra.

Tabela 16: Shpërndarja gjeografike e transaksioneve valutore.

Shteti	Përgjigjet (në %)*
Italia	27.8
Greqia	16.7
Turqia	11.1
Gjermania	5.6
Bullgaria	0.0
Maqedonia	5.6
Të tjerë	38.9

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 18. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

⁹ Shih: Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vrojtimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 13.

Pyetja 2, ka për qëllim të identifikojë valutën me të cilën operohet më shpesh nga zyrat. Për këtë arsye edhe pyetja 2 lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton që **në shumicën e rasteve transaksionet kryhen në dollarë amerikan**. 14 zyra këmbimi e konfirmojnë këtë fakt. Në nivele të krahasueshme janë përgjigjet për përdorimin e markës gjermane (6 zyra) dhe liretës italiane (5 zyra).

Tabela 17: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	77.8
Lireta italiane	27.8
Marka gjermane	33.3
Dhrahmia greke	16.7
Të tjera	0.0

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 18. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Pyetja 3, është një pyetje që kërkon të marrë informacion sasior mbi numrin mesatar ditor të transaksioneve të kryera nga secila zyrë. Ofrohen për përgjigje gjashtë alternativa, por lejohet zgjedhja vetëm e njëjës. Informacioni i siguar jep mundësi për të gjetur një numër mesatar të transaksioneve valutore të kryera nga zyrat e këmbimit valutor në një njësi kohe të caktuar.

Tabela 18: Shpërndarja e zyrave sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	Frekuencat kumulative rritëse
Deri në 10	61.1	61.1
10-20	22.2	83.3
20-30	16.7	100.0
Totali	100.0	

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 18.

Nga përgjigjet rezulton **se në shumicën e rasteve kryhen deri në 10 transaksione në ditë**. Të gjitha zyrat kryejnë mesatarisht në një ditë deri në 30 transaksione.

Box 2: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për zyrat në njësinë e kohës.

I. Në një ditë numri mesatar i transaksioneve është rreth 11.

II. Në një muaj numri mesatar i transaksioneve është rreth 242 (numri i ditëve të punës në një muaj është marrë 22).

III. Në një vit numri mesatar i transaksioneve është rreth 2904 (numri i ditëve të punës në një vit është marrë 264).

Pyetja 4, si edhe pyetja 3, kërkon të marrë informacion sasior mbi vlerën mesatare të një transaksioni të shprehur në dollarë amerikanë. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur vlerën mesatare të një transaksioni valutor të zyrave. Karakteristikë për zyrat e këmbimit është gjerësia e madhe e variacionit, kufijtë e të cilës variojnë nga 2.5 dollarë amerikan (vlera më e ulët e deklaruar) në 11 mijë dollarë amerikanë (vlera më e lartë e deklaruar). Kjo tregon që ndërmjet zyrave të këmbimit valutor ka një segmentim tregu. Për qëllime analize kemi bërë grupimin në klasa sipas emërimit: zyra që këmbëjnë me shuma mjaft të vogla (0 - 100 usd), shuma të vogla (100 - 1000 usd), shuma të nivelit të mesëm (1000 - 10000 usd) dhe të mëdha (10000 - 100000 usd).

Tabela 19: Shpërndarja e zyrave sipas vlerës mesatare për një transaksion.

Vlerat mesatare e një këmbimi (në dollarë amerikanë)	Rastet e përgjigjeve
2.5	1
20	1
30	1
40	1
50	2
60	1
Deri në 100	7
150	1
200	1
250	1
500	2
100-1000	5
2500	3
6500	1
1000-10000	4
11000	1




Tabela 20: Struktura e shpërndarjes së zyrave sipas grupimit për vlerën mesatare të një transaksioni.

Grupet (në dollarë amerikanë)	Përgjigjet (në %)*
Deri në 100	41.2
100 – 1000	29.4
1000 – 10000	23.5
Mbi 10000	5.9
Totali	100.0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 17. Një zyrë nuk është përgjigjur.

Vërehet se **pjesa më e madhe e zyrave kryejnë këmbime me vlerë mesatare deri në 100 dollarë amerikanë për një transaksion.** Mbi gjysma e tyre kryejnë transaksione me vlerë mesatare deri në njëmijë dollarë amerikanë. Ndërsa 94.1 për qind kryejnë transaksione me vlerë deri në dhjetëmijë dollarë amerikanë. Pra, pothuaj të gjitha zyrat e këmbimit kryejnë transaksione deri në nivelin e shumave të mesme. **Vlera mesatare e një transaksioni të kryer nga zyrat e intervistuar rezulton rreth 1580 dollarë amerikanë.**

Meqënëse, rreth 71 për qind e zyrave kryejnë transaksione me vlera mesatare deri në 500 dollarë amerikanë paraqitja e shpërndarjes së këtij grupi zyrash paraqet interes të veçantë për të qartësuar formën e këtij përqëndrimi.




Tabela 21: Vlerat mesatare për një transaksion sipas grupeve.

Grupet (në dollarë amerikanë)	Në mijë dollarë amerikanë
Deri në 100 (mjaft të vogla)	36
100 – 1000 (të vogla)	320
1000 – 10000 (të mesme)	3500
Mbi 10000 (të mëdha)	11000

Kombinimi i rezultateve të përgjigjeve të dhëna për pyetjet 3 dhe 4, siguron një informacion rreth vëllimit total të transaksioneve që kryejnë zyrat në njësinë e kohës.

Tabela 22: Vëllimi total mesatar i transaksioneve sipas grupeve (në usd).

Grupet	Një ditë	Një muaj	Një vit
Deri në 100 (mjaft të vogla)	396	8 712	104 544
100 – 1000 (të vogla)	3 520	77 440	929 280
1000 – 10000 (të mesme)	38 500	847 000	10 164 000
Mbi 10000 (të mëdha)	121 000	2 662 000	31 944 000

Vërehet që për një vit zyrat e këmbimit valutore realizojnë, sipas grupeve të klasifikuara, një volum transaksionesh valutore që varion nga afërsisht 104 mijë dollarë amerikanë në afërsisht 32 milionë dollarë amerikanë.

Nëse do të kombinohen rezultatet e deritanishme mund të jepet një vlerësim mbi vëllimin mesatar total të transaksioneve që kanë realizuar zyrat gjatë një viti (konkretisht në vitin 2000). Kështu, **për një vit një zyrë realizon një vëllim mesatar transaksionesh valutore prej afro 4.6 milionë dollarë amerikanë.** Ndërkohë, **të gjitha zyrat së bashku kanë një vëllim mesatar të realizuar transaksionesh në masën 97 milionë dollarë amerikanë¹⁰.**

Box 3: Llogaritja e intervalit të besimit të vëllimit mesatar vjetor të transaksioneve për të gjitha zyrat e këmbimit valutore.

Vëllimi mesatar vjetor i transaksioneve të kryera nga një zyrë rezultoi 4.6 milionë dollarë amerikanë.

Duke patur parasysh se janë 21 zyra të regjistruara, atëherë mund të vlerësohet vëllimi mesatar vjetor për të gjitha zyrat së bashku: 96.6 milionë dollarë amerikanë (4.6 *21=96.6).

Intervali i besimit për treguesin më sipër, merr vlerën e një përgjithësimi real, sepse vrojtimi është i përgjithshëm, pra është kryer mbi një popullim të fundëm (numri i zyrave është i ditur, 21 të tilla). Në rastin konkret, lejohet të bëhet një vlerësim intervalor i parametrave të zgjedhjes, për arsye se janë përgjigjur vetëm 17 zyra, apo rreth 81 për qind e totalit.

Për të arritur këtë vlerësim zbatohet formula e përgjithësimi të rezultatit të zgjedhjes për vëllimin mesatar vjetor për të gjitha zyrat:

Intervali i besimit për vëllimin mesatar vjetor për të gjitha zyrat = (Mesatari) +/- (niveli i besueshmërisë për p=0.05) * (numrin e zyrave) * (devijimin standard për mesataren e një transaksioni në një zyrë) * (numrin mesatar vjetor të transaksioneve të kryera). Duke zbatuar formulën më sipër kemi:

Intervali i besimit për vëllimin mesatar vjetor për të gjitha zyrat = (96.6 milionë usd)+/- (2) * (21) * (550) * (2904) = (96.6 milionë usd) +/- (67 milionë usd) = nga 30 milionë usd deri në 164 milionë usd.

¹⁰ Intervali i besimit është llogaritur me një koeficient besueshmërie 95 për qind dhe luhet nga rreth 30 milionë dollarë amerikanë në rreth 164 milionë dollarë amerikanë.

Pyetja 5, kërkon të zbulojë se cili/cilët operator/operatorë preferohen për të kryer veprimtari valutore. Nga përgjigjet rezultojnë që 11.1 për qind e zyrove punojnë me banka, 5.6 për qind me zyra të tjera të këmbimit valutor, 33.3 për qind me tregun jozyrtar të këmbimeve dhe pjesa që mbetet (50 për qind) i kombinon operatorët. Në 66.7 për qind të rasteve, zyrat kanë identifikuar edhe format e kombinimit të operatorëve. Në përgjithësi zyrat kanë kombinuar bankat me tregun jozyrtar dhe vetëm në një rast deklarohet kombinimi bankë-zyrë.

Duke e përgjithësuar këtë informacion për të gjitha zyrat e këmbimit të përgjigjura rezultojnë që kombinimi "bankë-treg jozyrtar", zë afro 33 për qind. Nga një vlerësim i të dhënave mundësohet deri diku edhe përgjithësimi për tregun jozyrtar i cili rezultojnë të preferohet në total të paktën në masën 66.7 për qind, nga zyrat, për kryerjen e këmbimeve valutore.

Box 4: Përgjithësime

a- Përgjithësimi për kombinimin "bankë-treg jozyrtar"

b- Përgjithësimi për tregun jozyrtar

a- Brenda kombinimit të operatorëve deklarohen 6 të tilla në të cilat evidentohen banka dhe tregu jozyrtar. Për të gjitha zyrat e përgjigjura, pesha e këtij kombinimi do të llogaritet si produkt i peshës së të gjitha kombinimeve me peshën e kombinimit përkatës në alternativën e kombinimit të operatorëve, ose thjesht si raport i numrit të kombinimeve "bankë-treg jozyrtar" me numrin e përgjigjeve në total, pra:

$$(9/18)*(6/9)=6/18=33.3 \text{ për qind.}$$

b) Për tregun jozyrtar evidentohen dy preferenca: së pari, preferenca e pastër për këtë treg (e vlerësuar në 50 për qind të zyrove të përgjigjura);

së dyti, preferenca brenda kombinimeve, e shprehur në 6 raste edhe për këtë treg. Meqenëse, tregu jozyrtar është shprehur në kombinim me një operator tjetër, mund të supozohet që ai zë të paktën, gjysmën e peshës së këtij kombinimi pra, të paktën 3 raste (6/2), ose në rreth 16.7 për qind të të gjitha zyrove të përgjigjura, që llogaritet si më poshtë:

$$(3/18)*100 = ((9/18)*(3/9))*100 = 16.7 \text{ për qind.}$$

Përgjithësimi për preferencën ndaj tregut jozyrtar nga ana e zyrove, do të vlerësohet duke u bazuar njëherësh në këto dy informacione dhe ajo do të rezultonte:

$$50+16.7=66.7 \text{ për qind.}$$

Pra, tregu jozyrtar preferohet për kryerjen e këmbimeve valutore nga zyrat, të paktën në masën 66.7 për qind.

Pyetja 6, kërkon të dijë arsyet që çojnë zyrat në kryerjen e transaksioneve me operatorët e tyre të preferuar. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 11 zyra (61.1 për qind e të pyeturve).

Në 72.7 për qind të rasteve të përgjigjeve del si arsye "kursi më i favorshëm që ofron operatori". Pra, **kushti i parë në zgjedhjen e një operatori për një zyrë është "fitimi"**. Faktori "siguri" renditet i dyti (në 54.5 për qind të rasteve të përgjigjura) por edhe ai paraqitet i konsiderueshëm.

Tabela 23: Arsyjeja për zgjedhjen e operatorëve.

Arsyjeja	Numri i përgjigjeve (raste)
Kurs i favorshëm, në kuptimin e sigurimit të fitimit më të mirë.	8
Siguri më e lartë	6
Shpejtësi në veprime	3

Për nevoja të analizës është shqyrtuar kombinimi i arsyes për zgjedhjen e operatorit. Nga ky kombinim kuptohet qartë struktura e tregut valutor në Shqipëri, ku tregu jozyrtar ofron shrbim të shpejtë dhe fitimprurës, për shkak të kursit më të favorshëm që aplikon në raport me operatorët zyrtarë, ndërsa banka ofron siguri në veprime.

Tabela 24: Shpërndarja e operatorëve sipas arsyes së zgjedhjes.

Arsyjeja – Kurs i favorshëm në kuptimin e sigurimit të fitimit më të mirë.	
Tregu jozyrtar	7 raste
Zyra	1 rast
Arsyjeja – Siguri më e lartë	
Banka	5 raste
Zyra	1 rast
Arsyjeja - Shpejtësi në veprime	
Treg jozyrtar	3 raste

Megjithatë, një zyrë, e cila nuk është marrë parasysh në llogaritjet e mësipërme, shprehet se kryen transaksione me tregun jozyrtar, por banka paraqet më shumë garanci.

II. 3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor".

Rubrika B përbëhet nga 10 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi organizimin e tregut valutor në vend, si është ecuria e tij dhe si kanë ndryshuar raportet në rëndësinë që kanë operatorë apo valuta të ndryshme në këtë treg në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999. Kjo rubrikë përmban dhe dy pyetjet thelbësore që në fakt përbëjnë dhe qëllimin e vrojtimit (pyetjet 7 dhe 9). Ato kanë të bëjnë me identifikimin e monedhës më të qëndrueshme dhe të monedhës orientuese për vendimet ekonomike të zyrave të këmbimit valutor.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së dytë ka rezultuar:

Pyetja 7, kërkon që zyrat të identifikojnë monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Ofrohen pesë alternativa (monedha) dhe lejohet zgjedhja e më shumë se njëjës prej tyre.

Tabela 25: Shpërndarja e zyrave sipas opinionit mbi monedhën më të qëndrueshme.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	88.9
Lireta italiane	0.0
Marka gjermane	16.7
Dhrahmia greke	5.6
Të tjera	0.0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 18. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Përgjigjet e zyrave paraqesin një opinion të konsoliduar. 16 zyra e konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën më të qëndrueshme.

Pyetja 8, kërkon që zyrat të japin arsyet për zgjedhjen e tyre në pyetjen 7. monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 15 zyra ose 83.3 për qind e zyrave të përgjigjura. 12 zyra e arsyetojnë zgjedhjen e tyre me faktin që dollari amerikan përfaqëson një ekonomi të qëndrueshme, të fortë dhe për pasojë, është vetvetiu një monedhë e qëndrueshme. Dy zyra përgjigjen se dollari amerikan është monedhë me qarkullim të lartë, pra siguron likuiditet. Ky arsyetim është në vijim të filozofisë së administrimit të rrezikut që kanë adoptuar zyrat e këmbimit valutor. Pra është zgjedhur ajo monedhë që sot paraqitet më e qëndrueshme edhe në tregjet botërore.

Pyetja 9, kërkon që zyrat të identifikojnë monedhën orientuese për të marrë vendime. Ofrohen po pesë alternativa (monedha) dhe lejohet zgjedhja e më shumë se njëres prej tyre.

Tabela 26: Shpërndarja e zyrave për opinionin mbi monedhën orientuese.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	83.3
Lireta italiane	11.1
Marka gjermane	0.0
Dhrahmia greke	5.6
Të tjera	0.0

Shënim: * Llogaritur mbi numrin e zyrave të përgjigjura, 18. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Përgjigjet e zyrave përsëri paraqesin një opinion të konsoliduar. 15 zyra konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën orientuese për vendimmarrjen e tyre. Ky konkluzion është në harmoni me atë të pyetjes 7. Dollari konsiderohet monedhë e qëndrueshme dhe si i tillë ofron dhe monedhën orientuese për vendimet që marrin zyrat në zhvillimin e aktivitetit të tyre valutor. Kjo i ndihmon për të marrë vendime të suksesshme dhe për të shmangur rreziqet.

Pyetja 10, dhe katër pyetjet vijuese, përqëndrohen në marrjen e informacionit mbi tregun jozyrtar të këmbimeve valutore. Pyetja është e thjeshtë dhe kërkon të

dijë nga zyrat nëse e konsiderojnë, për kushtet e Shqipërisë, ekzistencën e tregut jozyrtar të këmbimeve valutore të nevojshëm apo jo. **Shumica e zyrave (66.7 për qind e tyre) e konsiderojnë tregun jozyrtar të nevojshëm**, 16.7 për qind të panevojshëm dhe pjesa tjetër nuk jep opinion. Ky opinion është në harmoni me përgjigjet e dhëna në pyetjen 5 sipas të cilës rreth 1/3 e zyrave të këmbimit valutor operonin vetëm me tregun jozyrtar.

Nga kombinimi i përgjigjeve të dhëna për pyetjet 5 dhe 10 rezulton se janë të njëjtat zyra, që punojnë me tregun jozyrtar dhe që e vlerësojnë atë të nevojshëm (10 të tilla).

Pyetja 11, kërkon të dijë arsyet për përgjigjet e dhëna nga zyrat në pyetjen më sipër. Janë përgjigjur të gjitha zyrat që normalisht duhet të jepnin përgjigje, 15.

Tri zyrat që shprehen se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore është i panevojshëm e arsyetojnë me faktin që tregu nuk jep informacion të saktë, nuk paraqet interes dhe në të ka spekulime në çmim.

Zyrat që shprehen se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore është i nevojshëm japin këto arsye:

Tabela 27: Arsyet për nevojën e tregut jozyrtar.

Arsyeja	Numri i përgjigjeve (raste)
Shpejtësi veprimi	6
Jep informacion të drejtë	4
Fitim më i mirë	4
Plotëson nevojat (pasi bankat nuk janë në gjendje)	3
Ofron mundësi punësimi	1


Në tërësi, **ajo ç'ka e bën të nevojshëm këtë treg për zyrat e këmbimit është shpejtësia e veprimit që ai ofron**. Ky është një sinjal për përmirësim të veprimit të sistemit bankar në këtë drejtim.

Pyetja 12, kërkon të dijë mbi ç'bazë përcaktohet kursi i këmbimit në tregun jozyrtar sipas opinionit të zyrave. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 17 zyra (ose 94.4 për qind e zyrave të përgjigjura). 16 zyra shprehen se **në tregun jozyrtar kursi vendoset sipas kursit në tregjet ndërkombëtare**. Një zyrë shprehet se kursi përcaktohet në bazë të kërkesës dhe ofertës për valutë.

Pyetja 13 dhe 14 janë identike. Ato kërkojnë të dinë raportin e vëllimit të transkioneve që kryhen në tregun jozyrtar me atë të bankave për vitin 1999 dhe vitin 2000. Analizimi i këtyre dy pyetjeve siguron edhe vlerësimin e zhvillimit të këtyre dy tregjeve.

Tabela 28: Evolucionit i vlerësimit të raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Më i madh	22.2	33.3
Më i vogël	55.6	22.2
Nuk ka ndryshuar	5.6	16.7
Nuk e di	16.7	27.8



Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë se **situata, sipas opinionit të zyrave, është përkeqësuar**. Rezulton që, nëse në vitin 1999 mbi gjysma e zyrave mendojnë se vëllimi i transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar është më i vogël se në tregun bankar, në vitin 2000 ky tregues reduktohet me 33.4 pikë përqindjeje, duke rritur me nga 11.1 pikë përqindjeje numrin e zyrave që mendojnë se është më i madh dhe që nuk ka ndryshuar.


Akoma më shqetësues paraqitet ky konstatim nëse kemi parasysh që nga vërtetimi i kryer me zyrat në vitin 1999¹¹, u vu re se për periudhën 1996-1999 pati një përmirësim të raportit të vëllimeve të transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar dhe atë bankar në favor të këtij të fundit.

Pyetja 15, është e ngjashme me pyetjet 13 dhe 14, pasi kërkon të dijë ecurinë e vëllimit të transaksioneve që kryhen në zyrat e këmbimeve valutore për vitin 1999 dhe për vitin 2000. Analizimi i këtyre dy pyetjeve siguron edhe vlerësimin e peshës së këtij operatori në treg sipas opinionit të vetë zyrave.

¹¹ Shih: Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vërtetimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 29-30 dhe fq. 111.

Tabela 29: Evolucion i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrat e këmbimit valutor.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Në rritje	61.1	50.0
Në rënie	5.6	11.1
Nuk ka ndryshuar	16.7	16.7
Nuk e di	16.7	22.2



Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë se situata, **sipas opinionit të vetë zyrove, ka një përkeqësim të lehtë**. Alternativës që pesha e zyrove të këmbimit valutor ka ardhur në rritje në vitin 2000 i përgjigjen më pak zyra këmbimi (reduktimi është me 11.1 pikë përqindjeje). Për vitin 2000 vetëm gjysma e tyre e pohon këtë fakt. Ndërkohë rritet me 5.5 pikë përqindjeje numri i zyrove që mendon se është në rënie. Kurse pesha në treg e zyrove të këmbimit për periudhën 1996-1999 deklarohet të jetë më e madhe në bazë të informacionit të marrë prej vrojtimit të kryer me zyrat në vitin 1999¹².

Ky konkluzion i kombinuar dhe me konkluzionin e pyetjeve 14 dhe 15 jep sinjale shqetësuese për bankën qendrore. Vetë zyrat e këmbimit valutor mendojnë që po bie pesha e operatorëve zyrtarë në tregun e këmbimeve valutore në zgjerim (rritje) të peshës së tregut jozyrtar.


Pyetja 16, është e ngjashme me tri pyetjet e mësipërme, pasi kërkon të dijë valutën më të preferuar për këmbime valutore për vitin 1999 dhe për vitin 2000.

¹² Shih Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vrojtimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 30.

Tabela 30: Evolucion i preferencës për valutat.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999*	2000
Dollari amerikan	64.6	61.1
Lireta italiane	11.8	11.1
Marka gjermane	11.8	16.7
Dhrahmia greke	11.8	11.1

Shënim: *Për vitin 1999 janë përgjigjur 17 zyra. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.



Sipas opinionit të zyrave, dollari amerikan në të dy vitet mbetet monedhë e preferuar. Një shpërndarje pak a shumë uniforme vërehet për tri monedhat e tjera. Pra, në tërësi, situata paraqitet e pandryshuar. Megjithatë, vërehet një reduktim i lehtë i peshës së dollarit amerikan (3.5 pikë përqindjeje) dhe rritje e peshës së markës gjermane (4.9 pikë përqindjeje).

Ky opinion është në përputhje edhe me rezultatet e dala nga vrojtimi i kryer në vitin 1999¹³. Zyrat e përgjigjura në këtë vërtetim kanë deklaruar se për periudhën 1996-1999 monedha më e preferuar në treg ishte dollari amerikan.

II. 4. Pyetjet e rubrikës C "Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë".

Rubrika C përbëhet nga 9 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi politikën valutore të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe përshtatshmërinë e regjimit të kursit të këmbimit që zbatohet në Shqipëri. Banka e Shqipërisë është e interesuar që të dijë se si perceptohet nga operatorët politika e saj. Përgjigjet e dhëna janë një bazë e mirë për të gjykuar mbi vlefshmërinë e kësaj politike.

¹³ Shih Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vërtetimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 30.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së tretë ka rezultuar:

Pyetja 17, kërkon të zbulojë se si konsiderohet regjimi aktual i kursit të këmbimi nga një prej operatorëve, zyrat e këmbimit valutor. Rezulton se **gjysma e zyrave (50 për qind) shprehen se ky regjim krijon përparësi në punën e tyre**, 16.7 për qind përgjigjen se nuk krijon përparësi dhe pjesa tjetër, 33.3 për qind, nuk ka dhënë opinion.

Pyetja 18, nisur nga rëndësia që ka regjimi i kursit të këmbimit, kërkon arsyen se përse zyrat e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo këtë regjim. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 12 zyra ose 100 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Zyrat që e konsiderojnë të përshtatshëm këtë regjim japin arsye të ndryshme. Pesë zyra shprehen se në këtë regjim kursi sigurojnë fitime të mira, katër të tjera e lidhin me shpejtësinë e veprimit, dy zyra shprehen se regjimi lejon përcaktimin e një kursi real, njëra se krijon mundësi punësimi dhe e fundit, për të cilin mendojmë është një arsyetim interesant, lejon shtimin e valutës në treg.

Vërehet se zyrat që e konsiderojnë të papërshtatshëm regjimin aktual të kursit të këmbimit arsyetojnë se rolin kryesor e luan tregu i lirë dhe jo banka apo bursa (një zyrë) dhe banka e media nuk japin kurs real të tregut (dy zyra). Këto arsyetime mund të interpretohen me faktin, që mungesa e një sistemi informacioni të njëlojtë për lojtarët e tregut e bën të vështirë orientimin e tyre në një regjim luhatës të lirë të kursit.

Nga kombinimi i informacionit që merret nga pyetjet 5 dhe 18, rezulton se, në përgjithësi, zyrat që e konsiderojnë regjimin e kursit të këmbimit të papërshtatshëm janë ato që veprojnë me tregun jozyrtar. Nga një analizë e mëtejshme rezulton që këto zyra janë klasifikuar në grupin e zyrave që kryejnë transaksione me shuma të vogla. Normalisht, për këtë kategori operatorësh, ekspozimi ndaj rrezikut të ndryshimit të lirë të kursit të këmbimit është më i lartë.

Pyetja 19, kërkon të dijë përshtatshmërinë e transaksioneve të shit-blerjes së valutës nga ana e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor. Gjysma (50 për qind) e zyrave nuk kanë dhënë opinion. Megjithatë, numri i zyrave që deklarojnë se Banka e Shqipërisë vepron në treg në momentin e përshtatshëm është rreth 3.5 herë më i lartë se numri i zyrave që shprehen se Banka e Shqipërisë nuk vepron në momentin e përshtatshëm (përkatesisht 38.9 dhe 11.1 për qind).

Pyetja 20, është e ngjashme me pyetjen 17 dhe kërkon arsyen se përse zyrat e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo momentin e shit-blerejeve valutore nga Banka e Shqipërisë. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 7 zyra ose 77.8 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Zyrat që e konsiderojnë të përshtatshëm momentin e veprimit të Bankës së Shqipërisë shprehen se "këto veprime bëhen për të mbajtur të stabilizuar kursin

e këmbimit të monedhës së vendit" (tri zyra), apo thjesht se "veprimet janë të drejta" (dy zyra). Ndërsa një zyrë i arsyeton ato me fuqinë që banka qendrore ka si institucion, pasi ka në dispozicion fonde valutore.

Vërehet se zyra që e konsideron të papërshtatshëm këtë moment shprehet se "veprimet e shit-blerjes nga ana e Bankës së Shqipërisë, çorientojnë tregun dhe janë në drejtim të kundërt me zhvillimet në tregjet ndërkombëtare".

Pyetja 21, kërkon të dijë nëse Banka e Shqipërisë arrin, sipas mendimit të zyrave, të realizojë qëllimin me shit-blerjet valutore që kryen. Përsëri gjysma e zyrave nuk japin opinion. Megjithatë, diferenca midis zyrave që shprehen se e arrin qëllimin (44.4 për qind) dhe atyre që shprehen se nuk e arrin një qëllim të tillë (5.6 për qind) është e konsiderueshme.

Nga kombinimi i përgjigjeve për pyetjet 19 dhe 21 vërehet se në katër raste që zyrat deklarojnë se banka qendrore ia arrin qëllimit me shit-blerjet e saj, ato janë dakort që ajo të ndërhyjë.

Në një rast përputhet fakti që zyra nuk përkrah veprimet e bankës dhe deklaron që nuk ia arrin qëllimit. Interesant paraqitet kombinimi në dy raste kur zyrat megjithëse nuk përkrahin këto veprime, përsëri pohojnë se banka e realizon qëllimin.

Pyetja 22, është një pyetje cilësore dhe kërkon arsyen për përgjigjen e dhënë nga zyrat në pyetjen 21. Insistohet në të tilla pyetje për shkak të natyrës delikate të veprimeve në tregun valutor. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 8 zyra ose 88.9 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Zyrat që mendojnë se Banka e Shqipërisë e arrin qëllimin e saj shprehen se këto ndërhyrje stabilizojnë tregun (pesë zyra). Dy zyra të tjera mendojnë se Banka e Shqipërisë punon thjesht për interes të saj.

Vërehet se zyra që mendon se Banka e Shqipërisë nuk ia arrin qëllimit me ndërhyrjet e saj shprehet se banka krijon luhatje të paarsyeshme dhe të humbur dalin gjithmonë kambistët dhe klientët.

Pyetja 23, kërkon të dijë opinionin e zyrave mbi monedhën që ato e konsiderojnë më të përshtatshme për të kryer shit-blerje valutore në treg duke ofruar katër alternativa përgjigjeje: dollari amerikan, lireta italiane, marka gjermane, dhrahmia greke. Pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. **Mendimi i zyrave është dukshëm në favor të dollarit amerikan, pasi për këtë monedhë janë shprehur 83.3 për qind e tyre.** Ndërsa 22.2 për qind e zyrave identifikojnë markën gjermane. Ky rezultat është në harmoni me përgjigjet e dhëna në pyetjen 2, e cila identifikon shkallën e përdorimit të monedhave të huaja.

Pyetja 24, kërkon të dijë se cilat duhet të jenë, sipas mendimit të zyrave, arsyet në bazë të të cilave Banka e Shqipërisë të veprojë në tregun valutor. 55.6 për qind e zyrave shprehen se banka duhet të veprojë për të vlerësuar monedhën e vendit, 38.9 për qind për ruajtje të kursit stabël, 22.2 për qind për të zhvlerësuar monedhën vendase dhe 5.6 për qind nuk jep opinion.

Pyetja 25, kërkon të dijë opinionin e zyrave mbi peshën që ka monedha europiane, euro, dhe si ka ecur ajo duke krahasuar vitin 2000 me vitin 1999. **55.6 për qind e zyrave shprehen se nuk mendojnë se euro si monedhë është fuqizuar në tregun shqiptar gjatë vitit 2000** në raport me vitin 1999, 33.3 për qind nuk japin opinion, ndërsa 11.1 për qind mendojnë se po.

II. 5. Konkluzione.

Zyrat e këmbimeve valutore që veprojnë në Shqipëri janë, krahas bankave tregtare, një tjetër operator i rëndësishëm dhe profesional i tregut valutor.

II. 5. 1. Gjeografia e transaksioneve.

Sipas mendimit të zyrave, gjeografia e transaksioneve valutore që kryhen është e ngjashme me atë të bankave përsa i përket dy shteteve kryesore dhe orientohet me Italinë dhe Greqinë (44.5 për qind të rasteve). Megjithatë, në banka ky orientim është më i fortë se sa në zyra. Ndërsa si shtet i tretë i rëndësishëm për zyrat renditet Turqia në ndryshim nga bankat të cilat rendisnin Gjermaninë.

II. 5. 2. Monedha e huaj më e preferuar.

Zyrat e këmbimit konfirmojnë se më shpesh ato operojnë me dollarin amerikan, duke qenë më unike se sa bankat në këtë deklaram. Të rëndësishme për transaksionet valutore janë edhe marka gjermane dhe lireta italiane, duke patur përsëri një shpërndarje më të ndryshme në krahasim me bankat tregtare, të cilat rendisin të dytën liretën italiane dhe drahminë greke të tretën. Dollari amerikan konsiderohet si monedhë e qëndrueshme dhe e preferuar për transaksionet valutore. Preferenca për dy vitet e fundit (1999 - 2000) për këtë monedhë mbetet e fortë, megjithëse në vitin 2000 kjo preferencë është reduktuar lehtë. Dollari amerikan paraqitet si monedhë orientuese për vendimmarrje, madje konsiderohet prej zyrave si monedha më e përshtatshme për shit-blerje në tregun valutor nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Përsa i përket monedhës europiane, euro, mbi gjysma e zyrave mendojnë se ajo nuk është fuqizuar në dy vitet e fundit në tregun shqiptar.

II. 5. 3. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore.

Në ndryshim nga opinioni i bankave për tregun jozyrtar, shumica e zyrave shprehet se tregu jozyrtar është i nevojshëm për shkak të shpejtësisë me të cilën përfundohen transaksionet në këtë treg dhe kurseve më të favorshme që ofron.

Aktiviteti valutor në këtë treg rezulton të jetë rritur në raport me bankat. Nga përgjigjet e zyrave, konfirmohet rezultati i dhënë nga bankat, sipas të cilave tregu jozyrtar në aktivitetin e tij orientohet nga tregjet ndërkombëtare.

II. 5. 4. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e bankës qendrore.

Përsa i takon pranisë së Bankës së Shqipërisë në tregun valutor, përgjithësisht zyrat nuk kanë dhënë opinion, gjë që flet për një njohje të paktë të politikës dhe të veprimeve të Bankës së Shqipërisë nga ana e këtij operatori.

Nga shqyrtimi i përgjigjeve të grupit që ka shprehur një opinion rezulton se:

- * gjysma e zyrave e konsiderojnë të përshtatshëm regjimin e kursit të këmbimit në Shqipëri;
- * pjesa më e madhe mendon se Banka e Shqipërisë vepron në momentin e përshtatshëm;
- * pjesa më e madhe mendon se Banka e Shqipërisë kur vepron realizon qëllimin e saj.

Ashtu si bankat tregtare, edhe zyrat sugjerojnë që shit-blerjet në tregun valutor duhen bërë në dollarë amerikanë. Por, në ndryshim nga bankat, zyrat shprehen se shit-blerjet e Bankës së Shqipërisë duhet të kenë si qëllim vlerësimin e monedhës së vendit.

II. 5. 5. Aktiviteti valutor i zyrave të këmbimit valutor.

Informacioni i paraqitur i zyrave tregon se ato kryejnë rreth 11 transaksione në ditë me vlerë mesatare, që varion nga 400 dollarë amerikanë në 121 mijë dollarë amerikanë. Kjo do të thotë që, në një vit, të gjitha zyrat e këmbimit qarkullojnë për qëllime të këmbimeve valutore një sasi prej 97 milionësh dollarë amerikanë.

Në përfundim, konkludohet që zyrat e këmbimit valutor, ashtu si dhe bankat, konsiderojnë dollarin amerikan si monedhë të qëndrueshme dhe orientuese në vendimet e tyre dhe mendojnë që euro nuk e ka fuqizuar peshën e saj në tregun shqiptar.

Pyetësori për zyrat e këmbimit valutor (ZKV).

A. Informacione të përgjithshme

Pyetja 1. Cili është vendi kryesor i huaj me të cilin mendoni se kryhet shumica e transaksioneve? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Itali	1
Greqi	2
Turqi	3
Gjermani	4
Bullgari	5
Maqedoni	6
Të tjerë	8

Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 2.. Cila është monedha me të cilën operoni më shpesh? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4
Te tjera	6

Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 3. Sa transaksione valutore në ditë kryeni mesatarisht?

Deri 10	1
10-20	2
20-30	3
30-40	4
40-50	5
50 e lart	6

Pyetja 4. Sa është vlera mesatare për çdo transaksion në dollarë amerikanë?

Pyetja 5. Preferoni të këmbeni paratë tuaja: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Në bankë?	1
Në ZKV?	2
Në tregun informal (kambistë të lirë)?	3
Kombinim i varianteve të mësipërme?	4

Pyetja 6. Jepni arsyen/et për zgjedhjen në pyetjen 5.

!_!

B. Opinione për organizimin e tregut valutor

Pyetja 7. Cila mendoni se është valuta më e qëndrueshme tek ne ? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 8. Jepni arsyen për zgjedhjen në pyetjen 7.

!_!

Pyetja 9. Cila monedhë e huaj përbën pikën orientuese në aktivitetin tuaj? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 10. A e vlerësoni të nevojshëm tregun informal të këmbimit valutor?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 11. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 10.

!_!

Pyetja 12. Cili është, sipas mendimit tuaj, kursi mbi të cilin bazohet vendosja e kurseve të këmbimit në tregun jozyrtar të këmbimeve valutore?

!_!

Pyetja 13. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryenit në tregun jozyrtar në vitin 1999, krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Më i madh	1
Më i vogël	2
Nuk ka ndryshuar	3
Nuk e di	4

Pyetja 14. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryeni aktualisht në tregun jozyrtar (në vitin 2000), krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

- | | |
|------------------|---|
| Më i madh | 1 |
| Më i vogël | 2 |
| Nuk ka ndryshuar | 3 |
| Nuk e di | 4 |

Pyetja 15. Mendoni se pjesa e tregut të kembimeve valutore e zotëruar nga ZKV, në këto dy vitet e fundit ka ardhur: (Për secilin moment kohor zgjidhni vetëm një mundësi.)

viti 1999		viti 2000	
në rritje?	1	në rritje?	1
në rënie?	2	në rënie?	2
nuk ka ndryshuar?	3	nuk ka ndryshuar?	3
nuk e di?	4	nuk e di?	4

Pyetja 16. Cila është valuta me të cilën ju keni preferuar të operoni dhe preferoni aktualisht të operoni më shpesh? (Për secilin moment kohor mund të zgjidhni më shumë se një nga nga valutat e mëposhtme.)

viti 1999		viti 2000	
Dollari amerikan	1	Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2	Lireta italiane	2
Marka gjermane	3	Marka gjermane	3
Drahamia greke	4	Drahamia greke	4

C. Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë.

Pyetja 17. A ju krijon përparësi në punën tuaj regjimi aktual i kursit të këmbimit? (Të jepet një sqarim për këtë regjim.)

- | | |
|------------|---|
| Po | 1 |
| Jo | 2 |
| Pa opinion | 3 |

Pyetja 18. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 17.

!_!

Pyetja 19. A mendoni se shit-blerjet valutore të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor për ndryshimin e kursit të këmbimit, kryhen në momentin e përshtatshëm?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 20. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 19.

_____ !_!

Pyetja 21. A mendoni se nga këto transaksione ajo ia arrin qëllimit?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 22. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 21.

_____ !_!

Pyetja 23. Cila do të ishte, sipas mendimit tuaj, monedha më e përshtatshme për të kryer transaksione në treg? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4

Pyetja 24. Për ç'qëllim duhet të veprojë në treg Banka e Shqipërisë?

Zhvlerësim	1
Vlerësim	2
Ruajtje të një kursi stabël	3
Pa opinion	4

Pyetja 25. Mendoni se euro është fuqizuar në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999?

Po	1
Jo	2
Nuk ka ndryshuar	3
Nuk e di	4

Faleminderit për bashkëpunimin!

KAPITULLI III: REZULTATET E DALA NGA PËRPUNIMI I INFORMACIONIT TË PYETËSORIT PËR KAMBISTËT E LIRË.

III.1. Informacion i përgjithshëm.

Vrojtimi për këtë operator u krye me zgjedhje. Gjithsej janë intervistuar 50 individë, që zhvillojnë aktivitetin e këmbimit valutor në tregun paralel. Intervistimi i kësaj kategorie paraqet një rëndësi të veçantë pasi ata janë operatorë të këtij tregu (që për thjeshtësi do t'i referohemi si "tregu jozyrtar") dhe për pasojë jep informacion mjaft të vlefshëm dhe interesant.

Meqenëse vrojtimi për këtë grup u bë me zgjedhje, u synua realizimi i një përfaqësueshmërie reale në zgjedhje. Nga informacione dhe investigime paraprake¹⁴ lidhur me organizimin e këtij tregu në qytetin e Tiranës, në këtë treg veprojnë dukshëm rreth 200 persona. Kështu, zgjedhja prej 50 kambistësh të lirë, do të përbënte rreth 25 për qind të totalit të vlerësuar nga burime informacioni të ndryshme dhe që kanë konfirmuar pothuajse të njëjtat shifra për këtë treg. Problemi i mungesës së informacionit të zyrtarizuar për ta, si të regjistruar për aktivitetin që kryejnë, bëri që përzgjedhja e tyre të bëhej në vendin (fizik), ku ata zhvillojnë këtë aktivitet. Veç kriterit të vëllimit të tyre (50), duke shfrytëzuar gjithë të dhënat e grumbulluara paraprakisht rreth këtij tregu, u kërkua që kjo zgjedhje të kishte si qëllim vjeljen e të dhënave prej dy grupeve kryesore:

- grupit që zhvillon këmbimin me shumicë të parasë në këtë treg (35 të tillë);
- grupit që zhvillon këmbimin me pakicë të parasë në këtë treg (15 të tillë).

Si kriter për këtë ndarje u përdor vendndodhja e tyre në tregun fizik (të dukshëm).

Dhënia e një peshe të konsiderueshme (70 për qind), në zgjedhjen e kambistëve, që konsiderohen të zhvillojnë këmbime me shumicë në tregun valutor jozyrtar, justifikohet me faktin se, në kuadrin e përgjithshëm, qëllimi i vrotimit, fokusohet në mbledhjen e opinioneve rreth kursit të këmbimit, mënyrës se si ky i fundit vendoset në këtë treg, se ç'mendojnë kambistët rreth monedhave të qëndrueshme e orientuese si edhe disa opinione të tyre rreth politikës valutore të bankës qendrore. Kështu, kambistët, që zhvillojnë këmbime me shumicë, janë më në brendësi të problemeve të mësipërme, ndaj edhe opinionet e tyre dhe vlerësimet tona lidhur me këto opinione janë më reale. Ndërkohë që edhe nga grupi i kambistëve, që zhvillojnë këmbime me pakicë, dhe që në zgjedhje vlerësohen të zënë 30 për qind të këtij operatori të intervistuar, janë vjelë opinionet e mësipërme. Përpunimi i të dhënave nga të dyja grupet së bashku, mund të çojë në përgjithësi interesante përsa i takon opinioneve të tyre rreth kursit të këmbimit, mënyrës së organizimit të këtij tregu, përse jo edhe vëllimit

¹⁴ Investigimet janë kryer nga specialistë të Departamentit të Kërkimeve, në Bankën e Shqipërisë, për të marrë disa informacione paraprake lidhur me organizimin e tregut jozyrtar si edhe numrin e personave që punojnë (madhësinë) dukshëm në këtë treg. Këto të dhëna kanë shërbyer, për ndërtimin e strukturës së zgjedhjes dhe madhësisë së saj në këtë vrotim, si edhe në hartimin e pyetësorit përkatës.

total të transaksioneve që realizohen në këtë treg përgjatë periudhave të caktuara kohore. Realizimi i një vlerësimi të tillë është deri diku i mundur, sepse tregu jozyrtar është i organizuar në mënyrë të tillë, që në duart e tregtarëve (kambistëve) me shumicë, finalizohen pothuajse të gjitha këmbimet valutore. Kjo do të thotë që edhe kambistët e pakicës, pasi kanë grumbulluar në duart e tyre sasira të caktuara monedhash, i këmbajnë përfundimisht ato tek kambistët më shumicë. Nga ana tjetër, tregu jozyrtar i këmbimeve valutore, ka si qendër kryeqytetin. Pra, edhe gjeografikisht, agumentohet një zgjedhje, në favor të kambistëve të shumicës të qytetit të Tiranës.

Lidhur me qëllimin e vrojtimit, zgjedhja e këtij grupi në këtë mënyrë, mundësoi përmbushjen, deri diku të kënaqshme, të të dy kritereve themelore në zgjedhje: sasisë dhe përfaqësueshmërisë.

III. 2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme".

Rubrika A përbëhet nga 9 pyetje dhe synon të marrë informacion të përgjithshëm mbi monedhën/monedhat me të cilën/cilat kryhen transaksionet, vlerësime sasiore mbi numrin e transaksioneve dhe vlerën mesatare të transaksioneve si dhe operatorin/operatorët më të preferuar për të kryer veprime.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së parë ka rezultuar:

Pyetja 1, kërkon të dijë se për sa kohë të intervistuarit zhvillojnë këtë aktivitet. Përvoja e tyre në tregun jozyrtar është një element që siguron garanci për përgjigje nisur nga pozita të personit të mirëinformuar.

Tabela 31: Shpërndarja e kambistëve sipas përvojës në aktivitetin e kambizmit.

Përvoja (në vite)	Përgjigjet (në %)*
Deri në 1	8
1 – 3	14
3 – 5	22
5 – 7	10
Mbi 7	46

Shënim: *Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50.

Vërehet se më shumë se gjysma (56 për qind) e të intervistuarve kanë mbi pesë vjet aktivitet në këtë treg dhe gati gjysma mbi 7 vjet. **Përvoja mesatare e të intervistuarve rezultoi 5.5 vjet.** Kjo përvojë konsiderohet si një tregues i kënaqshëm për të përftuar informacion nga individë, që janë njohës të mirë të organizimit të këtij tregu dhe të tregut valutore në tërësi¹⁵.

¹⁵ Rezultatet e zgjedhjes na çojnë në përllogaritjen e intervalit të besimit për përvojën mesatare të të gjithë kambistëve, që vepron në tregun jozyrtar. Ky tregues luhet në kufijtë 4.5 - 6.2 vjet dhe është llogaritur me një koeficient besueshmërie 95 për qind.

Pyetja 2, kërkon të dijë nëse individët që veprojnë në tregun jozyrtar qarkullojnë fonde të tjerëve apo punojnë për vete. Ky klasifikim u bë pasi nga informacione paraprake u mësua se, tregu jozyrtar ka dy lloj operatorësh: të dukshëm fizikisht, të cilët punojnë për vete apo për të tretë dhe të padukshëm fizikisht, të cilët angazhojnë të tretë për veprimtarinë valutore. Megjithatë, përgjigjet e dhëna nuk e konfirmojnë këtë informacion. Pa përjashtim, **të gjithë të intervistuarit deklarojnë se punojnë për veten e tyre.**

Pyetja 3, ka për qëllim të identifikojë valutën me të cilën operohet më shpesh nga kambistët. Për këtë arsye, pyetja 2 lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Rezulton, që **gati gjysma e kambistëve i kryejnë transaksionet në dollarë amerikanë.** Në vend të dytë deklarohet dhrahmia greke, ndërsa për liritën italiane dhe markën gjermane deklarohen i njëjti numër kambistësh. Katër kambistë janë përgjigjur se përdorin edhe monedha të tjera, të cilat i cilësojnë si monedha të rralla dhe rendisin monedhën angleze, franceze dhe austriake.

Tabela 32: Shkalla e përdorimit të valutave me të cilat kryhen transaksionet valutore.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	48
Lireta italiane	28
Marka gjermane	28
Dhrahmia greke	32
Të tjera	8

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e kambistëve të përgjigjur, 50. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Pyetja 4, është një pyetje që kërkon të marrë informacion sasior mbi numrin mesatar ditor të transaksioneve të kryera nga secili kambist. Ofrohen për përgjigje pesë alternativa, por lejohet zgjedhja vetëm e njëjës. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur një numër mesatar të transaksioneve valutore të kryera nga kambistët në një njësi kohe të caktuar.

Tabela 33: Shpërndarja e kambistëve sipas numrit mesatar të transaksioneve ditore.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	Frekuenca kumulative rritëse (në %)
Deri në 1	2	2
1 – 3	28	30
3 – 5	32	62
5 – 7	12	84
Mbi 7	26	100

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e kambistëve të përgjigjur, 50.

Nga përgjigjet rezulton se **në shumicën e rasteve (62 për qind) kryhen nga 1 deri në 5 transaksione në ditë.** Megjithatë, pjesa më e madhe e kambistëve (84 për qind) kryejnë deri në 7 transaksione në ditë.

Box 5: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për zyrat në njësinë e kohës.

I. Në një ditë numri mesatar i transaksioneve është rreth 4.7.


II. Në një muaj numri mesatar i transaksioneve është rreth 103 (numri i ditëve të punës në një muaj është marrë 22).

III. Në një vit numri mesatar i transaksioneve është rreth 1241 (numri i ditëve të punës në një vit është marrë 264).

Pyetja 5, si edhe pyetja 4 kërkon të marrë informacion sasior mbi vlerën mesatare të një transaksioni të shprehur në dollarë amerikanë. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur vlerën mesatare të një transaksioni valutor të tregut jozyrtar valutor. Karakteristikë e vërejtur nga përgjigjet e kambistëve është gjerësia e madhe e variacionit, kufijtë e së cilës variojnë nga 50 dollarë amerikanë (vlera më e ulët e deklaruar) në 175 mijë dollarë amerikanë (vlera më e lartë e deklaruar). Kjo tregon që tregu jozyrtar është i ndërtuar me kambistë "të vegjël", "të mesëm" dhe "të mëdhenj". Për efekte llogaritjeje janë bërë këto grupime sipas klasifikimit të mësipërm:

Tabela 34: Shpërndarja e kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni.

Dollarë amerikanë	Rastet e përgjigjeve
50	1
100	1
Deri në 100	2
145	1
146	1
200	2
300	3
600	1
700	2
900	1
1000	2
100-1000	13
1200	1
1300	1
1450	1
1500	3
2000	3
2500	1
3000	3
4000	1
5000	7
10000	4
1000-10000	25
17500	2
20000	3
30000	1
40000	1
10000-100000	7
150000	2
175000	1
Mbi 100000 apo mbi 150000	3



Meqenëse rreth 80 për qind e kambistëve kryejnë këmbime valutore me vlera mesatare deri në 10 mijë dollarë amerikanë, atëherë forma e përqendrimit të tyre deri në këtë vlerë të këmbimeve paraqet interes të qartësohet.




Tabela 35: Grupimi i kambistëve sipas vlerës mesatare të një transaksioni.

Dollarë amerikanë	Përgjigjet (në %)*
Deri në 100	4
100 – 1000	26
1000 – 10000	50
10000 – 100000	14
Mbi 100000	6
Totali	100.0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin e kambistëve të përgjigjur, 50.

Vërehet se gjysma e kambistëve kryejnë këmbime me vlerë mesatare deri në 10000 dollarë amerikanë për një transaksion. Shumica e kambistëve (76 për qind) kryejnë transaksione me vlerë mesatare në intervalin 100 deri në 10

mijë dollarë amerikanë. Ndërsa, numri i kambistëve që kryejnë transaksione në vlera mjaft të mëdha (mbi njëqindmijë dollarë amerikanë) është me 2 pikë përqindjeje më i lartë se ata që kryejnë transaksione në shuma mjaft të vogla.

Tabela 36: Vlerat mesatare për një transaksion.

Dollarë amerikanë	Në dollarë amerikanë
Deri në 100 (mjaft të vogla)	75
100 – 1000 (të vogla)	500
1000 – 10000 (të mesme)	4 198
10000 – 100000 (të mëdha)	23 571
Mbi 100000 (mjaft të mëdha)	158 333

Kombinimi i rezultateve të përgjigjeve të dhëna për pyetjet 4 dhe 5, siguron një informacion rreth vëllimit total të transaksioneve që kryejnë kambistët në njesinë e kohës.

Tabela 37: Vëllimi total mesatar i transaksioneve sipas grupeve (në usd)*.

Grupet	Në ditë	Në muaj	Në vit
Deri në 100 (mjaft të vogla)	353	7 725	93 075
100 – 1000 (të vogla)	2 350	51 500	620 500
1000 – 10000 (të mesme)	19 521	432 394	5 209 718
10000 - 100000 (të mëdha)	110 788	2 427 850	29 252 107
Mbi 100000 (mjaft të mëdha)	744 170	16 308 300	196 491 250

Shënim: *Llogaritjet në tabelë janë bërë për kambistët e intervistuar.

Vërehet që për një vit kambistët realizojnë, sipas grupeve të klasifikuara, një volum transaksionesh valutore, që varion nga afërsisht 93 mijë dollarë amerikanë në afërsisht 196 milionë.

Meqenëse, vlerësimi mësipër shtrihet në një interval shumë të gjerë, për shkak të variacionit shumë të madh të vlerave që ai merr në konsideratë, është gjykuar që vlerësimi mbi vëllimin total vjetor të transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar, të zbatohet mbi grupin e kambistëve që veprojnë me shuma mjaft të mëdha. Këto rezultate përgjithësohen për të gjithë kambistët, që veprojnë dukshëm në tregun jozyrtar. Rezulton se volumi i transaksioneve gjatë një viti në këtë treg luhatet në rreth 2.4 miliardë dollarë amerikanë.

Pyetja 6, kërkon të dijë se ç'pjesë e të ardhurave të kambistëve kursehen. Ofrohen pesë alternativa dhe lejohet zgjedhja e vetëm njëjës. Nga përgjigjet rezulton se **gjysma e kambistëve kursejnë deri në 10 për qind të të ardhurave mujore dhe shumica (84 për qind) kursejnë deri në 20 për qind.**

Në intervalet e përgjigjes, vërehet që të dyja ekstremet kanë peshë relativisht të konsiderueshme. Ka mjaft kambistë që deklarojnë se nuk kursejnë dhe po, relativisht konsiderueshëm, që deklarojnë se kursejnë mbi 50 për qind të të ardhurave mujore.

Tabela 38: Shpërndarja e kambistëve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave.

Koeficienti i kursimit	Përgjigjet (në %)*	Frekuenat kumulative rritëse në (%)
0	22	22
0 – 10	52	74
10 – 20	10	84
20 – 30	2	86
30 – 40	2	88
40 – 50	0	88
Mbi 50	12	100

Shënim: *Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50.

Interesant është fakti që shumtë mesatare të një transaksioni, të klasifikuara si mjaft të vogla dhe të vogla kryhen nga persona me përvojë deri në 3 vjet dhe janë po këta persona që kursejnë deri në masën 20 për qind. Këta përbëjnë rreth 25 për qind të të intervistuarve. Ndërkohë, transaksionet e klasifikuara si të mesme kryhen nga pothuaj të gjitha kategoritë e përvojave pa nënvizuar ndonjë ligjësi të spikatur. Në këtë grup, si edhe në kategorinë e mësipërme, mbizotëron prirja për të kursyer deri në 20 për qind. Këta përbëjnë rreth 56 për qind të rasteve.

Në 9 raste, apo në 90 për qind të vrojtimit të transaksioneve të mëdha dhe shumë të mëdha, përvoja rezulton mbi 5 vjet. Në këto raste niveli i kursimit luhet deri në 30 për qind. Në veçanti, për grupin e transaksioneve të klasifikuara si "shumë të mëdha" kursimi shkon deri në masën 10 për qind. Në një rast nga grupi i "të mëdhenjve" deklarohet se "nuk kursehet". Përsa i takon përvojës, për këtë grup, në dy raste ajo kalon 7 vjet dhe në një rast luhet në kufirin 3 - 5 vjet.

Pyetja 7, kërkon të marrë informacion mbi monedhën që preferohet për të mbajtur kursimet. **Monedha më e preferueshme paraqitet dollari amerikan e më pas marka gjermane.** Ndërsa monedha e vendit, leku, renditet e treta.

Tabela 39: Shpërndarja e preferencave për kursim sipas monedhave.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	48
Lireta italiane	14
Marka gjermane	28
Dhrahmia greke	6
Leku shqiptar	18
Të tjera	2

Shënim: *Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Pyetja 8, kërkon të zbulojë se cili/cilët operator/operatorë preferohen për të kryer veprimtari valutore. Nga përgjigjet rezulton se **shumica e kambistëve, 76 për qind, punojnë me tregun jozyrtar, pra me kambistë të tjerë**, 2 për qind me banka, 4 për qind me zyra të këmbimit valutor dhe pjesa që mbetet (18 për qind) i kombinojnë operatorët.

Pyetja 9, kërkon të dijë arsyet që çojnë kambistët në kryerjen e transaksioneve me operatorët e tyre të preferuar. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 49 kambistë (98 për qind e të pyeturve).

- * 59.2 për qind e kambistëve e zgjedhin operatorin e tyre nisur nga fitimi më i lartë që sigurojnë. Të gjithë këta kambistë kanë deklaruar se veprojnë vetëm në tregun jozyrtar, domethënë me kambistë të tjerë;
- * 22.4 për qind e kambistëve e zgjedhin operatorin e tyre nisur nga shpejtësia që i ofrohet në kryerjen e transaksionit. Të gjithë këta kambistë kanë deklaruar se veprojnë vetëm në tregun jozyrtar, domethënë me kambistë të tjerë;
- * 16.3 për qind e kambistëve e zgjedhin operatorin nisur nga kushti i sigurisë. Në këtë grup shumica e kambistëve veprojnë me banka dhe zyra, pra me operatorë zyrtarë;
- * 8.2 për qind e kambistëve shprehin se operatori që ka zgjedhur ka më shumë klientë, pra ofron një treg më likuid. Edhe në këtë alternativë të gjithë kambistët veprojnë në tregun jozyrtar;
- * 4.1 për qind e kambistëve e zgjedhin operatorin e tyre pasi pranojnë transaksione në *cash*. Ky arsyetim jepet për zyrat e këmbimit.

III. 3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor".

Rubrika B përbëhet nga 10 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi organizimin e tregut valutor në vend, si është ecuria e tij dhe si kanë ndryshuar raportet në rëndësinë që kanë operatorë apo valuta të ndryshme në këtë treg në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999.

Kjo rubrikë përmban dhe dy pyetjet thelbësore që në fakt përbëjnë dhe qëllimin e vrojtimit (pyetjet 10 dhe 12). Ato kanë të bëjnë me identifikimin e monedhës më të qëndrueshme dhe të monedhës orientuese për vendimet ekonomike të kambistëve që zhvillojnë aktivitet në tregun jozyrtar.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së dytë ka rezultuar:

Pyetja 10, kërkon që kambistët të identifikojnë monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Ofrohen pesë alternativa (monedha) dhe lejohet dhe zgjedhja e më shumë se një prej tyre.

Tabela 40: Shpërndarja sipas valutave më të qëndrueshme.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	68
Lireta italiane	10
Marka gjermane	14
Dhrahmia greke	8
Të tjera	8

Shënim: *Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Për shumicën e kambistëve dollari amerikan është monedha më e qëndrueshme. Ndërsa në grupin e monedhave të tjera renditet monedha angleze.

Pyetja 11, kërkon që kambistët të japin arsyet për zgjedhjen e tyre në pyetjen 10, monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 48 kambistë ose 96 për qind e të intervistuarve. Arsyet kryesore që renditet në zgjedhjen e bërë nga kambistët del "siguria dhe qëndrueshmëria që ofron monedha e zgjedhur e mbështetur nga fuqia ekonomike e vendit përkatës". Kjo arsye deklarohet nga 37 kambistë ose 77.1 për qind e të përgjigurve. 6 kambistë (12.5 për qind e të përgjigurve) arsyetojnë se monedha që ata kanë zgjedhur ka volum të madh qarkullimi. Dy kambistë shprehen se kanë zgjedhur këtë monedhë për shkak të lëvizjes së lartë të mallrave dhe të turistëve. Renditen dhe arsye të tilla si "është jashtë sistemit të euro-s" apo "është pjesë e euro-s" etj..

Interesante është të shihen detajimet sipas monedhave brenda secilës arsye. Kështu, 34 kambistë konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën më të qëndrueshme, duke paraqitur edhe deklarata të tilla si "mbizotëron në tregun botëror", "mbizotëron ndaj euro-s" etj.. Në dy raste si monedhë e qëndrueshme konsiderohet marka gjermane, madje duke u shprehur se "është monedha më e fuqishme e euro-s" dhe në një rast konsiderohet monedha angleze.

Përsa i takon arsyet që renditet e dyta, në katër raste kambistët janë shprehur se zgjedhin liretën italiane pasi qarkullimi i lartë i saj sigurohet nga numri i madh i emigrantëve. Po kjo arsye në një rast jepet për dhrahminë greke dhe në një rast për markën gjermane.

Të dyja rastet që shprehen për dhrahminë greke e justifikojnë me arsyen se ka lëvizje mallrash dhe se turistët e preferojnë këtë monedhë më shumë.

Pyetja 12, kërkon që kambistët të identifikojnë monedhën orientuese për të marrë vendime. Ofrohen pesë alternativa (monedha) dhe lejohet zgjedhja e më shumë se njëres prej tyre.

Tabela 41: Shpërndarja sipas valutave orientuese.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	68
Lireta italiane	12
Marka gjermane	16
Dhrahmia greke	12
Të tjera	0

Shënim: *Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Në shumicën e përgjigjeve të kambistëve (34 të tillë) deklarohet se monedha orientuese është dollari amerikan. Ky konkluzion është në harmoni me atë të pyetjes 10. Dollari konsiderohet monedhë e qëndrueshme dhe si i tillë ofron dhe monedhën orientuese për vendimet që marrin kambistët në zhvillimin e aktivitetit të tyre valutor.

Pyetja 13, dhe katër pyetjet vijuese, përqendrohen në marrjen e informacionit mbi tregun jozyrtar të këmbimeve valutore. Pyetja është e thjeshtë dhe kërkon të dijë nga vetë “elementet” e këtij tregu nëse e konsiderojnë, për kushtet e Shqipërisë, ekzistencën e tregut jozyrtar të këmbimeve valutore të nevojshme apo jo. **Shumica (96 për qind e tyre), siç pritej, e konsiderojnë tregun të nevojshëm**, 2 për qind të panevojshëm dhe këta kambistë veprojnë me bankën dhe 2 për qind nuk japin opinion.

Pyetja 14, kërkon të dijë arsyet për përgjigjet e dhëna nga kambistët në pyetjen më sipër. Janë përgjigjur të 49 kambistët, që duhej të jepnin përgjigje, pra 100 për qind e tyre. Kambistët që shprehen se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore është i nevojshëm japin arsye prej të cilave përfitohet një informacion shumë i vlefshëm. Për qëllime analize, arsyet e ngjashme janë grupuar. Megjithatë, për të thithur sinjalet e dobishme të këtyre përgjigjeve, në vijim identifikohen edhe disa deklarime të veçanta mbi të cilat banka qendrore dhe tregu zyrtar duhet të reflektojnë. Një kambist që shprehet se tregu jozyrtar i këmbimeve valutore është i panevojshëm e arsyeton me faktin që tregu varet nga zhvillimi në tregjet ndërkombëtare.

Tabela 42: Arsyet pro ekzistencës së tregut jozyrtar.

Arsyeja	Numri i përgjigjeve (raste)
Është treg ku veprohet me leverdi	14
Krijon mundësi punësimi	10
Është treg likuid, pra ofron në çdo moment mundësi të realizimit të transaksionit	9
Është një treg real	8
Shpejtësi veprimi	7
Mungesa e fleksibilitetit nga operatorët zyrtarë (banka&zyra)	7
Është konkurrues i tregut zyrtar	4
E kërkojnë individët dhe tregtarët	1
Përvoja	1
Bëhet pastrim parash	1

Në tërësi, **ajo ç'ka e bën të nevojshëm këtë treg për kambistët është fitimi që sigurohet në të si për operatorët ashtu edhe për "klientët" e tyre.** Përveç kësaj, dukshëm del në pah fakti që **në këtë treg ka arritur të sigurojë të ardhura për jetesën një pjesë e të papunëve në Shqipëri.**

Në grupin e kambistëve që shprehen se është treg likuid, një kambist deklaron se në të mund të kryesh transaksione edhe me vlera të vogla.

Grupi i kambistëve që shprehet se nuk ka fleksibilitet nga operatorët zyrtarë deklaron se bankat dhe zyrat ende nuk janë në gjendje të përballojnë fluksin e këmbimit të monedhës dhe nuk kanë aftësi t'u përgjigjen nevojave të klientëve. Një kambist thekson se ka aktivitet më të lartë se të gjitha bankat dhe zyrat apo një tjetër që është i fuqishëm. Ndërsa një kambist ka deklaruar se "dikur në tregun jozyrtar bëheshin 80-90 për qind të lëvizjes së monedhës, ndërsa tani vetëm 50 për qind".

Në disa raste kambistët e justifikojnë ekzistencën e këtij tregu me ushqimin që ai merr nga emigrantët.

Të gjithë ata kambistë që zgjedhin tregun jozyrtar e justifikojnë këtë zgjedhje me arsyen e shpejtësisë së veprimit në këtë treg dhe të fitimit më të lartë që sigurohet.

Ata kambistë që paraqesin si arsye punësimin duke i studjuar sipas klasës që zënë në piramidën e tregut kanë këtë shpërndarje:


- 5 kambistë i përkasin klasës që vepron me shuma mjaft të vogla;
- 4 kambistë i përkasin klasës që vepron me shuma të vogla dhe një me shumë të madhe.

Pyetja 15, kërkon të dijë mbi ç'bazë përcaktohet kursi i këmbimit në tregun jozyrtar sipas opinionit të vetë kambistëve. Me fjalë të tjera, u kërkohet kambistëve të deklarojnë kursin të cilit ata i referohen. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 46 kambistë (ose 92 për qind e të intervistuarve). **Të 46 kambistët deklarojnë si referencë të parë kursin në tregjet ndërkombëtare**, madje në një rast është thënë se i referohen kurseve që jepen në kanal televiziv "Euroneës". 11 kambistë shprehen se kursi përcaktohet në bazë të kërkesës dhe të ofertës për valutë. Një kambist shprehet se kursi përcaktohet edhe në bazë të situatës politike dhe një tjetër se i referohet kursit që deklaron Banka e Shqipërisë.

Pyetjet 16 dhe 17 janë identike. Ato kërkojnë të dinë raportin e vëllimit të transaksioneve që kryhen në tregun jozyrtar me atë të bankave për vitin 1999 dhe vitin 2000. Analizimi i këtyre dy pyetjeve siguron edhe vlerësimin e zhvillimit të këtyre dy tregjeve nga operatorët e tregut jozyrtar.

Tabela 43: Evolucionit i raportit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Më i madh	42	34
Më i vogël	40	52
Nuk ka ndryshuar	2	2
Nuk e di	16	12




Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë se **situata, sipas opinionit të kambistëve, është përmirësuar**. Rezulton që numri i kambistëve që shprehen se në vitin 1999 vëllimi i transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar është më i madh se në tregun bankar, është 8 pikë përqindjeje më i madh se në vitin 2000. Ndërkohë është rritur me 12 pikë përqindjeje numri i kambistëve që shprehet se tregu jozyrtar është më i vogël se ai bankar në vitin 2000 krahasuar me 1999. Një kambist është shprehur se nuk mund të bëjë krahasim pasi nuk njih volumin e transaksioneve të kryera nga bankat. Ky është një sinjal që nënkupton dhënien e më shumë informacioneve për aktivitetin bankar. Në këtë mënyrë të gjithë operatorët do të jenë të informuar në mënyrë të padiskriminuar duke çuar në përsosje të tregjeve.

Pyetja 18, është e ngjashme me pyetjet 16 dhe 17, pasi kërkon të dijë ecurinë e vëllimit të transaksioneve, që kryen zyrat e këmbimeve valutore për vitin 1999 dhe për vitin 2000.

Tabela 44: Evolucionit i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të zyrave të këmbimit valutore.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Në rritje	46	46
Në rënie	26	28
Nuk ka ndryshuar	20	18
Nuk e di	8	8



Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet vërejmë se **situata, sipas opinionit të vetë kambistëve, ka një përkeqësim shumë të lehtë**. Opsionit që pesha e zyrave të këmbimit valutor ka ardhur në rritje i përgjigjen i njëjti numër kambistësh. Ndërkohë rritet me 2 pikë përqindjeje numri i kambistëve që mendon se është në rënie.


Ky konkluzion, i kombinuar dhe me konkluzionin e pyetjeve 16 dhe 17, jep sinjale që po ulet shumë pak pesha e njërit operator zyrtar, zyrave, duke u rritur pesha e operatorit tjetër, bankave.

Pyetja 19, është e ngjashme me tri pyetjet e mësipërme, pasi kërkon të dijë valutën më të preferuar për këmbime valutore për vitin 1999 dhe vitin 2000 nga kambistët.

Tabela 45: Evolucionin e preferencës për valutat.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	
	1999	2000
Dollari amerikan	42	54
Lireta italiane	22	18
Marka gjermane	20	16
Dhrahmia greke	22	18

Shënim: * Llogaritur mbi numrin kambistëve të përgjigjur, 50. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.



Sipas opinionit të kambistëve, **dollari amerikan në të dy vitet mbetet monedhë e preferuar, madje preferenca për të ka ardhur duke u shtuar.** Një shpërndarje, pak a shumë uniforme, vërehet për tri monedhat e tjera dhe preferenca për secilën prej tyre ka rënë me 4 pikë përqindjeje.

III. 4. Pyetjet e rubrikës C "Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë".

Rubrika C përbëhet nga 9 pyetje dhe synon të marrë opinione mbi politikën valutore të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe përshtatshmërinë e regjimit të kursit të këmbimit që zbatohet në Shqipëri. Banka e Shqipërisë është e interesuar që të dijë se si perceptohet politika e saj edhe nga operatorët jozyrtarë të tregut.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së tretë ka rezultuar:

Pyetja 20, kërkon të zbulojë se si konsiderohet regjimi aktual i kursit të këmbimit nga operatorët jozyrtarë. Rezulton se **mbi gjysma e kambistëve (64 për qind) shprehen se ky regjim krijon përparësi në punën e tyre**, 18 për qind përgjigjen se nuk krijon përparësi dhe pjesa tjetër, 18 për qind, nuk ka dhënë opinion.

Pyetja 21, nisur nga rëndësia që ka regjimi i kursit të këmbimit, kërkon arsyen se përse kambistët e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo këtë regjim. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 38 kambistë ose 92.7 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Kambistët, që e konsiderojnë të përshtatshëm këtë regjim, japin arsye të ndryshme. 16 kambistë shprehen se në këtë regjim kursi sigurojnë fitime të mira, 5 kambistë e lidhin me shpejtësinë e veprimit dhe të sigurimit të fitimit, 4 kambistë shprehen se regjimi krijon fleksibilitet, 3 kambistë shprehen se krijon mundësi për të ndjekur luhatjet e tregut ndërkombëtar, dy të tjerë se krijon

stabilitet dhe tre të fundit (nga një arsye secili) shprehen se ky regjim është i përshtatshëm nga përvoja e punës, siguron përcaktimin e një çmimi më real, ose sepse banka qarkullon vlera të mëdha.

Vërehet se 9 kambistët, që e konsiderojnë të papërshtatshëm regjimin aktual të kursit të këmbimit arsyetojnë në dy raste që veprimtaria e tyre nuk varet nga kursi bankar, në dy raste të tjera, sepse ka një lloj rutine dhe po në dy raste se ky lloj regjimi mbahet për interesa të bankës. Ndërsa, një kambist shprehet se ky regjim nuk është i përshtatshëm pasi ekonomia është në rënie, një tjetër se në këtë regjim ka normë të ulët fitimi dhe një i tretë, e arsyeton me faktin që banka qendrore nuk punon me kambistët e tregut jozyrtar. Interesante është të shënohet që këta kambistë, në piramidën e tregut, janë të shpërndarë në dy klasat e para: domethënë që veprojnë me shuma mjaft të vogla dhe të vogla (deri në 10 mijë dollarë amerikanë).

Pyetja 22, kërkon të dijë përshtatshmërinë e transaksioneve të shit-blerjes së valutës nga ana e Bankës së Shqipërisë në tregun valutë. **Gati gjysma (48 për qind) e kambistëve i konsiderojnë të përshtatshme veprimet e bankës qendrore**, 28 për qind shprehen se nuk janë të përshtatshme dhe pjesa tjetër (24 për qind) nuk japin opinion.

Pyetja 23, kërkon arsyen se përse kambistët e konsiderojnë të përshtatshëm ose jo momentin e shit-blerjeve të kryera nga Banka e Shqipërisë. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 38 kambistë ose 100 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Kambistët, që e konsiderojnë të përshtatshëm momentin e shit-blerjeve valutore të kryera nga Banka e Shqipërisë, shprehen se "këto veprime bëhen për të mbajtur të stabilizuar kursin e këmbimit të monedhës së vendit dhe për të ruajtur ekuilibrin në treg" (10 kambistë), 5 kambistë shprehen se këto veprime krijojnë mundësi veprimi për ta, 4 kambistë theksojnë se këto të fundit janë në interesin e vetë bankës, 2 kambistë i mendojnë ato të përshtatshme pasi bëhen në raste të rralla dhe specifike, një kambist i quan të përshtatshme pasi bëhen për arsye shtetërore, një tjetër mendon se ndikon në tregun jozyrtar dhe një i tretë se banka ka aftësi intelektuale dhe sasi monetare për të realizuar shit-blerjet valutore.

Vërehet se 14 kambistët, që e konsiderojnë të papërshtatshëm momentin e veprimit të Bankës së Shqipërisë, shprehen se "këto veprime bëhen për interesa të bankës ose të drejtuesve të saj dhe jo të tregut" (8 raste), dy kambistë deklarojnë se në treg ka stabilitet dhe banka vepron duke e prishur atë, një kambist deklaron se "bankat spekulojnë", një tjetër thekson se shit-blerjet valutore të bankës çorientojnë tregun, një kambist thotë që banka i kryen ato për të ulur vlerën e monedhës së huaj dhe i fundit se shit-blerjet valutore të bankës janë të papërfillshme.

Pyetja 24, kërkon të dijë nëse Banka e Shqipërisë arrin të realizojë, sipas mendimit të kambistëve, qëllimin me anë të transaksioneve të shit-blerjeve valutore që ajo ndërmerr. **Mbi gjysma (62 për qind) e kambistëve shprehen se Banka e Shqipërisë e realizon qëllimin e saj**, 14 për qind se nuk e realizon dhe 24 për qind nuk jep opinion.

Të gjithë ata, që shprehen pro këtyre veprimeve të Bankës së Shqipërisë mendojnë se banka e realizon qëllimin. Ndërsa 14 për qind e kambistëve që shprehen kundër tyre, mendojnë se përsëri banka ia arrin qëllimit.

Pyetja 25, kërkon arsyen për përgjigjen e dhënë nga kambistët në pyetjen 24. Insistohet në të tilla pyetje për shkak të natyrës delikate të veprimeve në tregun valutore. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 37 kambistë ose 97.4 për qind e atyre që duhej të jepnin përgjigje.

Kambistët, që mendojnë se Banka e Shqipërisë e arrin qëllimin e saj, shprehen se këto veprime stabilizojnë dhe ekuilibrojnë tregun (9 kambistë), se banka realizon qëllimet e veta (ka leverdinë e vet - 7 kambistë), 6 kambistë shprehen se arrin të shmangë spekulimet në treg, sidomos në tregun jozyrtar, 5 kambistë shprehen se banka e realizon qëllimin pasi është institucion i fuqishëm, tre kambistë mendojnë që qëllimi i bankës është të çorientojë tregun dhe këtë qëllim e realizon, 1 kambist shprehet se krijon mundësi manovrimi për ta dhe 1 tjetër e lidh me faktin që ekonomia ka filluar të prodhojë dhe për pasojë është reduktuar importi i frutave dhe perimeve.

Vërehet se 7 kambistët që mendojnë se Banka e Shqipërisë nuk ia arrin qëllimit me veprimet e saj të shit-blerjeve valutore, shprehen se ajo vetëm sa spekulon në treg (pesë kambistë) dhe të humbur dalin gjithmonë kambistët dhe klientët (dy kambistë).

Pyetja 26, kërkon të dijë opinionin e kambistëve mbi monedhën që ata e konsiderojnë më të përshtatshme për të kryer transaksione në formën e shit-blerjeve valutore në treg duke ofruar katër alternativa përgjigjeje: dollarin amerikan, liritën italiane, markën gjermane dhe dhrahminë greke. Pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. **Mendimi i kambistëve është dukshëm në favor të dollarit amerikan, pasi për këtë monedhë janë shprehur 80 për qind e tyre**, ndërsa 12 për qind identifikojnë markën gjermane. Për liritën italiane dhe dhrahminë greke shprehen përkatësisht 6 për qind e kambistëve.

Pyetja 27, kërkon të dijë se cilat duhet të jenë, sipas mendimit të kambistëve, arsyet në bazë të të cilave Banka e Shqipërisë të veprojë në tregun valutore. **82 për qind e kambistëve shprehen se banka duhet të veprojë për të mbajtur stabël monedhën e vendit**, 8 për qind për ta vlerësuar atë, 6 për qind për ta zhvlerësuar dhe 4 për qind nuk jep opinion.

Pyetja 28, kërkon të dijë opinionin e kambistëve mbi peshën që ka monedha europiane, euro, dhe si ka ecur ajo duke krahasuar vitin 2000 me vitin 1999. **Shumica e kambistëve (82 për qind) shprehen se nuk mendojnë që euro, si monedhë, është fuqizuar në tregun shqiptar gjatë vitit 2000** në raport me vitin 1999, 16 për qind mendojnë se është fuqizuar dhe 2 për qind nuk japin opinion.

III. 5. Çështje të tjera.

Pyetësi është ndërtuar i tillë, që nuk kërkon komente në fund të tij. Megjithatë, disa prej kambistëve kanë shprehur opinione të tyre të cilat duken interesante dhe të dobishme për t'u bërë të njohura.

Kështu, 7 kambistë kanë dhënë edhe normën e fitimit. Kjo normë fitimi varion nga 0.07 për qind deri në 1 për qind ose nga 0.1 cent në 1 dollar për 100 dollarë amerikanë.

Vërehet se vlera mesatare e fitimit për 100 dollarë amerikanë është 48 cent ose 0.48 për qind. Në përgjithësi kambistët e përgjigjur u takojnë klasave "mjaft të vogël dhe të vogël" të piramidës së tregut.

Një kambist, i cili ka mbi 7 vjet punë, dhe renditet në grupin e kambistëve që qarkullojnë shuma të mesme (dy mijë dollarë mesatarisht për një transaksion) shprehet se në 70 për qind të rasteve banka qendrore vepron me kambistët dhe jo në shitje të lirë duke komanduar në këtë mënyrë tregun jozyrtar.

Një kambist, i cili ka mbi 7 vjet punë, dhe renditet në grupin e kambistëve që qarkullojnë shuma mjaft të mëdha (150 mijë dollarë mesatarisht për një transaksion) shprehet se është mirë të shkohet drejt grupimeve të zyrave.

Një kambist shprehet se kushtet e zhvillimit të veprimtarisë në tregun jozyrtar janë tepër të vështira.

Konsideratat e mësipërme mund të çojnë në konkluzionin se duhen bërë përpjekje për kanalizimin në bursë të veprimtarisë valutore të tregut jozyrtar.

III. 6. Konkluzione.

Kambistët e lirë në tregun jozyrtar të këmbimeve valutore përbëjnë një tjetër operator të rëndësishëm të tregut të këmbimeve valutore në tërësi. Informacioni i tyre sidomos paraqet vlefshmëri për një ide të përafërt që krijon për shtrirjen e aktivitetit jozyrtar.

III. 6. 1. Monedha e huaj më e preferuar.

Përsa i takon identifikimit të monedhës së huaj më të preferuar, edhe kambistët janë në të njëjtin mendim me bankat dhe zyrat e këmbimit. Ata konfirmojnë se më shpesh operojnë me dollarin amerikan, megjithëse përdorimi i monedhave të tjera është disi më uniform në krahasim me dy operatorët e tjerë. Në ndryshim nga bankat dhe zyrat, si monedhë të dytë të rëndësishme kambistët deklarojnë drahminë greke duke lënë në nivel të njëjtë liretën italiane dhe markën gjermane.

Dollari amerikan konsiderohet si monedhë e qëndrueshme dhe e preferuar për të mbajtur kursimet. Preferenca për dy vitet e fundit (1999 - 2000) për këtë monedhë mbetet e konsiderueshme dhe është rritur. Dollari amerikan paraqitet si monedhë orientuese për vendimmarrje, madje konsiderohet prej kambistëve si monedha më e përshtatshme për shit-blerje në tregun valutor nga ana e Bankës së Shqipërisë.

Përsa i përket monedhës europiane, euro, shumica e kambistëve mendojnë se ajo nuk është fuqizuar në dy vitet e fundit në tregun shqiptar.

III. 6. 2. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore.

Është e qartë që pothuaj të gjithë kambistët janë shprehur se tregu jozyrtar është i nevojshëm për shkak të shpejtësisë me të cilën përfundohen transaksionet në këtë treg dhe të kurseve më të favorshme që ofron. Si një justifikim i rëndësishëm për nevojën e këtij tregu është edhe mundësia që ofron ai për punësim.

Në ndryshim nga bankat dhe zyrat, kambistët deklarojnë se aktiviteti valutor në këtë treg është reduktuar megjithëse relativisht pak në peshë në raport me bankat. Megjithatë, edhe ky operator konfirmon që tregu jozyrtar, në aktivitetin e tij, orientohet nga tregjet ndërkombëtare.

III. 6. 3. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e bankës qendrore.

Kambistët e gjykojnë se regjimi aktual i kursit të këmbimit është i përshtatshëm për ta pasi u jep mundësi të veprojnë shpejt dhe të kenë fitime.

Po kështu, në përgjithësi, kambistët mendojnë se banka qendrore shet dhe blen në treg në momente të përshtatshme duke e realizuar qëllimin e saj në këtë veprimtari.

Kambistët, ashtu si edhe bankat, shprehen se shit-blerjet e Bankës së Shqipërisë duhet të kenë si qëllim stabilizimin e monedhës së vendit.

III. 6. 4. Aktiviteti valutor i kambistëve.

Informacioni i deklaruar prej kambistëve është i një rëndësie të veçantë pasi na jep mundësi të krijojmë një ide paraprake mbi madhësinë e tregut jozyrtar të këmbimeve. Sipas operatorëve të këtij tregu, numri i transaksioneve është rreth 4.7 në ditë me vlerë mesatare që varion nga 75 dollarë në 158 mijë dollarë amerikanë. Kjo do të thotë që, në një vit kambistët qarkullojnë për qëllime të këmbimeve valutore një sasi prej 93 mijë deri në 196 milionë dollarë amerikanë. Nëse rezultati do të përgjithësohej për të gjithë kambistët, që veprojnë dukshëm në tregun jozyrtar, do të vlerësonim se volumi i transaksioneve të kryera prej tyre (tregu jozyrtar), do të ishte rreth shifës 2.4 miliardë dollarë amerikanë në vit.

Në këtë mënyrë, kambistët dhe zyrat e këmbimit shfaqin ngjashmëri përse i përket numrit të vogël të transaksioneve që kryejnë dhe variacionit të gjerë të shumave të këmbyerë. Në të kundërt, bankat kryejnë transaksione me vlera që variojnë në një interval të ngushtë dhe jo shumë të mëdha, por numri i lartë i transaksioneve që ato kryejnë i rendisin bankat si operatorin e parë dhe më kryesor të tregut. Ndryshe nga pritshmëria, operator i dytë i rëndësishëm, përse i takon numrit të transaksioneve, dalin kambistët e tregut jozyrtar dhe të tretët renditen zyrat e këmbimit valutor.

Në përfundim konkludohet që edhe kambistët konsiderojnë dollarin amerikan si monedhë të qëndrueshme dhe orientuese në vendimet e tyre dhe mendojnë që euro nuk e ka fuqizuar peshën e saj në tregun shqiptar.

Pyetëson për kambistët.

A. Informacione të përgjithshme

Pyetja 1. Sa kohë keni që keni nisur këtë aktivitet (në vite)?

Deri 1	1
1-3	2
3-5	3
5-7	4
7 e lart	5

Pyetja 2. A punoni për vete aktualisht?

Po	1
Jo	2

Pyetja 3. Cila është monedha me të cilën operoni më shpesh? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmi greke	4	
Lekë	5	
Te tjera	6	Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 4. Sa transaksione valutore në ditë kryeni mesatarisht?

Deri 1	1
1-3	2
3-5	3
5-7	4
7 e lart	5

Pyetja 5. Sa është vlera mesatare e një transaksioni në dollarë amerikanë?

_____.

Pyetja 6. Sa për qind të të ardhurave tuaja mujore kurseni? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

0	1
0-10	2
10-20	3
20-30	4
30-40	5
40-50	6
50 e lart	7

Pyetja 7. Në ç'monedhë preferoni të mbani kursimet tuaja? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmi greke	4
Lekë	5
Të tjera	6

Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 8. Preferoni të këmbeni paratë tuaja: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Në bankë?	1
Në ZKV?	2
Në tregun informal (kambistë të lirë)?	3
Kombinim i varianteve të mësipërme?	4

Pyetja 9. Jepni arsyen/et për zgjedhjen në pyetjen 8.

_____ !_!

B. Opinione për organizimin e tregut valutor.

Pyetja 10. Cila mendoni se është valuta më e qëndrueshme tek ne? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane?	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4
Të tjera	5

Specifikoni: _____ !_!

Pyetja 11. Jepni arsyen për zgjedhjen në pyetjen 10.

_____ !_!

Pyetja 12. Cila monedhë e huaj përbën pikën orientuese në aktivitetin tuaj?
(Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

- | | | |
|------------------|---|------------------------|
| Dollari amerikan | 1 | |
| Lireta italiane | 2 | |
| Marka gjermane | 3 | |
| Drahamia greke | 4 | |
| Të tjera | 5 | Specifikoni: _____ !_! |

Pyetja 13. A e vlerësoni të nevojshëm tregun jozyrtar të këmbimit valutor?

- | | |
|------------|---|
| Po | 1 |
| Jo | 2 |
| Pa opinion | 3 |

Pyetja 14. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 13.

_____ !_!. ?

Pyetja 15. Cili është, sipas mendimit tuaj, kursi mbi të cilin bazohet vendosja e kurseve të këmbimit në tregun jozyrtar? _____ !_!.

Pyetja 16. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve, që kryenit në tregun jozyrtar në vitin 1999, krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

- | | |
|------------------|---|
| Më i madh | 1 |
| Më i vogël | 2 |
| Nuk ka ndryshuar | 3 |
| Nuk e di | 4 |

Pyetja 17. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve, që kryenit aktualisht në tregun jozyrtar (në vitin 2000), krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

- | | |
|------------------|---|
| Më i madh | 1 |
| Më i vogël | 2 |
| Nuk ka ndryshuar | 3 |
| Nuk e di | 4 |

Pyetja 18. Mendoni se pjesa e tregut të këmbimeve valutore e zotëruar nga ZKV, në këto dy vitet e fundit ka ardhur: (Për secilin moment kohor zgjidhni vetëm një mundësi.)

viti 1999		viti 2000	
në rritje?	1	në rritje?	1
në rënie?	2	në rënie?	2
nuk ka ndryshuar?	3	nuk ka ndryshuar?	3
nuk e di?	4	nuk e di?	4

Pyetja 19. Cila është valuta me të cilën ju keni preferuar të operoni dhe preferoni aktualisht të operoni më shpesh? (Për secilin moment kohor mund të zgjidhni më shumë se një nga valutat e mëposhtme.)

viti 1999		viti 2000	
Dollari amerikan	1	Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2	Lireta italiane	2
Marka gjermane	3	Marka gjermane	3
Drahamia greke	4	Drahamia greke	4

C. Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë

Pyetja 20. A ju krijon përparësi në punën tuaj regjimi aktual i kursit të këmbimit? (Të jepet një sqarim për këtë regjim.)

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 21. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 20.

_____ !_!.

Pyetja 22. A mendoni se shit-blerjet valutore të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor për ndryshimin e kursit të këmbimit, kryhen në momentin e përshtatshëm?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 23. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 22.

_____ !_! ?

Pyetja 24. A mendoni se nga këto transaksione ajo ia arrin qëllimit?

- Po 1
- Jo 2
- Pa opinion 3

Pyetja 25. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 24.

!_!. ?

Pyetja 26. Cila do të ishte, sipas mendimit tuaj, monedha më e përshtatshme për të kryer transaksione në treg? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

- Dollari amerikan 1
- Lireta italiane 2
- Marka gjermane 3
- Drahamia greke 4

Pyetja 27. Për ç'qëllim duhet të veprojë në treg Banka e Shqipërisë?

- Zhvlerësim 1
- Vlerësim 2
- Ruajtje të një kursi stabël 3
- Pa opinion 4

Pyetja 28. Mendoni se euro është fuqizuar në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999?

- Po 1
- Jo 2
- Nuk ka ndryshuar 3
- Nuk e di 4

Faleminderit për bashkëpunimin!

KAPITULLI IV: REZULTATET E DALA NGA PËRPUNIMI I INFORMACIONIT TË PYETËSORIT PËR BIZNESET

IV. 1. Informacion i përgjithshëm.

Bashkësia e bizneseve, nisur nga roli i rëndësishëm që ka në "lojën" e madhe të tregut valutor, u konsiderua një lojtar me peshë dhe me vlera të veçanta studimi në këtë vërtetim.

Ky operator konsiderohet të jetë i rëndësishëm si për veprimtarinë që ka në tregun këmbimit valutor, edhe për vlerësimet, gjykimet dhe opinionet e lira që ai shpreh lidhur me të tashmen dhe të ardhmen e këtij tregu, kryesisht për kursin përfaqësues të këmbimit.

Niveli i përgjigjeve të 150 bizneseve të intervistuar, ishte përgjithësisht i kënaqshëm. Refuzuan të përgjigjeshin 12 biznese. Kështu, niveli i bashkëpunimit në plotësimin e plotë apo të pjesshëm të pyetësorëve, arriti në 92 për qind, fakt që konsiderohet si zhvillim pozitiv në lidhje me shkallën e sensibilizimit gjithnjë e më të lartë të bizneseve përballë problemeve të tregut valutor, kursit të këmbimit dhe ndikimet e politikës së ndjekur nga Banka e Shqipërisë në veprimtarinë e tyre. Llogaritjet në material janë bazuar në numrin e bizneseve që kanë pranuar të përgjigjen, pra, 138 biznese, i cili do të konsiderohet si totali. Fakti që 12 biznese kanë refuzuar të përgjigjen, nuk ndikon në ndryshime strukturore të zgjedhjes, meqenëse bizneset që kanë refuzuar, i përkasin kategorisë së vetme në vërtetim, grupit të bizneseve të mëdha dhe mjaft të mëdha.

Për të patur një informacion më të plotë rreth kursit të këmbimit dhe ndikimit të luhatjeve të tij në aktivitetin e bizneseve, të cilat punojnë me material porositës, nga totali i bizneseve të zgjedhura, 10 për qind e tyre, u zgjodhën nga firmat prodhuese që punojnë me material porositës. Këto biznese i përkasin rrethëve Durrës, Korçë dhe Fier. Edhe në totalin e bizneseve që u përgjigjën, ky lloj aktiviteti përbën 10 për qind.

Pyetësi përmban tre rubrika, informacionet e të cilave, mund të kombinohen dhe të arrihet në konkluzione. Gjatë përpunimit u vu re se pyetjet janë kuptuar mirë dhe ka lidhje logjike midis tyre.

IV. 2. Pyetjet e rubrikës A "Informacione të përgjithshme".

Kjo rubrikë përfshin tetë pyetje, ndër të cilat më interesante lidhur me qëllimin e vërtimit konsiderohen ato që kanë të bëjnë me aktivitetin që ushtrojnë të intervistuarit, me vëllimin e transaksioneve mujore që ata kryejnë në dollarë amerikanë, si edhe monedhat më të përdorura në aktivitetin e tyre. Kjo rubrikë përmban pyetje që kërkojnë të vjelin informacion sasior e cilësor, si edhe opinionet e lira. Konstatohet një nivel i lartë përgjigjesh në të gjitha llojet e pyetjeve, fakt që lejon kryerjen e analizave dhe arritjen e konkluzioneve.

Kështu, pyetjeve me natyrë sasiore iu përgjigjën nga 82 për qind në 100 për qind të bizneseve. Atyre me natyrë cilësore iu përgjigjën nga 93 për qind në 100 për qind e tyre. Ndërsa pyetjes që kërkon dhënie opinioni, pra pak a shumë me natyrë të lirë iu përgjigjën rreth 86 për qind e tyre, përsëri një nivel i lartë.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së parë ka rezultuar:

Pyetja 1, ka për qëllim të identifikojë fushën e veprimtarisë së bizneseve, sipas sektorëve¹⁶ të listuar. Kjo pyetje lejon më shumë se një zgjedhje. Interesi i kësaj pyetjeje është që ajo t'i shërbejë analizës në kombinimin e mëtejshëm me pyetje të tjera, pra të analizojë shpërndarjen e bizneseve sipas sektorëve të ekonomisë. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 100 për qind e bizneseve.

Tabela 46: Shpërndarja e bizneseve sipas aktiviteteve ekonomike.

Aktiviteti i ushtruar	Në përqindje*
Industri	26.8
Ndërtim	19.6
Tregti	34.1
Shërbime	19.6
Transport	7.3
Bujqësi	0.007

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve 138. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Ndër përgjigjet, evidentohet prirja e të intervistuarve drejt tregtisë dhe industrisë. Gjithashtu, bie në sy fakti që, 9 raste kanë deklaruar se ushtrojnë më shumë se një aktivitetet ekonomik dhe në një rast katër të tilla. Në këto 10 raste kombinimesh të aktiviteteve ekonomike, evidentohet gjithmonë tregtia si njëri prej tyre.

Krahasuar me vrojtimin e sistemit bankar në vitin 1999, evidentohet një strukturë e përafërt sipas aktiviteteve ekonomike të ushtruara¹⁷.

Pyetja 2, ka për qëllim të identifikojë shtetin, i cili haset më shpesh në transaksionet valutore të bizneseve. Për këtë arsye pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Kësaj pyetjeje, ashtu si edhe në pyetjen parardhëse, iu përgjigjën 100 për qind e bizneseve.

Nga përpunimi rezulton se **shteti me të cilin kryhen më shpesh transaksionet valutore, ashtu si edhe pritej, është Italia**. Për këtë shtet deklarohen 56 biznese. Vendi i dytë në renditje është Greqia për të cilën përgjigjen 33 biznese. Vlen të përmendet fakti se edhe Shqipëria ka peshë të konsiderueshme në kryerjen e këtyre transaksioneve. Këtë fakt e deklarojnë 31 biznese.

¹⁶ Në listimin e sektorëve, janë respektuar kategorizimet e kryera nga INSTAT për aktivitetet ekonomike.

¹⁷ Shih: Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij." (analizë vrojtimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 45.

Tabela 47: Shpërndarja e transaksioneve sipas shteteve.

Shteti	Përgjigjet (në %)
Italia	40.6
Greqia	23.9
Turqia	5.1
Gjermania	11.6
Bullgaria	2.2
Maqedonia	4.3
Shqipëria	22.5
Të tjerë	8.7

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve 138. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Në 15.2 për qind të të intervistuarve pohohet se kryejnë transaksione me më shumë se një vend. Në 16 raste, deklarohet se kryhen transaksione me dy vende, në 3 raste me katër vende dhe vetëm në një rast me 5 vende.

Ndër vendet e tjera me të cilat kryhen transaksione, evidentohen: Kosova (2 raste), Mali i zi (2 raste), Anglia (2 raste), Kroacia (2 raste), Austria, Kanadaja, Sllovenia dhe Hollanda. Në një rast nuk është evidentuar shteti.

Informacioni i marrë në pyetjet 1 dhe 2 na lejon të kombinojmë të dhënat për këto dy pyetje për të gjykuar, deri diku, si mbi strukturën e aktiviteteve sipas shteteve partnere ashtu edhe mbi orientimin gjeografik të aktiviteteve ekonomike¹⁸.

Tabela 48: Peshat e aktiviteteve ekonomike sipas çdo shteti*.

Shteti	Aktiviteti					
	Tregti	Ndërtim	Industri	Shërbime	Transport	Bujqësi
Italia	36.5	17.5	20.6	15.9	9.5	0.0
Greqia	34.2	10.5	34.2	13.2	7.9	0.0
Turqia	50.0	20.0	10.0	0.0	20.0	0.0
Gjermania	40.0	5.0	35.0	10	10	0.0
Bullgaria	50.0	0.0	25.0	25.0	0.0	0.0
Maqedonia	33.2	16.7	16.7	0.0	16.7	16.7
Shqipëria	11.4	40.0	11.4	28.6	5.7	2.9
Të tjerë	33.3	0.0	16.7	41.7	8.3	0.0

Shënim: * Struktura është paraqitur në përqindje, ku 100 për qind është konsideruar aktiviteti ekonomik në tërësi me shtetin përkatës.

Duke analizuar shpërndarjen e aktiviteteve ekonomike sipas çdo shteti, vihet re se bizneset që deklarojnë se kryejnë transaksione me vendet e huaja të listuara, i kanë të orientuara ato kryesisht për aktivitet tregtar.

¹⁸ Kjo analizë është realizuar nëpërmjet tabelave 48 dhe 49, sepse natyra e këtyre dy pyetjeve, që lejojnë zgjedhjen e më shumë se një alternative, nuk mundëson përmbledhjen dhe analizën e të dhënave të strukturuarra sipas dy teguesve (shtetit dhe aktivitetit ekonomik) në një tabelë të vetme.

Maqedonia, dallohet për një barazpeshë në aktivitetet e ndërtimit, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë. Për Shqipërinë, spikatin dy aktivitete me peshë më të konsiderueshme, ndërtimi dhe shërbimet. Këto aktivitete normalisht zhvillohen në terrenin shqiptar. Një fakt i tillë do të ishte shumë i pritshëm edhe për bujqësinë, por për fat të keq, ky sektor evidentohet të jetë larg vëmendjes së bizneseve të mëdha dhe mjaft të mëdha, që u intervistuan.

Tabela 49: Pësha e çdo shteti sipas aktivitetit*.

Shteti	Aktiviteti					
	Tregti	Ndërtim	Industri	Shërbime	Transport	Bujqësi
Italia	37.7	33.4	30.9	30.3	35.3	0.0
Greqia	21.3	12.1	30.9	15.2	17.5	0.0
Turqia	8.1	6.1	2.4	0.0	11.8	0.0
Gjermania	13.1	3.0	16.7	6.0	11.8	0.0
Bullgaria	3.3	0.0	2.4	3.0	0.0	0.0
Maqedonia	3.3	3.0	2.4	0.0	5.9	50.0
Shqipëria	6.6	42.4	9.5	30.3	11.8	50.0
Të tjerë	6.6	0.0	4.8	15.2	5.9	0.0

Shënim: *Struktura e shpërndarjes është paraqitur në përqindje, ku 100 për qind është konsideruar aktiviteti ekonomik përkatës për të gjitha shtetet.

Kombinimet nxjerrin në pah orientimet më të spikatura gjeografike të aktiviteteve ekonomike. Kështu, bie në sy aktiviteti i tregtisë i cili zhvillohet më së shumti me Italinë dhe Greqinë. Në përgjithësi, për çdo aktivitet, evidentohen të zënë peshat më të konsiderueshme dy partnerët kryesorë tregtarë dhe dy investitorët më të mëdhenj, Italia dhe Greqia.

Nga deklaratimet në intervista rezulton se përsëri bujqësia, me pjesën më të madhe të shteteve nuk zhvillohet fare, ndërsa evidentohet si një aktivitet që kryhet vetëm me Shqipërinë dhe Maqedoninë.

Pyetja 3, ka për qëllim të identifikojë monedhën me të cilën operohet më shpesh nga bizneset. Për këtë arsye edhe kjo pyetje lejon zgjedhjen e më shumë se një alternative për përgjigje. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën të gjithë të intervistuarit.

Rezulton që më shpesh transaksionet kryhen në dollarë amerikanë dhe në lekë. Më pas renditet lireta italiane e dhrahmia greke.

Tabela 50: Shkalla e përdorimit të monedhave.

Monedha e përdorur	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	50
Lireta italiane	34.1
Marka gjermane	10.9
Dhrahmia greke	22.5
Leku	39.1
Të tjera	0.007

Shënim: * Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve, 138. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Vihet re fakti se në 62 raste përgjigjesh deklarohet se operohet me dy monedha ku njëra, në rreth 80 për qind të rasteve është leku. Pra, siç pritej, monedha vendase është një nga alternativat më të forta, pse jo e domosdoshme, në aktivitetin që bizneset ushtrojnë.

Nëse kombinohen informacionet e dhëna në pyetjen 1 dhe 3, do të mund të identifikohet përdorimi i secilës prej monedhave të rradhitura në pyetësor sipas sektorëve ekonomikë.

Tabela 51: Përdorimi i secilës monedhë sipas aktiviteteve ekonomike*.

Monedha	Aktiviteti					
	Tregti	Ndërtim	Industri	Shërbime	Transport	Bujqësi
Dollari amerikan	35.1	22.1	18.2	16.9	7.7	0.0
Lireta italiane	37.8	17.0	22.6	15.1	7.5	0.0
Marka gjermane	37.4	6.3	31.3	6.3	12.4	6.3
Dhrahmia greke	38.9	11.1	30.6	13.9	5.5	0.0
Leku	22.0	27.2	18.6	28.8	1.7	1.7
Të tjera	-	-	-	100.0	-	-

Shënim: *Struktura e shpërndarjes është paraqitur në përqindje, ku 100 për qind është konsideruar përdorimi në total (në të gjithë sektorët ekonomikë) i monedhës përkatëse.

Sipas të gjithë sektorëve ekonomikë, përdorimi i monedhës amerikane, ndër të gjitha monedhat e rradhitura ndeshet më shpesh. Për më tepër, është sektori i tregtisë që e përdor atë më shumë se sa sektorët e tjerë. Ndërtimi është i pozicionuar, gjithashtu, te kjo monedhë. Vihet re se, në përgjigjithësi, të gjitha monedhat e tjera, e gjejnë përdorimin e tyre më të madh në tregti. Vlen të përmendet fakti se leku, ka jo vetëm një përdorim të lartë në të gjithë sektorët, por karakterizohet nga një shpërndarje më harmonike e rasteve sipas aktiviteteve ekonomike. Nivelin më të lartë të përdorimit e gjejmë në shërbime dhe në ndërtim. Në sektorin e ndërtimit ka pothuajse përdorim të njëjtë me dollarin amerikan. Kombinimi i pyetjeve 2 dhe 3 na jep informacion mbi shpërndarjen apo përdorimin e monedhave (në përqindje) sipas vendeve me të cilat deklarohet të kryhen më dendur transaksione nga bizneset.

Tabela 52: Përdorimi i secilës monedhë sipas shteteve*.

Shteti	Monedha				
	Dollari amerikan	Lireta italiane	Marka gjermane	Dhrahmia greke	Të tjera
Italia	38.5	50	2.6	7.7	1.2
Greqia	33.3	6.7	0	60	0
Turqia	58.4	0	41.6	0	0
Gjermania	33.3	29.2	37.5	0	0
Bullgaria	100	0	0	0	0
Maqedonia	42.9	0	57.1	0	0
Të tjerë	69.2	15.4	15.4	0	0

Shënim: *Struktura e shpërndarjes është paraqitur në përqindje, ku 100 për qind është konsideruar përdorimi në total (për të gjitha monedhat) për shtetin përkatës.

Nga ky kombinim, **del në pah preferenca e theksuar për të përdorur dollarin amerikan, pavarësisht nga vendi me të cilin kryhen më shpesh transaksionet.** Kështu, vërtet transaksionet kryhen më shpesh me Italinë, por monedha parësore pas liritës italiane, vlerësohet të jetë ajo amerikane, pra në rreth 38.5 për qind të bizneseve që kanë marrëdhënie me Italinë, transaksionet kryhen me dollarë amerikanë. Po i njëjti fenomen vihet re edhe me Greqinë dhe Gjermaninë. Gjithçka u shpjegua më sipër nënvizon faktin që **një pjesë e konsiderueshme e pagesave tregtare me vendet kryesore partnere, bëhet jo në monedhën përkatëse, por në dollarë amerikanë.**

Nëse kjo analizë do të bëhej vetëm për shtetin me të cilin kryhen më shpesh transaksione, konkretisht, për Italinë, evidentohen këto fenomene:

- pas liritës italiane, dollari amerikan është monedha me të cilën kryhen pjesa më e madhe e transaksioneve me këtë shtet (rreth 38.5 për qind);
- në aktivitetin e tregtisë dhe të ndërtimit deklarohet se veprohet kryesisht me dollarë amerikanë (rreth 40 për qind për secilin aktivitet);
- në aktivitetin e industrisë, monedha italiane (lireta), është mbizotëruese në masën rreth (40 për qind), fakt që evidentohet kryesisht në firmat (bizneset) që punojnë me material porositës.

Në mënyrë më të shprehur, ky fenomen (prania e dollarit në transaksione) evidentohet me Turqinë, Bullgarinë si edhe me vendet e tjera. Në transaksionet me Maqedoninë më shumë se gjysma e tyre realizohet me marka gjermane, madje do të theksonim faktin që kjo shifër është edhe më e lartë se me vetë Gjermaninë.

Pyetja 4, është një pyetje sasiore që ka për qëllim të masë numrin mesatar mujor të transaksioneve valutore të kryera nga secili biznes. Ofrohen tre alternativa intervalore dhe lejohet zgjedhja vetëm e njëjës. Informacioni i siguruar jep mundësi për të gjetur një numër mesatar të transaksioneve valutore të kryera nga bizneset në një njësi kohe të caktuar. Në këtë pyetje u përgjigjën 129 biznese, apo afro 93.5 për qind e totalit.

Tabela 53: Shpërndarja e bizneseve sipas numrit të transaksioneve.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	Frekuenat kumulative rritëse (në %)
Deri në 2	36.4	36.4
3-5	35.7	72.1
Mbi 6	27.9	100.0
Totali	100.0	

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve 129.

Nga përgjigjet rezulton se **transaksionet mujore (deri në 5), kryhen nga rreth 72 për qind e të intervistuarve.** Madje, grupi i parë dhe i dytë i transaksioneve ndeshen pothuajse në mënyrë të barabartë.

Ky informacion na lejon të llogarisim numrin mesatar të transaksioneve mujore për bizneset e intervistuar.

Box 6: Llogaritja e numrit mesatar të transaksioneve për bizneset në njësinë e kohës.

I. Në një muaj numri mesatar i transaksioneve është rreth 4.

III. Në një vit numri mesatar i transaksioneve është rreth 48.

Pyetja 5, plotëson informacionin sasior të nisur në pyetjen 4, duke synuar finalizimin e tij me anë të një vlerësimi mbi vëllimin total të transaksioneve në dollarë amerikanë për bizneset e pyetura. Me anë të një vlerësimi intervalor do të mundësohet shtrirja e gjykimit mbi vlerën mesatare të një transaksioni valutor në mjedisin e bizneseve “të mëdhenj dhe më të mëdhenj”. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 113 biznese apo rreth 82 për qind e totalit.

Vlera minimale e një transaksioni rezultoi 850 dollarë dhe ajo maksimale 500 mijë dollarë. Nga grupimi që iu bë vlerës mesatare të një transaksioni të deklaruar nga bizneset, mund të gjykohej për pozicionimin e tyre.

Tabela 54: Shpërndarja e bizneseve sipas vlerës mesatare të një transaksioni.

Dollarë amerikane	Përgjigjet (në %)*	Frekuencat kumulative rritëse (në %)
Deri 1000	3.5	3.5
1000-10000	57.6	61.1
10000-100000	35.4	96.5
Mbi 100000	3.5	100.0
Totali	100.0	

Shënim: * Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve, 113.

Vërehet se mëse 60 për qind e bizneseve kryejnë transaksione me vlerë mesatare deri në 10 mijë dollarë amerikanë dhe pothuajse 97 për qind e tyre deklarojnë se operojnë me një shumë mesatare transaksionesh deri në 100 mijë dollarë. Pjesa e mbetur e deklarimeve, që vlerësohet të jetë e vogël, (3.5 %), operon me shuma të konsiderueshme.

Për të intervistuarit rezultoi një nivel mesatar i vlerës së një transaksioni prej afro 25 mijë dollarësh amerikanë¹⁹.

Tabela 55: Kombinimi i rezultateve për numrin e transaksioneve dhe vlerën e një transaksioni (në mijë usd) në njësinë e kohës.

Treguesi	Në muaj	Në vit
1. Nr. mesatar i transaksioneve	4	48
2. Vlera mesatare e një transaksioni (në mijë)	25	25
3. Vëllimi total mesatar i transaksioneve (në mijë)	100	1 200

¹⁹ Vlerësim intervalor i kësaj mesatareje tregon që kjo e fundit luhet në kufijtë nga 14 mijë deri në 36 mijë. Ai është kryer me një nivel besueshmërie 95 për qind.

Sipas grupeve mund të vlerësojmë vëllimin mesatar të transaksioneve të kryera (në dollarë amerikanë), në njësinë e kohës nga bizneset.

Më parë le të paraqesim kombinimin e rezultateve të pyetjeve 4 dhe 5 sipas grupimit të bërë për bizneset:

Tabela 56: Shpërndarja e bizneseve sipas transaksioneve dhe vlerës mesatare të një transaksioni.

Grupet (në mijë dollarë amerikanë)	Transaksionet			Totali
	Deri në 2	3-5	Mbi 6	
Të vogla (deri në 1)	3	0	1	4
Të mesme (1-10)	19	23	7	49
Të mëdha (10-100)	16	21	16	53
Mjaft të mëdha (mbi 100)	2	1	4	7
Totali	40	45	28	113

Nga të dhënat e kësaj tablele vërehet se përqëndrimet më të mëdha të bizneseve janë për grupin e mesëm dhe të madh.

Për efekt të një analize më të plotë llogaritja e vëllimit mesatar të transaksioneve sipas grupeve do të ishte si më poshtë:

Tabela 57: Vëllimi mesatar i transaksioneve për secilin grup transaksionesh.

Transaksionet	Vëllimi mesatar (në mijë dollarë)
Deri në 2	35
3-5	31
Mbi 6	66

Krahasuar me rezultatet e dala nga analiza e sistemit bankar për vitin 1999, vërehet se, përgjithësisht, vëllimi mesatar i transaksioneve në dollarë amerikanë është rritur ndjeshëm për të gjitha grupet e bizneseve sipas transaksioneve që kryejnë. Madje, për grupin e tretë ky vëllim është dyfishuar²⁰. Këto vlera i dedikohen, ndoshta, edhe rritjes së shkallës së përgjigjes për këtë pyetje.

Nga ana tjetër do të vlerësojmë se **vëllimi mesatar i transaksioneve për një vit nga bizneset e intervistuar është rreth 200 milionë dollarë²¹.**

Pyetja 6, ka për qëllim të identifikojë prirjen e biznesmenëve lidhur me monedhën në të cilën ata preferojnë të mbajnë kursimet e tyre. Ajo jep një informacion të dyfishtë. Njëherësh, ajo zbulon sjelljen e biznesmenëve si ndaj kursimeve ashtu edhe përballë monedhës së preferuar për ta. Në këtë informacion, rëndësi të veçantë merr sjellja e tyre përballë monedhës me të cilën ata preferojnë të mbajnë kursimet e tyre.

²⁰ Shih Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij" (analizë vrojtimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 53.

²¹ Intervali i besimit luhet nga 150 në 250 milionë dollarë amerikanë.

Si e tillë pyetja lejon më shumë se një alternativë zgjedhjeje. Gjatë intervistimit rezultoi se iu përgjigjën 137 biznese apo 99.3 për qind e totalit.

Tabela 58: Shkalla e përdorimit të monedhave në kursim.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	75.2
Lireta italiane	11.7
Marka gjermane	12.4
Dhrahmia greke	10.2
Leku	30.7
Të tjera	0.0

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve, 137. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Rezultatet dëshmojnë se **dollari amerikan është dukshëm monedha e dominuese për kursimet tek biznesmenët shqiptarë. Leku gjithashtu është preferuar në masë të konsiderueshme.** Ndërsa nënfishat e euros qëndrojnë pothuajse në nivele të përafërta me njëri - tjetrin, pra asnjëri nuk mund të konsiderohet më i preferuari. Njëkohësisht, ata gjenden mjaft të distancuar nga dollari dhe leku. Madje, në raport me dollarin amerikan, edhe të tre së bashku (34.3 për qind), ata qëndrojnë shumë larg.

Në 36.5 për qind të rasteve është deklaruar se mbajtja e kursimeve bëhet në më shumë se një monedhë. Mbizotëron si monedhë e dytë leku.

Prireja e bizneseve për të patur kursimet e tyre në dollarë jep sinjalin se kjo monedhë është më e besueshme dhe më e qëndrueshme.

Nëse do të kombinohet informacioni i pyetjes 6 me atë të pyetjes 1, mund të realizohej një analizë më e detajuar e preferencës ndaj monedhës në të cilën/at kursimet mbahen dhe veprimtarisë ekonomike të ushtruar nga bizneset.

Tabela 59: Shpërndarja e aktiviteteve ekonomike të ushtruara sipas secilës monedhë të kursyer*.

Preferenca për kursim sipas monedhës	Aktiviteti					
	Tregti	Ndërtim	Industri	Shërbime	Transport	Bujqësi
Dollari amerikan	33.6	20.4	24.8	13.3	7.1	0.8
Lireta italiane	41.1	17.6	23.6	11.8	5.9	0.0
Marka gjermane	33.3	4.8	28.6	23.8	9.5	0.0
Dhrahmia greke	42.9	0.0	50.0	7.1	0.0	0.0
Leku	18.2	27.2	20.5	29.5	2.3	2.3

Shënim: *Struktura e shpërndarjes është paraqitur në përqindje, ku 100 për qind është konsideruar përdorimi në total (në të gjithë sektorët ekonomikë) i monedhës përkatëse të kursyer.

Evidentohet fakti, se të **gjitha monedhat e listuara janë të preferuara për të mbajtur kursimet, kryesisht për ata biznesmenë që ushtrojnë veprimtari tregtare.** Në këtë aktivitet, leku ka shifrën më të ulët. Kjo buron nga fakti se:

- * qarkullimi në sektorin tregtar është shumë më i shpejtë, fakt që nuk lë vend për kursime të mëdha në monedhën vendase;
- * ky aktivitet është i ekspozuar shumë më pak se aktivitetet e tjera kundrejt rrezikut të humbjes nga ndryshimi i kursit të këmbimit, si pasojë e kohës së shkurtër në qarkullim;
- * ky aktivitet zhvillohet kryesisht me vende të huaja, tregues ky, i shkallës së përdorimit dhe të kursimit më të madh në monedha të huaja.

Aktivitetet e ndërtimit dhe shërbimeve, me origjinë vendase dhe terren të zhvillimit të tyre gjithashtu shqiptar, **karakterizohen nga nivele më të larta të kursimit në monedhën vendase.**

Aktiviteti industrial, ka shpërndarjen më homogjene të kursimeve sipas monedhave, sepse të tillë e ka edhe orientimin.

Ndërsa në monedhat e tjera të kursyera vihet re një shpërndarje më e njëtrajtshme, kursimet në monedhën greke paraqiten me një asimetri të theksuar sipas aktiviteteve. Vetëm bizneset që deklarohen se zhvillojnë aktivitet tregtar dhe industrial, kursejnë në monedhën greke.

Pyetja 7, kërkon të identifikojë operatorët më të preferuar për bizneset në procesin e këmbimeve valutore. Ajo lejon vetëm një zgjedhje në alternativat e paraqitura. Rezultoi se kësaj pyetjeje iu përgjigjën 136 biznese, apo 98.6 për qind e totalit.

Vihet re një preferencë pothuajse e njëjtë dhe e konsiderueshme njëkohësisht për bankat, tregun jozyrtar dhe kombinimet.

Zyrat e këmbimit valutore ende mbeten më pak të preferuara.

Ndërkohë që varianti i kombinimit në rastet që ai është treguar si i tillë, ka si njërin nga përbërësit e tij **tregun jozyrtar të këmbimit**. Pra, ky i fundit **është në total më i preferuar si operator se të tjerët**. Në mënyrë më të detajuar rezultatet paraqiten si më poshtë:

Tabela 60: Shpërndarja e bizneseve sipas operatorëve të preferuar.

Operatorët	Në %
Banka	28.7
Zyrat e këmbimit valutore	13.2
Tregu jozyrtar	29.4
Kombinimi i alternativave	28.7
Totali	100.0

Pyetja 8, kërkon një opinion të lirë për zgjedhjen e bërë në pyetjen 7. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 117 biznese apo 86 për qind e atyre që duhej t'i përgjigjeshin. Niveli i përgjigjeve është i kënaqshëm për të nxjerrë konkluzione.

Preferenca për bankat si operator motivohet me sigurinë që ky institucion i ofron klientëve nga falsifikimet.

Një motiv tjetër është se bizneset kanë një histori me bankat (llogaritë bankare), fakt që edhe i detyron ato ta përdorin bankën si operator. Megjithatë, ky motiv ndeshet shumë më rrallë, vetëm në dy raste. Ky fakt, korrelohet edhe me përfundimin e dalë nga analiza e sistemit bankar për vitin 1999, ku preferenca e bizneseve për t'u gjendur pranë shërbimeve bankare, është ende e ulët, për shkak të mentalitetit të varfër të tyre për të qenë pranë bankave²². Faktori i mungesës së traditës së bizneseve për të punuar me bankat është evidentuar me një peshë të konsiderueshme edhe përgjatë analizës mbi aktivitetin kreditues, për vitin 2000²³.

Preferenca për zyrat është, gjithashtu, e motivuar nga siguria, shpejtësia e veprimeve me to si edhe kursi më i favorshëm i tyre në raport me bankat. Pra, evidentohen dy elemente që ulin koston për bizneset gjatë procesit të këmbimeve valutorë. Në dy raste është përmendur edhe orari i zgjatur i punës në këto zyra.

Ndërkohë që në të gjitha rastet e preferencës për tregun jozyrtar ajo ka për bazë humbjet më të vogla apo "leverdinë", që ky operator ofron, pra një kosto më të ulët.

IV. 3. Pyetjet e rubrikës B "Opinione për organizimin e tregut valutor".

Rubrika B, përmban 10 pyetje të cilat kanë për qëllim të vjelin opinione të bizneseve mbi organizimin e tregut valutor në vend. Ajo përqëndrohet veçanërisht në tre pyetje, që drejtpërdrejt, i shërbejnë përmbushjes së qëllimit kryesor të vërtetimit. Me anë të tyre nga njëra anë synohet të zbulohet monedha e huaj më e qëndrueshme dhe orientuese, e perceptuar si e tillë nga bizneset dhe, nga ana tjetër, se cili është kursi bazë i këmbimit në tregun jozyrtar të këmbimit valutor.

Kjo rubrikë synon që të analizojë edhe ecurinë e transaksioneve në këtë treg dhe në zyrat e këmbimit valutor përgjatë dy viteve të fundit (1999 dhe 2000).

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së dytë ka rezultuar:

²² Shih: Cani Sh., Muço M., Baleta T., "Sistemi bankar shqiptar. Probleme të zhvillimit të tij", (analizë vërtetimi), botim i Bankës së Shqipërisë, gusht 2000, fq. 63.

²³ Analizë vërtetimi "Për aktivitetin kreditues"- dhjetor 2000, faqe 22

Pyetja 9, kërkon që bizneset të identifikojnë monedhën më të qëndrueshme në tregun shqiptar. Ofrohen pesë alternativa (domethënë monedha) dhe lejohet dhe zgjedhja e më shumë se njëres prej tyre. Rezultoi se kësaj pyetjeje iu përgjigjën 134 biznese, ose 97.1 për qind e totalit të përgjigjur dhe nga përpunimi **u identifikua si monedha më e qëndrueshme dollari amerikan**, madje në shifra tepër domethënëse, kundrejt monedhave të tjera.

Tabela 61: Shpërndarja e bizneseve sipas opinionit mbi monedhën më të qëndrueshme.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	94.0
Lireta italiane	1.5
Marka gjermane	5.2
Dhrahmia greke	1.5
Të tjera	1.5

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve, 134. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Në tre raste është identifikuar më shumë se një monedhë e huaj.

Pyetja 10, ka për qëllim të plotësojë informacionin e marrë në pyetjen paraardhëse, duke zbuluar arsyet kryesore të zgjedhjes së bërë në këtë pyetje. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 96 biznese, ose 71.6 për qind e atyre që u përgjigjën në pyetjen 9. Në disa raste janë dhënë disa arsye.

Nga përpunimi rezultoi se përzgjedhja e dollarit amerikan si monedha më e qëndrueshme, motivohet me të qënurit e saj si një monedhë e fuqishme, pra me luhatjet më të lehta në kohëzgjatje të vogël. Kjo i jep siguri dhe garanci bizneseve për të zhvilluar aktivitetin e tyre. Kështu u arsyetua në 68 raste apo në 70.8 për qind të bizneseve të përgjigjura.

Në 19.8 për qind të rasteve arsyeja e zgjedhjes së dollarit amerikan është ekonomia e konsoliduar në SHBA.

Në 5 raste (5.2 për qind), është zgjedhur dollari amerikan, sepse ai ka mundësi të larta likuiditeti dhe përdorim më të gjerë. Vetëm në një rast i intervistuari shprehet se, përvoja dhjetëvjeçare e punës me dollarin amerikan, i ka rezultuar e kënaqshme.

Në dy raste janë dhënë shpjegime për zgjedhjen e markës gjermane si monedha më e qëndrueshme: ajo përbën monedhën më të përdorur edhe në vendet fqinje dhe njëkohësisht ka treguar stabilitet më të lartë krahasuar me monedhat e tjera të euro-s, gjatë vitit 2000.

Pyetja 11, synon të identifikojnë monedhën orientuese në procesin e vendimmarrjes tek bizneset. Ofrohen po pesë alternativa dhe lejohet zgjedhja e më shumë se njëres prej tyre. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 126 biznese apo 91.3 për qind e totalit.

Tabela 62: Shpërndarja e bizneseve sipas monedhës orientuese.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	80.0
Lireta italiane	11.9
Marka gjermane	10.3
Dhrahmia greke	0.0
Të tjera	0.0

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve, 126. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Në 11 raste u deklaruan dy monedha orientuese dhe vetëm në një rast 3 të tilla. Siç vërehet, **80 për qind e bizneseve kanë dollarin amerikan si pikë orientuese në veprimtarinë e tyre**, fakt që korrelohet edhe me përfundimin e dalë në pyetjen 9. Si monedhë e qëndrueshme ajo është edhe orientuese në vendimmarrje, sepse stabiliteti i orienton bizneset drejt niveleve më të ulëta të rrezikut.

Lireta italiane, siç edhe pritej, së bashku me markën gjermane vijnë të dytat në radhë, por me një diferencë të konsiderueshme nga dollari.

Pyetja 12, ka për qëllim të mësojë opinionin e bizneseve mbi nevojën e ekzistencës së tregut jozyrtar të këmbimeve valutore. Ajo është e drejtpërdrejtë dhe lejon zgjedhjen e një alternative.

Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 100 për qind e bizneseve. Ndërkohë që **60.1 për qind e tyre janë të mendimit se ky treg është i nevojshëm**, 14.5 për qind mendojnë se ky treg nuk është i nevojshëm. Pjesa e mbetur (25.4 për qind), nuk shprehu opinion rreth këtij tregu.

Pyetja 13, synon të zbulojë arsyen e zgjedhjes në pyetjen 12. Si e tillë ajo konsiderohet e lirë. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 82 biznese, ose 79.6 për qind e atyre që duhej t'i përgjigjeshin. Në disa raste vërehet se janë dhënë disa arsye për zgjedhjen e kryer.

Përgjigjet më të shumta në këtë pyetje i kanë dhënë bizneset, që janë në favor të ekzistencës së tregut valutor jozyrtar. Ky fakt mbështetet edhe në rezultatet e pyetjes 12, ku një pjesë shumë e vogël e bizneseve nuk e mbështesin alternativën e nevojës së tregut jozyrtar valutor. Ata që nuk e mbështesin këtë treg, e justifikojnë qëndrimin e tyre me sigurinë më të madhe që ofrojnë institucionet bankare, kryesisht përballë rrezikut të falsifikimeve.

Tabela 63: Arsyet e preferencës për tregun jozyrtar të këmbimit valutor.

Arsyeja	Operatori	Rastet në %*
- Kurs i favorshëm këmbimi ("leverdi")	Tregu jozyrtar	51.2
- Shpejtësi dhe lehtësi veprimi	Tregu jozyrtar	25.4
- Sistemi bankar jofleksibël, joeficient; mungesa e tregut ndërbankar**;	Tregu jozyrtar	7.3
- Mundësi të mëdha likuiditeti	Tregu jozyrtar	5.1
- Rregullator, ekuilibrues dhe ndihmon konkurrencën	Tregu jozyrtar	4.9
- Orientim dhe burim informacioni për bizneset dhe çmimet	Tregu jozyrtar	3.7

Shënim: * Janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve, 82.

**Në 2 raste kjo arsye është dhënë më e plotë: ndjehet më shumë në periudhat e ardhjes së emigrantëve, kur edhe këmbimet valutore janë më të shumta.

Pyetja 14, kërkon të dijë opinionin e bizneseve mbi faktorin që përcakton vendosjen e kursit të këmbimit në tregun jozyrtar. Kjo është një pyetje cilësore dhe e lirë. U përgjigjën 86 biznese ose 62.3 për qind e totalit. Megjithëse niveli i përgjigjeve është disi më i ulët se ai i hasur në pyetjet paraardhëse, vihet re një opinion kompakt për bazën e vendosjes së kursit të këmbimit në këtë treg. **Mbi gjysma e bizneseve janë të mendimit se kursi që orienton këtë treg është ai ndërkombëtar.** Kursi bankar dhe për më tepër ai i bankës qendrore janë akoma larg orientimit të këtij tregu. Kërkesë-oferta në këtë treg luan rol në vendosjen e kursit dhe në disa raste të intervistuarit shpjegojnë se kjo, është shumë e shprehur në periudhat e ardhjes së emigrantëve.

Tabela 64: Shpërndarja e opinionëve të bizneseve për faktorin që përcakton kursin e këmbimit në tregun jozyrtar të këmbimeve valutore.


Kursi bazë	Rastet në %
Kursi ndërkombëtar	55.8
Kursi bankar	17.4
Kërkesë-oferta	11.6
Nuk ka rregull	7.0
Kursi i bankës qendrore	4.7
Kursi i zyrave të këmbimit valutor	3.5
Totali	100.0

Shënim: *Janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve, 86.

Pyetjet 15 dhe 16, janë të njëjta vetëm se i referohen periudhave të ndryshme. Ato kërkojnë të dinë se si ka qenë raporti i vëllimit të transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar me atë të bankave për vitin 1999 dhe vitin 2000. Krahasimi në vite na lejon të gjykojmë mbi zhvillimin e këtyre dy tregjeve. Niveli i përgjigjeve rezultoi i lartë përkatësisht për dy vitet, 99.3 për qind dhe 98.6 për qind e totalit.

Tabela 65: Evolucionit i vlerësimit të raportit të vëllimit të transaksioneve në tregun jozyrtar me atë të bankave.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Më i madh	26.3	27.2
Më i vogël	17.5	22.1
Nuk ka ndryshuar	27.0	21.3
Nuk e di	29.2	29.4




Vërehet se **situata, sipas opinionit të bizneseve, qëndron përsëri në favor të tregut jozyrtar**. Përsa i takon vëllimit të transaksioneve të kryera në vitin 2000, krahasuar me vitin 1999, deklarohet se ky vëllim është më i madh në tregun jozyrtar se sa në atë bankar me një rritje rreth një pikë përqindjeje nga njëri vit në tjetrin. Me aq pikë përqindjeje sa është ulur opinionit i bizneseve, që mendojnë se tregu jozyrtar realizon më pak transaksione se ai bankar nga viti 1999 në vitin 2000, me afro aq pikë është rritur opinionit se ky treg nuk ka ndryshuar nga njëri vit në tjetrin.

Pyetja 17, është e ngjashme me pyetjet 15 dhe 16. Ajo ka për qëllim të mësojë raportin e vëllimit të transaksioneve, që kryhen nga zyrat e këmbimeve valutore për vitin 1999 dhe vitin 2000, vlerësuar nga këndvështrimi i bizneseve. Pyetja lejon një zgjedhje alternative për secilin vit. Në këtë pyetje për çdo moment kohor u përgjigjën përkatësisht 97.8 dhe 95.7 për qind e totalit (138).

Tabela 66: Evolucionit i vlerësimit të vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrat e këmbimit valutor.

Alternativat	Përgjigjet (në %)	
	1999	2000
Në rritje	45.9	51.5
Në rënie	9.6	9.1
Nuk ka ndryshuar	15.6	11.4
Nuk e di	28.9	28.0



Nëse krahasohen rezultatet për të dy vitet **vërejmë se gjendja për këtë operator është përmirësuar, rritja ka rezultuar me 5.6 pikë përqindjeje në vitin 2000**, krahasuar me një vit më parë.


Sinjalet e dhëna nga rezultatet e pyetjeve 15-17, tregojnë se tregu jozyrtar dhe ai i zyrave të këmbimit kanë peshën më të madhe në rritje. Këto sinjale sipas vlerësimit të bizneseve, janë në disfavor të tregut bankar.

Pyetja 18, është e ngjashme me pyetjen 17. Ajo ka për qëllim të evidentojë preferencat e bizneseve për monedhën/at e përdorur prej tyre nga viti 1999 në vitin 2000. Kjo pyetje lejon disa zgjedhje. U përgjigjën përkatësisht për dy vitet 97.1 dhe 97.8 për qind e totalit të të intervistuarve.

Tabela 67: Evolucionit i preferencave për monedhat e huaja.

Alternativat	Përgjigjet (në %)*	
	1999	2000
Dollari amerikan	59.7	60.7
Lireta italiane	21.6	22.2
Marka gjermane	9.7	9.6
Dhrahmia greke	14.9	14.8

Shënim: *Janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve për çdo vit, përkatësisht 134 dhe 135. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.



Nga rezultatet bie në sy një situatë pothuajse e qëndrueshme, me strukturë të njëjtë, nga njëri vit në tjetrin. Për secilin vit, evidentohet fakti që **dollari amerikan është monedha më e preferuar për bizneset**. Për më tepër, viti 2000, krahasuar me vitin 1999, ka shtuar preferencën e bizneseve për dollarin amerikan me 1 pikë përqindjeje dhe shumë lehtë liritën italiane me 0.6 pikë përqindjeje. Ulje, pothuajse të papërfillshme në preferencat e bizneseve, kanë pësuar marka gjermane dhe dhrahmia greke.

Kjo rrjedh edhe nga natyra e qëndrueshme e bizneseve në aktivitetin e tyre, fakt që i bën ato të qëndrueshme edhe në preferencat e tyre për monedhat me të cilat operojnë.

IV. 4. Pyetjet e rubrikës C "Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë".

Rubrika C përbëhet nga 9 pyetje. Ajo ka për qëllim të tërheqë opinionet e bizneseve lidhur me politikën valutore të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe nëse regjimi i kursit të këmbimit që zbatohet në Shqipëri është apo jo i përshtatshëm për ta. Banka e Shqipërisë është e interesuar që të njohë, më në detaje, gjykimet e këtij operatori rreth politikës së saj.

Nga përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e rubrikës së tretë ka rezultuar:

Pyetja 19, kërkon të zbulojë se si konsiderohet regjimi aktual i kursit të këmbimit parë në syrin e bizneseve. Është një pyetje që lejon vetëm një zgjedhje. Asaj iu përgjigjën 136 biznese, apo 98.55 për qind e totalit.

Pjesa e bizneseve që nuk ka dhënë opinion rezulton e lartë, 47.1 për qind e përgjigjeve. Ndërkohë që bizneset që mbështesin regjimin aktual të kursit të këmbimit përbëjnë 27.2 për qind të të përgjigjurve. Pothuajse po aq, janë ata që nuk e mbështesin këtë regjim (25.7 për qind).

Pyetja 20, ka për qëllim të mësojë arsyen e zgjedhjes në pyetjen paraardhëse. Pra, përse bizneset e mbështesin apo jo këtë regjim. Vetëm 31 biznese kanë dhënë arsyet e tyre. Ata përbëjnë afro 43.1 për qind të bizneseve që duhej të përgjigjeshin. Gjatë fazës së pastrimit të pyetësorëve, u vu re se një pjesë e bizneseve, nuk kishin ide të qarta mbi regjimin e kursit të këmbimit të zbatuar në Shqipëri, ndaj edhe arsyet për zgjedhjet e kryera, ishin të pakuptimta.

Ndër bizneset, që mbështesin regjimin aktual vetëm në 19 raste është identifikuar arsyeja.

Në 16 raste apo në 84.2 për qind të atyre që kanë identifikuar arsyen, deklarohet se kjo formë krijon hapësira më të mëdha për të fituar, sepse edhe luhatjet janë të shpejta. Madje, në dy raste, është specifikuar përparësia e këtij regjimi në këndvështrimin e monedhës me të cilën operojnë më shpesh këto dy biznese, dhrahmisë, e cila duke u zhvlerësuar, u ka krijuar fitime më të mëdha. Në tre rastet e tjera, zgjedhja ka të bëjë me atë që, ky lloj regjimi mundëson edhe parashikimin e ecurisë së aktivitetit të tyre.

Në 12 rastet që janë kundër këtij regjimi, evidentohet motivi i pasigurisë që kjo formë mbart, sepse në pjesën më të madhe gjeneron humbje për bizneset. Këtu, evidentohen rastet e firmave që punojnë me material porositës (10 biznese në Tiranë, Durrës dhe Korçë). Ata pohojnë se forma aktuale e kursit të këmbimit vështirëson punën e tyre. Luhatjet e kursit (rëniët) në dy momente të ndryshme kohore, atij të nënshkrimit të kontratës dhe atij të realizimit të mallit, shpesh shkaktojnë humbje, në disa raste të konsiderueshme për bizneset e tyre. Kështu, në një rast deklarohet: “politika e Bankës së Shqipërisë, për të mbajtur monedhë shqiptare të fortë, krijon probleme për eksportuesit”.

Box 7: A ndikon baza e konvertimit të lekut me monedhat e huaja në zhvillimin e prodhimit? – pjesë nga intervista e një biznesmeni, në numrin 4(6), shkurt 2001, faqe 47, dhënë revistës “Monitor”.

Mendoj se ky është një problem shumë i madh. Unë pyes: -Duhet stimuluar importi apo prodhimi?

Shumica e firmave, që prodhojnë në Tiranë, janë me material porositës, e kryesisht italian.

Viti 2000 tregoi që konvertimi lek-USD stimulon biznesin dhe jo prodhimin. Në vitin 1999 ne patëm të njëjtat të ardhura sa në vitin 2000. Të gjitha të ardhurat tona janë në lireta. Në vitin 1999 kursi mesatar i këmbimit të lretës me lekun për 1000 lireta ishte 0.073 lekë. Në vitin 2000 ishte mesatarisht 0.066 lekë. Vetëm nga kursi ne patëm një humbje të paplanifikuar prej rreth 10 milionë lekë të reja. Është e nevojshme që leku të lidhet me monedhën europiane dhe jo me dollarin amerikan, sepse janë europianët që po investojnë dhe aspak amerikanët.

Janë këto lloj biznesesh, që ndjehen më të ekspozuara përballë rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit. Ato tentojnë drejt situatave fikse, pra preferojnë regjimin fiks të kursit të këmbimit.

Në dy rastet e tjera nënvizohet ideja se, mungesa e stabilitetit në tregun valutor, sjell disavantazhe për bizneset. Në njërin prej dy rasteve shpjegohet më qartë se zhvlerësimi i monedhës italiane, ka shkaktuar humbje të konsiderueshme për biznesmenin e intervistuar (fakt që korrelohet edhe me intervistën në *box-in* paraardhës).

Pyetja 21, kërkon të dijë opinionin e bizneseve lidhur me momentin e shit-bletjeve valutore të kryera nga Banka e Shqipërisë. A është ajo e aftë të zgjedhë momentin e përshtatshëm për të vepruar?

Në këtë pyetje u përgjigjën 100 për qind e bizneseve, por një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk u prononcuan për këtë çështje (52.9 për qind e tyre). Vetëm 21.7 për qind e tyre deklaruan se momenti i zgjedhur nga banka qendrore është i përshtatshëm dhe 25.4 për qind e tyre mendojnë të kundërtën.

Pyetja 22, është në funksion të pyetjes paraardhëse dhe kërkon një shpjegim më të plotë për zgjedhjen e bërë në atë pyetje. Si e tillë ajo është e lirë. Në këtë pyetje u përgjigjën 75.4 për qind e bizneseve që duhej të përgjigjeshin.

Në 25 raste janë dhënë arsyet lidhur me alternativën pozitive.

Kështu në 15 raste shit-bletjet valutore të Bankës së Shqipërisë janë vlerësuar të përshtatshme në momentet kohore, sepse si të tilla ato kanë stabilizuar kursin e këmbimit, për pasojë ato kanë rikthyer qëndrueshmërinë në tregun e këmbimeve valutore përgjatë vitit 2000. Në tre raste këto momente janë konsideruar të përshtatshme, sepse janë kryer duke vëzhguar tregun ndërkombëtar.

Në rastet e tjera (7 raste), thjesht është pohuar se shit-bletjet janë bërë në momentet e duhura, apo në momente kritike.

Në 24 raste përgjigjet kanë dhënë arsyet për zgjedhjen e alternativës negative. Ndër këto, përmendim 9 raste në të cilat bizneset mendojnë se, banka qendrore nuk ka gjetur momentin e përshtatshëm për të kryer këto shit-bletje, për pasojë ato nuk kanë stabilizuar kursin e këmbimit, madje, në ndonjë rast e kanë çrregulluar atë.

Në 7 raste ato janë konsideruar spekulative, duke specifikuar se janë ndërhyrje që kryhen për interesat e vetë bankës dhe jo për të mbrojtur interesat e bizneseve.

Në 5 raste ndërhyrjet janë konsideruar të vonshme në kohë. 2 raste kanë deklaruar se vetë natyra e kursit të këmbimit është e tillë që reagon ngadalë kundrejt shit-bletjeve në tregun valutor.

Pyetja 23, në vazhden e pyetjeve paraardhëse, ka për qëllim të mësojë opinionin e bizneseve lidhur me arritjen e qëllimit nga këto shit-bletje. Në 28.5 për qind të rasteve të përgjigjur opinioni i bizneseve është pozitiv. Ndërsa 15.3 për qind e

tyre mendojnë se banka qendrore nuk ia arrin qëllimit. Pjesa e mbetur nuk shpreh opinion (56.2 për qind).

Pyetja 24, është e ngjashme me pyetjen 22 dhe kërkon të identifikojë arsyen e zgjedhjes në pyetjen 23. Rreth 70 për qind e bizneseve që duhej të përgjigjeshin dhanë arsyet e tyre.

Në 26 raste që janë shprehur se banka ia arrin qëllimit kanë dhënë edhe arsyen. Kështu, në 15 raste ata shprehen se stabiliteti i kërkuar është arritur nëpërmjet veprimeve të kryera prej saj. Në 4 raste opinioni i bizneseve është se banka ka potencial intelektual dhe material (fonde) për ta kryer këtë dhe e arrin qëllimin. Në 6 raste opinioni i tyre është se ajo ia arrin vetëm qëllimeve të veta dhe kënaq ata që organizojnë spekulimin.

Në 1 rast ajo e bën këtë për të konkurruar tregun jozyrtar të këmbimeve valutore.

Në 14 raste gjejmë opinione lidhur me zgjedhjen e alternativës negative, pra që banka nuk ia arrin qëllimit të saj. Në 8 raste arsyeja është e evidente: “veprimet e bankës qendrore janë të vonuara”. Në 5 raste ato bëhen për interesat e vetë bankës. Në një rast, gjejmë arsyen se banka kryen shit-blerje me sasira të pakta parash, prandaj edhe nuk ia arrin qëllimit.

Pyetjet 23 dhe 24 korrelojnë me pyetjet 21 dhe 22. Në 87 për qind të rasteve, ata që mendojnë se veprimet e shit-blerjeve, nuk kryhen në momentin e përshtatshëm, janë të mendimit se me këto këto të fundit ajo nuk ia arrin qëllimit. Pra, opinioni i këtij grupi të bizneseve është plotësisht i konsoliduar në këtë pikë. Ndërkohë, shumica e firmave me material porositës (7 prej tyre), janë të mendimit se banka duhet të veprojë për të mos lejuar luhatje të mëdha, pra të stabilizojë shumë shpejt situatën dhe të krijojë për ta gjendje sa më fikse të kursit të këmbimit.

Pyetja 25, ka për qëllim të shtrijë më tej opinionin e bizneseve për të mësuar më shumë mbi monedhën me të cilën banka duhet të kryejë shit-blerjet më të fuqishme në treg. Pyetjes iu përgjigjën 100 për qind e bizneseve. Për katër monedhat e renditura rezultatet e përgjigjeve janë në vijim:

Tabela 68: Struktura e përgjigjeve sipas monedhës me të cilën duhet të kryhen shit-blerjet valutore.

Alternativa	Në përqindje*
Dollari amerikan	87.0
Lireta italiane	3.6
Marka gjermane	8.0
Dhrahmia greke	3.6

Shënim: * Janë llogaritur ndaj totalit të përgjigjur, 138. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Del qartë se **dollari amerikan konsiderohet nga bizneset, monedha më e përshtatshme për të bërë shit-blerjet valutore**. Monedhat e tjera europiane gjenden në nivele shumë të ulëta, kundrejt monedhës amerikane. Në tre raste u ndeshën prononcime për më shumë se një monedhë. Sidoqoftë, në të trija rastet, dollari amerikan ishte njëra nga alternativat.

Pyetja 26, kërkon të dijë se cilat duhet të jenë, sipas bizneseve, arsyet në bazë të të cilave Banka e Shqipërisë duhet të veprojë në tregun valutitor. Në këtë pyetje u përgjigjën 100 për qind e bizneseve. **Opinionet e tyre mbështet në mënyrë dominante idenë se banka qendrore duhet të kryejë shit-blerje në tregun valutitor, për të ruajtur një stabilitet të kursit të këmbimit (75.4 për qind të rasteve).**

Pyetja 27, kërkon të dijë opinionin e bizneseve mbi peshën që ka monedha europiane, euro, në tregun shqiptar, si edhe ecurinë e saj gjatë periudhës 1999-2000. Interesant është fakti që **mbi gjysma e bizneseve (59.4 për qind) vlerësojnë se euro nuk është fuqizuar në tregun shqiptar gjatë vitit 2000** në raport me vitin 1999, ndërsa 15.2 për qind mendojnë se ajo është fuqizuar. 6.5 për qind e tyre janë të mendimit se përgjatë viteve 1999 dhe 2000, euro nuk ka ndryshuar. Pjesa e mbetur (18.8 për qind), nuk e dinë nëse monedha europiane ka ndryshuar apo jo.

IV. 5. Konkluzione.

Bizneset e mëdha dhe më të mëdhatë që punojnë në Shqipëri, përbëjnë një operator të rëndësishëm në tregun valutitor. Siç evidentohet edhe në analizën kryer për këtë operator, ai vlerësohet në veçanti për konsideratat praktike që shpreh, lidhur me kursin e këmbimit dhe me monedhën orientuese në vendosjen e tij. Opinionet e bizneseve mbi tregun jozyrtar të këmbimeve valutore si edhe mbi politikën e ndjekur nga banka qendrore në pjesën më të madhe të tyre, janë interesante dhe të vlerësueshme për mesazhin që përcjellin. Në një pjesë të konsiderueshme të pyetjeve, rezultatet pajtohen me pritshmëritë dhe gjykimet e kryera nga specialistë pranë Bankës së Shqipërisë.

IV. 5. 1. Gjeografia e transaksioneve.

Bizneset kryejnë transaksione valutore kryesisht me Italinë dhe Greqinë (64 për qind e rasteve). Ky fakt është në përputhje edhe me gjeografinë e partnerëve të tregtisë së jashme dhe atë të emigrantëve shqiptarë (Italia dhe Greqia janë partnerët kryesorë tregtarë dhe dy vendet, ku janë vendosur pjesa më e madhe e emigrantëve shqiptarë). Nga ana tjetër, e treta në rradhë për shpeshësinë e transaksioneve të kryera, ashtu siç pritej, evidentohet Shqipëria.

IV. 5. 2. Monedha më e preferuar.

Vërtetë që shpërndarja gjeografike e transaksioneve, është në favor të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, por kjo nuk ndodh me monedhat përkatëse të vendeve të lartpërmendura. Është dollari amerikan që mbizotëron, në preferencat për të kryer transaksione valutore (në 50 për qind të rasteve).

Ai identifikohet edhe si monedha e huaj më e qëndrueshme në tregun shqiptar (94 për qind e rasteve). Duke rezultuar më e qëndrueshmja ndër monedhat e renditura, dollari amerikan konsiderohet edhe monedha, e cila gëzon vlerat më orientuese në procesin e vendimmarrjes për bizneset. Gjatë periudhës 1999-2000 kjo monedhë ka ruajtur pozicionin e saj të fortë dhe mbizotërues në preferencat e bizneseve, madje duke fituar pikë nga njëri vit në tjetrin.

Bizneset janë të konsoliduara në opinionin e tyre se monedha me të cilën banka duhet të kryejë shit-blerjet në tregun e këmbimeve valutore është dollari amerikan.

Për më tepër informacionet e marra nga ky pyetësor e pozicionojnë dollarin amerikan të parin në rradhë edhe përse i takon preferencave të biznesmenëve lidhur me monedhën në të cilën ata dëshirojnë të mbajnë kursimet e tyre (në 75.2 për qind të rasteve).

Në mjedisin e biznesit mbizotëron opinioni se monedha euopiane, euro, gjatë periudhës 1999-2000 nuk është fuqizuar (rreth 60 për qind të rasteve të përgjigjura).

IV. 5. 3. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore.

Shumica e bizneseve janë të mendimit se ky treg është i nevojshëm. Për më tepër një pjesë e konsiderueshme e tyre veprojnë vetëm me këtë treg (operator) ose e kombinojnë atë me operatorët e tjerë. Në minorancë mbeten bizneset që e konsiderojnë të panevojshëm tregun jozyrtar (14.5 për qind). Preferenca dhe nevoja për tregun jozyrtar të këmbimeve valutore motivohet në pjesën më të madhe të rasteve, me koston më të ulët dhe me shpejtësinë e veprimeve që ky treg ofron.

Ndërkohë që ajo pjesë e vogël e bizneseve që deklarohen kundër këtij tregu, e motivojnë këtë zgjedhje me pasigurinë dhe falsifikimet që ndodhin në këtë treg. Ecuria e tregut jozyrtar në raport me atë zyrtar të këmbimeve valutore për periudhën 1999-2000, mbetet në favor të tregut jozyrtar. Bizneset japin sinjalet se tregu bankar nuk e ka fuqizuar pozicionin e tij në tregun e këmbimeve valutore.

IV. 5. 4. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e bankës qendrore.

Pjesa e bizneseve që nuk janë prononcuar për këtë çështje të rëndësishme, vlerësohet të jetë e lartë. Mëse gjysma e tyre nuk japin opinionin lidhur me regjimin e kursit të këmbimit. Kjo dëshmon për një shkallë të ulët njohjeje nga ana e bizneseve, të politikës së ndjekur nga Banka e Shqipërisë. Për këtë arsye konkluzionet e këtij operatori lidhur me këtë çështje duhet të merren me rezervë.

Nga ana tjetër, do të theksonim se bashkëpunimi i ulët i bizneseve në këtë pyetje nënvizon faktin që edhe Banka e Shqipërisë nga ana e saj duhet të rrisë transparencën dhe kontaktet me ta, pra, në fund të fundit, të luajë një rol edukues më intensiv për probleme që lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e bizneseve dhe lidhjeve të tyre me bankat.

Regjimi aktual i kursit të këmbimit është mbështetur vetëm në 27.2 për qind të rasteve dhe në pothuajse po aq nuk mbështetet fare. Bizneset, që e mbështesin këtë regjim, e motivojnë zgjedhjen e tyre me mundësitë që ky i fundit u ofron për të fituar më shumë.

Në të kundërt shprehen pjesa më e madhe e bizneseve që nuk e mbështesin këtë regjim, duke nxjerrë në pah elementet më të larta të pasigurisë, që ky i fundit mbart. Përballë rrezikut të humbjeve nga luhajtjet e kursit të këmbimit, ndjehen më të ekspozuara firmat që punojnë (prodhojnë) me material porositës. Del qartë, se bizneset tona ende nuk janë edukuar të punojnë në kushtet e një ekonomie tregu, ku edhe pasiguria ka koston e saj. Kjo kosto duhet të parashikohet si e tillë, ndërsa administratorët duhet ta evidentojnë këtë fakt në momentin e vendimmarrjes, pra edhe të nënshkrimit të kontratave. Nga ana tjetër, ky fenomen nxjerr në pah domosdoshmërinë e zhvillimit të instrumenteve mbrojtëse.

Momentet e shit-blerjeve valutore nga banka qendrore janë konsideruar të përshtatshme nga rreth 22 për qind e bizneseve dhe, për më tepër, ato kanë stabilizuar kursin e këmbimit, si të tilla ato ia kanë arritur qëllimit duke shmangur edhe spekulimet e mundshme në treg. Në të njëjtën masë këto momente janë konsideruar të papërshtatshme

Bizneset (e mëdha dhe më të mëdha), e konsiderojnë dollarin amerikan si monedhën më të qëndrueshme dhe për më tepër orientuesen e tyre në vendimmarrje. Për ta monedha amerikane ka ardhur duke e forcuar pozicionin e saj në tregun shqiptar, në të kundërt, pesha e monedhës europiane, euro, në këtë treg nuk është fuqizuar.

Pyetësoni për bizneset.

A. Informacione të përgjithshme

Pyetja 1. Cili është lloji i aktivitetit që ushtroni? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Industri	1
Ndërtim	2
Tregti	3
Shërbime	4
Transport	5
Bujqësi	6

Pyetja 2. Cili është vendi kryesor me të cilin ju kryeni shumicën e transaksioneve? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Italia	1
Greqia	2
Turqia	3
Gjermania	4
Bullgaria	5
Maqedonia	6
Shqipëria	7
Të tjera	8

Specifikoni: _____!_!

Pyetja 3. Cila është monedha me të cilën operoni më shpesh? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4
Leku	5
Të tjera	6

Specifikoni: _____!_!

Pyetja 4. Sa transaksione valutore në muaj kryeni mesatarisht?

1-2	1
3-5	2
mbi 5	3

Pyetja 5. Sa është vlera mesatare për çdo transaksion në dollarë amerikanë?

Pyetja 6. Në ç'monedhë preferoni të mbani kursimet tuaja? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmi greke	4	
Lekë	5	
Të tjera	6	Specifikoni: _____!_!

Pyetja 7. Preferoni të këmbeni paratë tuaja: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Në bankë?	1
Në ZKV?	2
Në tregun informal (kambistë të lirë)?	3
Kombinim i varianteve të mësipërme?	4

Pyetja 8. Jepni arsyen/t për zgjedhjen në pyetjen 7:

_____!_!

B. Opinione për organizimin e tregut valutor.

Pyetja 9. Cila mendoni se është valuta më e qëndrueshme tek ne? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni: _____!_!

Pyetja 10. Jepni arsyen për zgjedhjen në pyetjen 9:

_____!_!

Pyetja 11. Cila monedhë e huaj përbën pikën orientuese në aktivitetin tuaj? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmia greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni: _____!_!

Pyetja 12. A e vlerësoni të nevojshëm tregun jozyrtar të këmbimeve valutore?

Po 1
Jo 2
Pa opinion 3

Pyetja 13. Jepni arsyen, nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 12:

_____ !_! ?

Pyetja 14. Cili është, sipas mendimit tuaj, kursi mbi të cilin bazohet vendosja e kurseve të këmbimit në tregun jozyrtar? _____ !_!

Pyetja 15. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryenit në tregun jozyrtar në vitin 1999, krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Më i madh 1
Më i vogël 2
Nuk ka ndryshuar 3
Nuk e di 4

Pyetja 16. Cili mendoni se është raporti midis vëllimit të transaksioneve që kryeni aktualisht në tregun informal (në vitin 2000), krahasuar me vëllimin e transaksioneve me bankat? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Më i madh 1
Më i vogël 2
Nuk ka ndryshuar 3
Nuk e di 4

Pyetja 17. Mendoni se pjesa e tregut të kembimeve valutore e zotëruar nga ZKV, në këto dy vitet e fundit ka ardhur (Për dy momentet kohore zgjidhni vetëm një mundësi.)

viti 1999		viti 2000	
në rritje?	1	në rritje?	1
në rënie?	2	në rënie?	2
nuk ka ndryshuar?	3	nuk ka ndryshuar?	3
nuk e di?	4	nuk e di?	4

Pyetja 18. Cila është valuta me të cilën ju keni preferuar të operoni dhe preferoni aktualisht të operoni më shpesh? (Për secilin moment kohor mund të zgjidhni më shumë se një nga valutat e mëposhtme.)

viti 1999

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4

viti 2000

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4

C. Opinione për disa aspekte të politikës valutore të Bankës së Shqipërisë.

Pyetja 19. A ju krijon përparësi në punën tuaj regjimi aktual i kursit të këmbimit? (Të jepet një sqarim për këtë regjim.)

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 20. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 19.

?!.

Pyetja 21. A mendoni se shit-blerjet valutore të Bankës së Shqipërisë në tregun valutor për ndryshimin e kursit të këmbimit, kryhen në momentin e përshtatshëm?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 22. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 21.

!_!?

Pyetja 23. A mendoni se nga këto transaksione ajo ia arrin qëllimit?

Po	1
Jo	2
Pa opinion	3

Pyetja 24. Jepni arsyen nëse keni zgjedhur 1 apo 2 në pyetjen 23.

!_!

Pyetja 25. Cila do të ishte, sipas mendimit tuaj, monedha më e përshtatshme për të kryer transaksionet në treg? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollari amerikan	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmia greke	4

Pyetja 26. Për ç'qëllim duhet të veprojë në treg Banka e Shqipërisë?

Zhvlerësim	1
Vlerësim	2
Ruajtje të një kursi stabël	3
Pa opinion	4

Pyetja 27. Mendoni se euro është fuqizuar në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999?

Po	1
Jo	2
Nuk ka ndryshuar	3
Nuk e di	4

Faleminderit për bashkëpunimin!

KAPITULLI V: REZULTATET E DALA NGA PËRPUNIMI I INFORMACIONIT TË PYETËSORIT PËR QYTETARËT

V.1. Informacion i përgjithshëm.

Grupi i qytetarëve përbën një tjetër operator në tregun valutor. Pësia e tij është e rëndësishme, megjithëse ai nuk nënkupton rolin e “profesionistit të mirëfilltë” në “lojën e madhe” të tregut. Ai luan si një “amator”, por që në një farë kuptimi ndjen se çfarë ndodh rreth tij dhe si duhet të veprojë. I trajtuar në këtë mënyrë, grupi i individëve, vihet përballë një pyetësi më të thjeshtë parë në këndvështrimin teknik, por me pyetje më specifike në këndvështrimin e përgjithshëm. Opinione dhe dhëna nga ky operator zënë një vend të rëndësishëm në pyetësor. Vëllimi i zgjedhjes prej 100 individësh të intervistuar dhe të zgjedhur nga specialistë të INSTAT, sipas disa kritereve të shpjeguara tashmë, konsiderohet i mjaftueshëm për qëllimin e studimit.

Pyetësi përmban 14 pyetje të vendosura në një rubrikë të vetme. Nga procesi i intervistimit u vu re një bashkëpunim i mirë i qytetarëve 100 për qind e të zgjedhurve pranuar të intervistoheshin. Ky fakt dëshmohet nga niveli i lartë i përgjigjeve si në pyetje me karakter sasior e cilësor, ashtu edhe në ato që kërkojnë përgjigje të lira. Kështu, për pyetje sasiore rezultoi një nivel shumë i lartë i përgjigjeve, madje edhe për pyetje delikate, që kanë të bëjnë me deklarin në kufij të caktuar të të ardhurave mesatare mujore apo të kursimeve. Kështu për të ardhurat u përgjigjën 100 për qind e të intervistuarve dhe për kursimet 99 për qind e tyre. Kuptohet, që në pyetje të tilla niveli i besueshmërisë së përgjigjeve, vlen të diskutohet. Parë në këtë aspekt do të nënvizojmë se:

- * qëllimi i intervistimit nuk cënon aspak të ardhurat dhe kursimet e qytetarëve, si edhe aspekte të tjera të veprimtarisë së tyre (nuk bëhet për arsye të zbatimit të tatimeve apo të detyrimeve të ndryshme);
- * intervista dhe analiza ruan krejtësisht konfidencialitetin e informacionit;
- * mënyra e ndërtimit të pyetjeve me zgjedhje alternativash, të cilat përbëjnë intervale vlerash dhe jo vlera të veçanta, bën që qytetarët të jenë më realistë në përcaktimin e grupit të cilit i përkasin.

Të gjitha arsyetimet e mësipërme e bëjnë informacionin më të besueshëm.

Edhe në pyetjet me karakter cilësor, ku janë dhënë modalitetet dhe kërkohet zgjedhja e një apo disa alternativave, shkalla e përgjigjeve luhet nga 87 për qind në 100 për qind, nivele të konsideruara mëse të kënaqshme për të kryer analiza. Në pyetjet të cilat kërkojnë dhënie opinionesh apo arsyesh, konstatohet një shkallë përgjigjeje gjithashtu e kënaqshme, që luhet nga 47 për qind në 81 për qind. Këto nivele të përgjigjeve, shoqërohen në pjesën më të madhe të pyetjeve, edhe me një shkallë të pranueshme të logjikës që i lidh ato.

V.2. Përpunimi i informacionit të marrë për pyetjet e anketës për qytetarët.

Pyetja 1, ka për qëllim të vlerësojë të ardhurat mesatare mujore të individëve dhe t'i grupojë ata sipas këtyre të ardhurave. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën të gjithë të intervistuarit. Sqarojmë se tek të ardhurat përfshihen të gjitha hyrjet në familje brenda muajit nga të gjitha burimet. Ky informacion është kërkuar dhe është dhënë i konvertuar në lekë²⁴.

Vihet re një luhatje e lartë e të ardhurave mesatare mujore, pra një variacion me një gjerësi që lëviz nga 15 mijë lekë në rreth 470 mijë lekë.

Tabela 69: Shpërndarja e të ardhurave mesatare mujore.

Të ardhurat mesatare mujore (në lekë)	Rastet (në %)	Frekuenat kumulative rritëse (në %)
15000	1.0	1.0
18271	1.0	2.0
18500	1.0	3.0
18780	1.0	4.0
22000	1.0	5.0
25000	2.0	7.0
26000	1.0	8.0
26371	1.0	9.0
27000	1.0	10.0
28482	1.0	11.0
28694	1.0	12.0
30000	4.0	16.0
34847	1.0	17.0
35000	4.0	21.0
35882	1.0	22.0
38000	1.0	23.0
38823	1.0	24.0
38847	1.0	25.0
40000	6.0	31.0
43280	1.0	32.0
43742	1.0	33.0
44780	1.0	34.0
45000	7.0	41.0
45347	1.0	42.0
45705	1.0	43.0
46700	1.0	44.0
46847	1.0	45.0
47882	1.0	46.0
50000	7.0	53.0
51895	1.0	54.0
54823	1.0	55.0
55000	1.0	56.0
55694	1.0	57.0
56847	1.0	58.0

²⁴ Për konvertimin në lekë të shumave në valutë të huaj janë përdorur kurset mesatare vjetore të këmbimit për vitin 2000.

60000	7.0	65.0
62371	1.0	66.0
66847	1.0	67.0
68823	1.0	68.0
69557	1.0	69.0
70000	4.0	73.0
72000	1.0	74.0
73694	1.0	75.0
74000	1.0	76.0
78000	1.0	77.0
78788	1.0	78.0
80000	3.0	81.0
80270	2.0	83.0
81555	1.0	84.0
82000	1.0	85.0
86528	1.0	86.0
88895	1.0	87.0
89855	1.0	88.0
90000	2.0	90.0
94820	1.0	91.0
100000	1.0	92.0
100690	1.0	93.0
101800	1.0	94.0
120000	1.0	95.0
140000	1.0	96.0
160000	1.0	97.0
200000	1.0	98.0
255565	1.0	99.0
470541	1.0	100.0
Totali	100.0	

Në rastet e përgjigjura vihet re fenomeni i frekuencave të rralla (me vlera 1) për një pjesë të serisë së të ardhurave mesatare mujore që pasohen me rritje në trajtë kapërcimesh (vlera më të larta të frekuencave) për të dhëna të veçanta të kësaj serie. Ky fenomen është i shpjgueshëm. Ai shoqëron përgjithësisht procesin e plotësimit të anketave, kryesisht në pyetje që kërkojnë vlerësime numerike. Prirja e individëve është të japin shifra të plota (apo të rrumbullakosura), pranë niveleve reale. Ata kanë aftësinë të perceptojnë më mirë dhe më shpejt vlera të tilla²⁵.

Nga përpunimi rezultoi një **nivel mesatar i të ardhurave mujore rreth 63.7 mijë lekë për pyetësor**. Në fakt, këto të ardhura janë të ardhura mesatare për familje, sepse qytetarët e intervistuar, përfaqësojnë në çdo rast kryefamiljarët të cilët supozohet se njohin më mirë se çdo anëtar tjetër i familjes situatën ekonomike të saj. Ndërkohë, rreth gjysma e të intervistuarve deklaruan se kanë deri në 50 mijë lekë të ardhura mujore.

²⁵ Kështu të ardhurat mesatare mujore deklarohen më lehtë në shifrën 40 mijë lekë dhe kjo vlerë ka si frekuencë 6 qytetarë të përgjigjur, sesa vlerat 38.9 mijë lekë apo 43.3 mijë lekë, të cilat janë rreth vlerës 40 mijë lekë të të ardhurave. Si të tilla ato deklarohen vetëm një herë.





Tabela 70: Shpërndarja e familjeve sipas grupeve të të ardhurave mesatare mujore.

Grupet e të ardhurave (mijë lekë)	15-35	35-55	55-75	75-95	95-115	115 e lart	Totali
Rastet (në %)	17	38	21	15	3	6	100
Mesatarja e grupit (në mijë lekë)	25.526	43.883	64.516	84.065	100.830	224.351	63.659

Siç vërehet ekziston një asimetri në përqëndrimin e vendosjes së rasteve në të majtë, fakt që dëshmon se familjet me të ardhura mesatare mujore deri në rreth 45 mijë lekë në muaj përbëjnë afro 36 për qind të të intervistuarve. Ndërsa vetëm 6 për qind e tyre deklarojnë se kanë mbi 115 mijë lekë të ardhura në familje. Pra, rreth 2.6 herë më shumë se grupi më përfaqësues brenda zgjedhjes.



Niveli mesatar i të ardhurave për familje rezultoi në 63.7 mijë lekë²⁶.

Nëse do të llogaritej një nivel mesatar i të ardhurave vetëm për katër grupet e para të tabelës, ku janë përqëndruar numri më i madh i rasteve, ai do të rezultonte rreth 52.5 mijë lekë për familje. Kjo vlerë gjendet në pjesën e sipërme të intervalit të grupit me të ardhura të vogla, ose më saktë, gjendet në kufijtë midis dy grupeve (atij me të ardhura të vogla dhe atij me të ardhura të mesme).

Pyetja 2, kërkon që i intervistuari të zgjedhë një nga alternativat e paraqitura për nivelin e kursimit të të ardhurave. Kjo pyetje ka për qëllim të krijojë një ide rreth nivelit mesatar të kursimit të të ardhurave të qytetarëve dhe të na ndihmojë në vlerësime të treguesve të tjerë, të cilët kanë nevojë të rishihen në situatat në të cilat kalon ekonomia, shoqëria dhe përgjithësisht vendi. Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 98 qytetarë apo 98 për qind e rasteve të pyetur. Sipas intervaleve të renditura, në pyetësor rezultoi:

Tabela 71: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave mujore.

Kursimi (në %) ^{*27}	Rastet në (%)	Frekuenca kumulative rritëse (në %)
0	18.4	18.4
0-20	48.0	66.3
20-40	20.4	86.7
40-60	11.2	98.0
40-60	2.0	100.0
Totali	100.0	

Shënim: * Për intervalin mbi 80 për qind nuk pati asnjë deklaram nga qytetarët.

²⁶Intervali besimi për nivelin mesatar të të ardhurave luhetet nga 52.8 mijë lekë në 74,5 mijë lekë. Ai është vlerësuar me një koeficient besueshmërie 95 për qind.

²⁷ Për intervalin mbi 80 për qind nuk pati asnjë deklaram nga qytetarët.

Pra rreth **18.4 për qind e qytetarëve nuk mund të kursejnë aspak. Koeficienti mesatar i kursimit për të intervistuarit e përgjigjur se kursejnë** (80 persona), llogaritet nga një mesatare e ponderuar dhe **rezultoi 21.5 për qind e të ardhurave mesatare mujore.**

Ky koeficient nëse aplikohet në të ardhurat mesatare mujore, mund të shërbejë si një vlerësim për vëllimin e kursimeve në total. Ndërkohë, **një familje qytetare kryeqytetase, në një muaj mund të kursejë mesatarisht rreth 13.7 mijë lekë.** Kuptohet, këtu nuk bëjnë pjesë familje me të ardhura të ulëta, të cilat kanë deklaruar se nuk mund të kursejnë.

Po të kombinohet pyetja 1 me pyetjen 2 vërehet se individët që kanë deklaruar se nuk kursejnë i përkasin grupit të parë dhe gjysmës së parë të grupit të dytë të tabelës 70. Në familjet e tyre hyjnë nga 15 mijë në 45 mijë lekë të ardhura në muaj. Pra, koeficienti i kursimit mund të aplikohet mbi shumat 46 mijë lekë.

Nëse do të kombinohen të dhënat e grupuara për të ardhurat dhe kursimet do të kishim rezultatet në vijim:

Tabela 72: Niveli i mesatar i kursimit sipas të ardhurave mesatare mujore.

Grupi i të ardhurave (në mijë lekë)	Kursimi mesatar (në %)	Rastet
15-35	5.0	18
35-55	13.9	36
55-75	21.4	21
75-95	27.3	15
95-115	50.0	3
115 e lart	52.5	5
Totali	18.7 ²⁸	98

Nga kjo tabelë krijohet një ide rreth mesatares së kursimit për çdo grup të ardhurash. **Evidentohet një lidhje pozitive rritëse, pothuajse e njëtrajtshme deri në nivelin e të ardhurave 95 mijë lekë.** Rritja e fortë dhe e menjëhershme që pason (intervali i të ardhurave të mëdha 95-115 mijë lekë), i dedikohet vlerave të pakta në këto intervale të ardhurash (frekuencave të vogla). Kjo rritje normalizohet më pas në intervalin e fundit.

Duket qartë jo vetëm që ekziston një lidhje pozitive ndërmjet këtyre dy treguesve, por edhe që vlerësohet të jetë në nivele pranë lidhjeve mesatarisht të forta me një koeficient korrelacioni 0.5. Në fakt, në sjelljen e qytetarëve përballë kursimit nuk ndikon vetëm niveli i të ardhurave, por edhe një varg faktorësh të tjerë ekonomikë, socialë, kulturorë, politikë, psikologjikë, etj..

²⁸ Niveli mesatar i kursimit rezulton 18.7 për qind, pra më i ulët se ai i llogaritur më parë, sepse në këtë llogaritje janë marrë parasysh të gjitha vlerat (edhe individët që deklarojnë se nuk kursejnë).

Pyetja 3, kërkon të dijë nëse nga totali i të ardhurave ka të tilla në valutë. Ajo pasohet nga një tjetër pyetje, e cila ka për qëllim të identifikojë valutën në të cilën këto të ardhura janë. Pra, këto dy pyetje shërbejnë si pikënisje për të analizuar sjelljen e individëve përballë monedhave të huaja dhe përdorimit të tyre. Nga përpunimi i pyetjes 3 rezultoi se asaj iu përgjigjën 99 qytetarë, apo 99 për qind e totalit.

Rreth 70.7 për qind e të intervistuarve të përgjigjur deklaruan se kanë të ardhura në valutë dhe 29.3 e tyre nuk kanë të tilla. Pra, një pjesë e konsiderueshme e të përgjigurve kanë të ardhura në valutë dhe për pasojë, operojnë me këto të ardhura në forma të ndryshme (konsum apo kursim). Ky fakt, shpjegon edhe përdorimin e gjerë të valutës në Shqipëri.

Pyetja 4, identifikon monedhat në të cilat janë këto të ardhura. Kjo pyetje lejon më shumë se një zgjedhje ndër monedhat e rradhitura. Të gjithë individët që u përgjigjën pozitivisht në pyetjen 3 (69 qytetarë deklaruan se kanë të ardhura në valutë), deklaruan edhe monedhën/at e huaja në të cilat i kanë këto të ardhura.

Tabela 73: Shpërndarja e të ardhurave në valutë sipas monedhave.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	42.3
Lireta italiane	29.0
Marka gjermane	13.0
Dhrahmia greke	18.8
Të tjera	2.9

Shënim: * Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigurve në këtë pyetje, 69. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Evidentohet fakti që **të ardhurat në dollarë amerikanë ndeshen më shpesh.** Më rrallë janë ato në marka gjermane. Nëse do të aplikonim një mesatare të rasteve të ndeshjes së monedhave përbërëse të monedhës europiane, ato ndeshen mesatarisht në 14 të intervistuar. Pra, rreth 2 herë më rrallë se dollari amerikan.

Në tre raste qytetarët deklaruan se kanë të ardhura në më shumë se një monedhë të huaj. Në të trija këto raste, një nga këto monedha është dollari amerikan. Si monedhë e dytë është zgjedhur një nga nënfishat e euro-s. Ndër monedhat e tjera të zgjedhura janë specifikuar dy raste ku në njërin është identifikuar monedha zvicerane dhe ajo angleze dhe në rastin tjetër vetëm monedha angleze.

Pyetja 5, ka si qëllim të evidentojë deri diku, burimin e të ardhurave në monedhë të huaj. Duke ditur se një nga burimet kryesore të tyre është emigracioni, pyetja jep informacionin e parë për këtë burim të ardhurash, të konsideruar të rëndësishëm, pse jo edhe jetik për një pjesë të popullsisë.

Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 69 persona, apo 100 për qind e atyre që duhej t'i përgjigjeshin. Ky fakt dëshmon për kuptim të mirë të pyetjeve nga ana e qytetarëve.

Nga të përgjigjurit deklaruan se kanë të ardhura nga emigrantët 42 familje apo 60.9 për qind e tyre dhe pjesa tjetër, 27 familje (39.1 për qind), deklaruan se të ardhurat e tyre i kanë nga burime të tjera.

Nëse do të kombinoheshin rezultatet në pyetjet 1 dhe 5, mund të realizohet një krahasim ndërmjet nivelit të të ardhurave mesatare në familjet që deklarojnë se kanë të ardhura nga emigrantët me ato që deklarojnë se nuk kanë të ardhura në monedhë të huaj. Rezulton se **familjet me të ardhura nga emigrantët kanë rreth 2.3 herë më shumë se ato që nuk kanë të ardhura të tilla**, pjesa tjetër nuk ka të ardhura të tilla (58).

Pyetja 6, ka natyrë të ngjashme me pyetjen katër, por në këtë rast identifikohen të ardhurat nga emigracioni sipas monedhave të huaja. Edhe kjo pyetje lejon më shumë se një zgjedhje. Në këtë mënyrë mundësohet kryerja e një analize paraprake rreth preferencave të emigrantëve për dërgesat e tyre sipas monedhave.

Kësaj pyetjeje iu përgjigjën 100 për qind e individëve, të cilët deklaruan se kanë të ardhura nga ky burim. Nga përgjigjet rezultoi se këto të ardhura sipas monedhave të huaja rradhiten sipas rasteve të ndeshjes në vijim:

Tabela 74: Shpërndarja e dërgesave të emigrantëve sipas llojit të monedhave.

Monedha e huaj	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	26.2
Lireta italiane	38.1
Marka gjermane	11.9
Dhrahmia greke	28.6
Të tjera	2.4

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve pozitivisht në pyetjen 5, (42). Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Tre individë kanë deklaruar më shumë se një monedhë të huaj në të ardhurat nga emigrantët. Kombinimet kanë qenë midis dollarit amerikan dhe njëres nga monedhat europiane (në dy raste) dhe në një rast midis liritës italiane dhe drahmisë greke.

Në rastin e deklaruar si monedhë tjetër është identifikuar monedha angleze.

Një numër i lartë rastesh vihet re në deklarimin e monedhës italiane e më pas asaj greke, ndryshe nga struktura e emigracionit. Ndërkohë që dollari amerikan rradhitet i treti. Nëse mesatarizohet numri i rasteve të ndeshura për nënfishat e euro-s, ai do të rezultonte i ndeshur në 11 herë, ose në 26.2 për qind të rasteve të përgjigjur, pra po aq sa dollari amerikan.

Pyetja 7, është një pyetje me karakter sasior dhe kërkon të vlerësojë të ardhurat nga emigracioni. Deklarimet e të ardhurave janë bërë në monedha të ndryshme, por për efekte analize ato janë konvertuar në dollarë amerikanë duke patur për bazë kursin mesatar të këmbimit për vitin 2000.

Nga përpunimi u vu re se 100 për qind e individëve, që duhej të përgjigjeshin, deklaruan shumën mesatare mujore të të ardhurave nga emigrantët. Nga llogaritjet e 42 deklarimeve në total u arrit në këto përfundime:

- niveli mesatar i të ardhurave nga emigrantët në muaj është rreth 167 dollarë amerikanë;
- niveli i medianës për këto të ardhura është afro 89 dollarë amerikanë, që do të thotë se 50 për qind të familjeve (të intervistuarve), kanë si të ardhura mujore nga emigrantët deri në 89 dollarë amerikanë ndërsa pjesa tjetër mbi këtë vlerë;
- vlera më e ulët e këtyre të ardhurave shënon shifrën 47 dollarë amerikanë;
- vlera më e lartë e këtyre të ardhurave shënoi shifrën 1500 dollarë amerikanë;
- intervali i besimit për të ardhurat mesatare luhatet në kufijtë nga 92 deri në 243 dollarë amerikanë²⁹.

Vlera minimale dhe të përafërta me të, ndeshen me frekuenca të konsiderueshme, ndërsa ajo maksimale ndeshet vetëm një herë dhe si e tillë deformon nivelin mesatar.

U pa e arsyeshme që kjo vlerë, si e rrallë që është, të eliminohet dhe mesatarja të aplikohet mbi 41 të dhëna duke e modifikuar këtë të fundit **në rreth 134 dollarë amerikanë për familje** me të ardhura të tilla.

Tabela 75: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të të ardhurave nga emigrantët.

Grupet (në usd)	Rastet	Në (%)
Deri në 50	10	23.8
50-100	15	35.7
100-200	9	21.3
200-300	3	7.2
300-500	2	4.8
500-600	2	4.8
600 e lart ³⁰	1	2.4
Totali	42	100.0

²⁹ Interval i besimit është llogaritur me koeficient besueshmërie 95 për qind.

³⁰ Rasti që ka deklaruar se ka të ardhura 1500 usd në muaj.

Për qëllim analize mund të kombinohen të dhënat e pyetjes 1 me ato të pyetjes 7. Në këtë mënyrë mundësohet analiza e shpërndarjes së familjeve sipas të ardhurave mesatare mujore dhe sipas të ardhurave mujore nga burimi i emigracionit.

Tabela 76: Shpërndarja e familjeve sipas të ardhurave mujore dhe atyre nga emigracioni.

Grupet e të ardhurave nga emigrantët (në usd)	Grupet e të ardhurave (në mijë lekë)						Nr. raste
	15-35	35-55	55-75	75-95	95-115	Mbi 115	
Deri në 50	2	5	3	0	0	0	10
50-100	4	5	4	2	0	0	15
100-200	2	3	2	2	0	0	9
200-300	0	1	0	2	0	0	3
300-500	0	1	1	0	0	0	2
500-600	0	0	0	1	1	0	2
Mbi 600	0	0	0	0	0	1	1
Totali	8	15	10	7	1	1	42

Sic evidentohet në tabelë të ardhurat nga emigrantët u dërgohen më shpesh familjeve që kanë të ardhura mesatare mujore deri në nivele mesatare apo pranë mesatares. Konkretisht, përqëndrimi i tyre vlerësohet të jetë deri në 76 për qind e familjeve që deklarojnë se kanë të ardhura nga emigrantët. Ndërkohë që këto dërgesa, në të shumtën e rasteve, arrijnë deri në vlerat 200 dollarë amerikanë.

Shpërndarja e vlerave të tjera mbi 75 mijë lekë dëshmon për faktin se në familjet, ku të ardhurat mesatare mujore janë më të larta edhe nevojat për të ardhura (nga emigrantët), janë më të pakta, ndaj edhe intensiteti i ndeshjes së këtyre rasteve është më i ulët.

Pyetja 8, është e ngjashme me pyetjen 2 të këtij pyetësori. Edhe në këtë pyetje kërkohet të bëhet vetëm një zgjedhje ndër variantet e paraqitura. Kjo pyetje na lejon të gjykojmë rreth koeficientit mesatar të kursimit për këtë grup të ardhurash. Nga përpunimi rezultoi se kësaj pyetjeje iu përgjigjën 40 qytetarë, apo rreth 95.2 për qind e atyre që duhej t'i përgjigjeshin.

Tabela 77: Shpërndarja e familjeve sipas nivelit të kursimit të të ardhurave nga emigrantët.

Grupet (në %)	Rastet	Në %
0	5	12.5
0-20	13	32.5
20-40	11	27.5
40-60	2	5.0
60-80	4	10.0
80-100	5	12.5
Totali	40	100.0

Vihet re se 5 raste apo 12.5 për qind të të intervistuarve nuk mund të kursejnë aspak nga të ardhurat e emigrantëve.

Rreth 60 për qind e tyre kursejnë deri në 40 për qind të të ardhurave mujore nga emigracioni. Tërheqin vëmendjen rastet kur këto të ardhura kursehen në nivele shumë të larta, nga 80-100 për qind. Si të tillë janë deklaruar në 12.5 për qind të rasteve, po aq sa deklarime që nuk kursejnë aspak. Këto raste i përkasin nivelit të të ardhurave mesatare mujore mbi 450 mijë lekë në muaj.

Koeficienti mesatar i kursimit del nga një mesatare e ponderuar dhe merr parasysh vetëm rastet që deklarohen se kursejnë. Si i tillë ai **rezultoi 36.9 për qind**. Pra, nëse do të kombinohej rezultati i mësipërm me atë të dalë nga pyetja 7 rreth nivelit mesatar të të ardhurave nga emigrantët, mund të vlerësohet një nivel mesatar i kursimit në dollarë amerikanë. Ai vlerësohet të jetë rreth 62 dollarë amerikanë.

Box 8: Llogaritja e koeficientit mesatar të kursimit të të ardhurave nga emigracioni, për nevoja të rivlerësimit të tij në bilancin e pagesave.

Meqenëse vrojtimi sjell informacionet më të fundit mbi të ardhurat nga emigracioni dhe mbi nivelin e kursimit të tyre, mundet që këto të fundit të shfrytëzohen edhe në rivlerësimin e treguesit të koeficientit mesatar të kursimit të dërgesave të emigrantëve për nevoja të bilancit të pagesave. Në këtë rast, lidhur me specifikat e metodikës së llogaritjes së tij, koeficienti mesatar i kursimit, do të merrte parasysh edhe familjet në të cilat deklarohet se nuk kursehet aspak nga këto të ardhura. Zbatimi i mesatares aritmetike të ponderuar do të kryhet mbi të gjitha të dhënat e tabelës 78, pra pa përjashtuar grupin që deklaron se nivelin e kursimit e ka 0, dhe që në vrojtimin tonë ka pesë deklarime të tilla.

Kjo mesatare rezulton rreth 32.3 për qind, pra 4.6 pikë përqindje më poshtë se sa mesatarja që nuk merr parasysh grupin që deklaron se nuk kursen.

Nga kombinimi i pyetjes 7 me pyetjen 8 vihet re se rastet që deklarohen se nuk kursejnë, i përkasin grupeve të të ardhurave deri në 100 dollarë amerikanë, pra grupeve të piramidës me të ardhura shumë të vogla dhe të vogla.

Kombinimi i pyetjes 2 me pyetjen 8, mundëson krahasimin e sjelljes së individëve përballë kursimit të të ardhurave në total dhe atij të të ardhurave nga emigrantët.

Tabela 78: Krahasimi i sjelljes së qytetarëve kundrejt nivelit të kursimit të të ardhurave.

Kursimi (në %)	Rastet (në %) për deklarimet e kursimit	
	Në të ardhurat totale	Në të ardhurat nga emigrantët
0	18.4	12.5
0.20	48.0	32.5
20-40	20.4	27.5
40-60	11.2	5.0
60.80	2.0	10.0
80-100	0.0	12.5
Totali	100.0	100.0

Në përgjithësi vihet re e njëjta tendencë kursimi për të dyja llojet e të ardhurave, deri në nivelin e kursimit 60 për qind. Më pas, kjo tendencë prishet dhe kjo është normale: të ardhurat në total, nuk mund të kursehen në nivele shumë të larta, vetëm një pjesë shumë e vogël mund ta aplikojë këtë (2 për qind e të intervistuarve). Këtë e dëshmon edhe fakti që në grupin e kursimit të të ardhurave në total, 80-100 për qind, nuk ka asnjë deklaram. Ndërkohë që, për grupet e larta të kursimit, 60-100 për qind, për të ardhurat nga emigrantët, ndeshen rreth 22.5 për qind e rasteve. Kjo sjellje e individëve përballë kursimit të këtyre dy llojeve të të ardhurave, është e shpjgueshme, një pjesë e mirë e familjeve që kanë të ardhura nga emigracioni i ruajnë ato si “një rezervë të paprekshme”, brenda familjes. Kjo sjellje varet nga sasia e të ardhurave që këto familje sigurojnë brenda vendit si edhe nga sasia e dërgesave të emigrantëve.

Pyetja 9, kërkon të nxjerrë në pah preferencën e mbajtjes së kursimeve sipas monedhave duke përfshirë edhe monedhën vendase. Ajo lejon më shumë se një zgjedhjeje. Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 98 individë, apo 98 për qind e rasteve të intervistuar, nivel i lartë për të arritur konkluzione.

Tabela 79: Shpërndarja e preferencave për kursim sipas monedhave.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	50.0
Lireta italiane	7.1
Marka gjermane	5.1
Dhrahmia greke	6.1
Leku	50.0
Të tjera	0.0

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi qytetarët e përgjigjur, 98. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Në 18 raste janë deklaruar dy monedha, ku njëra është monedhë e huaj dhe tjetra monedha vendase.

Nga rezultatet **konfirmohet preferenca e qytetarëve për dollarin amerikan dhe lekun për të mbajtur kursimet e tyre**, ndaj monedhave të tjera. Këto monedha qëndrojnë në pothuajse të njëjtat nivele të preferencës.

Pra, sjellja e qytetarëve ndaj llojit të kursimeve parë në syrin e monedhës preferenciale për ta, justifikohet në një masë të caktuar nga siguria që ata duan të kenë si konsumatorë dhe kursimtarë, qoftë në monedhën vendase, ashtu edhe në atë të huaj, në rastin e konkret dollari amerikan.

Pyetja 10, kërkon të marrë dy informacione njëkohësisht:

- së pari, nga ana cilësore, të evidentojë preferencën e qytetarëve përballë depozitave bankare (dëshirojnë apo jo që të vendosin para si depozita bankare);
- së dyti, nga ana sasiore, të japë një vlerësim për masën e këtyre depozitave.

Kjo pyetje lejon vetëm një zgjedhje në intervalet e rradhitura. Niveli i përgjigjeve rezultoi 89 raste apo 89 për qind e totalit të intervistuar.

Tabela 80: Shpërndarja e familjeve sipas niveleve të preferencave për depozita bankare.

Masa e depozitave (në %)	Nr. rastesh	Nr %
0	25	28.1
0-20	33	37.1
20-40	14	15.7
40-60	7	7.9
60-80	5	5.6
80-100	5	5.6
Totali	89	100.0

Vihet re një nivel i konsiderueshëm i rasteve që deklarojnë se nuk kursejnë aspak në formën e depozitave bankare. Ata përbëjnë 28.1 për qind të rasteve të përgjigjura.

Rastet që përgjigjen se kursimet e tyre i vendosin në masa të caktuara pranë bankave si depozita bankare, janë përqëndruar kryesisht në grupimin deri në 40 për qind. Ky grup përbën rreth 73.4 për qind të rasteve që deklarojnë se kanë depozita bankare. Këtu janë përjashtuar qytetarët që deklarojnë se nuk kursejnë aspak (25 të tillë).

Koeficienti mesatar i kursimit si depozita bankare, rezulton rreth 29.7 për qind.

Nga ana cilësore, rezultatet e dala nga kjo pyetje janë deri diku optimiste, sepse në afro 72 për qind të rasteve, qytetarët preferojnë në nivele të ndryshme të ruajnë kursimet e tyre pranë bankave. Nga pikëpamja sasiore,

Pyetja 11, kërkon të dijë arsyen e zgjedhjes në pyetjen paraardhëse.

Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 47 qytetarë, të cilët arsyetojnë se kursimet i vendosin në masa të caktuara në banka.

Tabela 81: Shpërndarja e rasteve sipas arsyes së preferencës për depozita bankare.

Arsyeja	Rastet
Rritje të vlerës së tyre nga interesi	26
Siguri që ofron banka si institucion	23
Besueshmëria që ofron banka si institucion	1
Ruajtja e vlerës së kursimeve në banka	1

Në një rast gjejmë arsyen se "I vendos në bankë për të siguruar studimet e fëmijëve" duke zbuluar idenë e rritjes së gamës së shërbimeve bankare. Në katër raste qytetarët shprehen se "nuk kanë besim të plotë tek bankat", ndaj edhe nuk preferojnë të vendosin kursimet e tyre pranë bankave.

Pyetja 12, kërkon të zbulojë se cili/cilët operator/operatorë preferohen për të kryer këmbime valutore nga ana e qytetarëve. Kjo pyetje lejon vetëm një zgjedhje. Në këtë pyetje u përgjigjën 99 qytetarë (99 për qind). Nga përgjigjet rezultoi se 23.2 për qind e qytetarëve preferojnë të punojnë me banka, 11.1 për qind me zyra këmbimi valutor, 38.4 për qind e tyre me tregun jozyrtar dhe pjesa që mbetet 27.3 për qind i kombinon operatorët.

Në përgjithësi, kombinimi është bankë apo zyra këmbimi valutor me tregun jo zyrtar. Pra, **në total, tregu jozyrtar zë peshën më të lartë në preferencat e qytetarëve për zgjedhjen e operatorëve.**

Pyetja 13, kërkon të identifikojë arsyet e zgjedhjes së mesipërme. U përgjigjën 81 individë apo 82 për qind e atyre që pritej të përgjigjeshin. Ndër arsyet më të spikatura janë:

Tabela 82: Shpërndarja e rasteve sipas arsyes së preferencës për operatorët në këmbimet valutore.

Arsyeja	Rastet
Kurs më i favorshëm	38
Shpejtësi veprimi, lehtësi	13
Garanci nga falsifikimet	17
Siguri	16
Shërbim i mirë dhe serioz	2

Në shumicën e rasteve qytetarët zgjedhin operatorin duke u nisur nga fitimi që ata sigurojnë, apo humbjet minimale që ata pësojnë gjatë veprimeve valutore. Më pas preferohet garancia ndaj rrezikut të parave falso dhe siguria.

Nëse kombinohet pyetja 13 me zgjedhjen e operatorit në pyetjen 12, vërehet se:

- * arsyeja e parë dhe e dytë i përkasin të gjitha zgjedhjeve që janë bërë mbi tregun jo zyrtar;
- * arsyeja e tretë dhe e katërt i përket zgjedhjeve të bëra mbi bankat dhe zyrat e këmbimit valutor.


Pyetja 14, ka për qëllim të mësojë evoluimin e preferencave të qytetarëve për monedhat e huaja nga viti 1999 në vitin 2000.

Tabela 83: Evolucionit i preferencave për monedhat e huaja.

Alternativat	Raste në %	
	1999*	2000**
Dollari amerikan	76.7	80.0
Lireta italiane	12.8	10.6
Marka gjermane	10.5	9.4
Dhrahmia greke	8.1	8.2

Shënim: * përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve (86).

** përqindjet janë llogaritur mbi numrin e të përgjigjurve (85).



Duket qartë që preferencat nuk kanë ndonjë zhvillim të spikatur nga njëri vit në tjetrin. Përgjatë dy viteve **dollari amerikan është më i preferuari**, madje në nivele të larta dhe mjaft i distancuar nga monedhat e tjera nënfisha të euro-s. Ndërkohë, viti 2000, ka shënuar një rritje të lehtë drejt dollarit amerikan me afro 3 pikë përqindjeje dhe valutat e tjera europiane kanë shënuar rënie të lehta (lireta italiane dhe marka gjermane), ndërsa dhrahmia greke ka ruajtur pothuajse të njëjtat nivele preferencash.

V. 3. Çështje të tjera.

Megjithëse pyetësi nuk ka parashikuar një vend të veçantë për komente apo vërejtje të ndryshme, disa prej qytetarëve kanë evidentuar disa të tilla lidhur me kursimet. Kështu këto komente plotësojnë edhe më shumë spektrin e sjelljes së individëve përballë fenomenit të kursimit. Kështu, dallohen rastet në të cilat kursimet investohen dhe rastet që ato mbahen në shtëpi.

* Kursimet investohen në 7 raste duke u specifikuar edhe drejtimet e këtyre investimeve:

- për biznes (riinvestim) 2 raste
- për shtëpinë 3 raste
- për arsimimin e fëmijëve 2 raste

* Kursimet mbahen në shtëpi në 6 raste.

V. 4. Konkluzione.

Qytetarët përbëjnë një tjetër operator të rëndësishëm që vepron në tregun e këmbimeve valutore. Informacionet dhe opinionet e tërhequra prej këtij operatori, në fakt nënvizojnë aspekte të situatës ekonomike të familjeve qytetare të Tiranës. Në një hap të parë analiza përqëndrohet mbi të dhënat e të ardhurave mesatare mujore (në lekë), si edhe në nivelin e kursimit të tyre.

Më pas ajo detajon pjesën e të ardhurave në valutë duke specifikuar një nga burimet më të rëndësishme të tyre, emigracionin.

V. 4. 1. Monedha e huaj më e preferuar.

Ndër monedhat e huaja spikat preferenca për dollarin amerikan. Për më tepër rezultatet tregojnë se kjo preferencë ka fuqizuar pozitën e saj në vitin 2000, krahasuar me vitin 1999. Ndërkohë që nënfishat e euros janë mjaft larg monedhës amerikane, dukë shënuar edhe ulje për periudhën 1999-2000.

Dollari amerikan për qytetarët është monedha më e preferuar, njësoj si edhe leku për të mbajtur kursimet e tyre. Ky aspekt i sjelljes së qytetarëve, gjen bazën logjike në sigurinë që ata dëshirojnë të kenë për kursimet e tyre. Për ta monedha e huaj më e sigurt evidentohet të jetë dollari amerikan.

V. 4. 2. Të ardhurat e familjeve.

Niveli mesatar i të ardhurave në familjet qytetare, vlerësohet të jetë 63.7 mijë lekë. Ndërkohë, 50 për qind e familjeve të intervistuar kanë deri në 50 mijë lekë të ardhura mesatare mujore dhe pjesa tjetër mbi 50 mijë lekë. Mesatarisht një familje mund të kursejë rreth 21.5 për qind të të ardhurave mujore.

Vlerësohet se familjet e intervistuar në pjesën më të madhe të tyre (rreth 70 për qind) kanë të ardhura në valutë dhe monedha, që haset më shpesh në këto të ardhura është dollari amerikan (42.3 për qind), i pasuar nga lireta italiane (29 për qind).

V. 4. 3. Të ardhurat nga emigracioni.

Informacioni i përpunuar nga kjo anketë tregon se burimi kryesor i të ardhurave në valutë është emigracioni (në 61 për qind të familjeve që kanë të ardhura në valutë). Të ardhurat mesatare mujore nga emigrantët për familje luhaten në kufijtë 92 deri 243 dollarë amerikanë. Koeficienti mesatar i kursimit të të ardhurave nga emigracioni rezulton rreth 37 për qind të këtyre të ardhurave.

Profili i dërgesave të emigrantëve sipas monedhave është i strukturuar në favor të monedhave të vendeve fqinje, në lireta italiane dhe dhrahmi greke, përkatësisht 38 për qind dhe 28.6 për qind.

Interesant është fakti se emigracioni është një burim shumë i rëndësishëm i të ardhurave familjare. Nga vrojtimi vlerësohet se ai i rrit këto të fundit në masën 2.3 herë.

V. 4. 4. Të ardhurat dhe kursimet.

Mesatarisht, një familje mund të kursejë rreth 21.5 për qind të të ardhurave mujore. Ndërkohë, koeficienti mesatar i kursimit të të ardhurave nga emigracioni rezulton rreth 37 për qind të këtyre të ardhurave. Kurse rreth 12.5 për qind e familjeve nuk mund të kursejnë aspak prej të ardhurave nga emigracioni, duke i konsideruar ato si burim të domosdoshëm jetik.

Qytetarët kanë një preferencë mesatare për vendosjen e kursimeve të tyre pranë depozitave bankare. Rreth 73.4 për qind e tyre preferojnë të vendosin deri në 40 për qind të kursimeve të tyre pranë depozitave bankare.

Si përfundim, mund të konkludohet se, monedha e huaj më e preferuar për qytetarët është dollari amerikan. Ai ka fuqizuar pozitën e tij nga viti 1999 në vitin 2000. Po kështu, nga aspekti i kursimeve sipas llojit të monedhës, dollari amerikan dhe leku kanë pozitat dominuese në preferencat e qytetarëve.

Pyetësi për qytetarët.

Pyetja 1. Sa i vlerësoni të ardhurat totale mesatare mujore në familjen tuaj?
(Në lekë)_____

Pyetja 2. Sa për qind të tyre kurseni? (Zgjidhni një nga variantet e mëposhtme që ju mendoni se kurseni.)

0	1
0-20	2
20-40	3
40-60	4
60-80	5
80-100	6

Pyetja 3. A keni të ardhura në valutë?

Po	1
Jo	2

Pyetja 4. Nëse Po, në cilën monedhë i keni ato? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmi greke	4	
Të tjera	5	Specifikoni:_____!_!

Pyetja 5. Nëse jeni përgjigjur Po në pyetjen 3, a keni të ardhura nga emigrantët?

Po	1
Jo	2

Pyetja 6. Nëse Po, në cilën monedhë i keni ato? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1
Lireta italiane	2
Marka gjermane	3
Dhrahmi greke	4

Të tjera 5 Specifikoni: _____!_!

Pyetja 7. Cila është shuma mesatare mujore e të ardhurave nga emigrantët?
_____.

Pyetja 8. Sa për qind të tyre (totalit të të ardhurave nga emigrantët) kurseni?
(Zgjidhni vetëm një nga nivelet e mëposhtme që ju mendoni se kurseni.)

0	1
0-20	2
20-40	3
40-60	4
60-80	5
80-100	6

Pyetja 9. Në ç'monedhë preferoni të mbani kursimet tuaja? (Mund të zgjidhni më shumë se një mundësi.)

Dollarë amerikanë	1	
Lireta italiane	2	
Marka gjermane	3	
Dhrahmi greke	4	
Lekë	5	
Të tjera	6	Specifikoni: _____!_!

Pyetja 10. Kursimet tuaja i ruani si depozita bankare në masën? (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

0	1
0-20	2
20-40	3
40-60	4
60-80	5
80-100	6

Pyetja 11. Jepni arsyen e zgjedhjes në pyetjen 10.

_____ !_!

Pyetja 12. Preferoni të këmbeni paratë tuaja: (Zgjidhni vetëm një mundësi.)

Në bankë?	1
Në ZKV?	2
Në tregun informal (kambistë të lirë)?	3
Kombinim i varianteve të mësipërme?	4

Pyetja 13. Jepni arsyen e zgjedhjes në pyetjen 12.

!_!

Pyetja 14. Cila është valuta me të cilën keni preferuar të operoni dhe preferoni aktualisht të operoni më shpesh? (Për secilin moment kohor mund të zgjidhni më shumë se një nga valutat e mëposhtme.)

viti 1999

viti 2000

Dollari amerikan 1
Lireta italiane 2
Marka gjermane 3
Dhrahmia greke 4

Dollari amerikan 1
Lireta italiane 2
Marka gjermane 3
Dhrahmia greke 4

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

KAPITULLI VI: KONKLUZIONE DHE PROBLEME

Në këtë pjesë të analizës, janë përmbledhur rezultatet që kanë të bëjnë me pyetjet e përbashkëta në të gjithë pyetëtorët, apo pyetjet e njëjta, drejtuar të gjitha grupeve të intervistuar në këtë vërtetim. Problemet më të shumta të përbashkëta, evidentohen në grupin e bankave, të zyrave të këmbimit valutor të kambistëve dhe të bizneseve. Ndërkohë që, grupi i qytetarëve ndeshet rrallë me elemente të tilla për vetë natyrën e pyetësorit, i cili i hartuar enkas për këtë grup, është pak i ngarkuar me pyetje teknike.

VI. 1. Gjeografia e transaksioneve

Informacioni mbi gjeografinë e transaksioneve është i pranishëm në pyetëtorin e bankave, të zyrave dhe të bizneseve³¹. Në këtë pyetje pati 168 të intervistuar të përgjigjur për të gjitha grupet e lartpërmendura, apo u përgjigjën 100 për qind e tyre. Nga përpunimi i saj, ashtu siç edhe pritej, del në pah **se peshën kryesore në transaksionet e kryera nga këto grupe e zë Italia dhe Greqia**, ndërsa e treta renditet Gjermania. Nga përgjigjet e marra vërehet që struktura e shteteve me të cilat kryhen transaksione përputhet me modelin e partnerëve kryesorë tregtarë të Shqipërisë.

Tabela 84: Shpërndarja e transaksioneve sipas shteteve.

Shteti	Përgjigjet (në %)*
Italia	44.8
Greqia	24.4
Turqia	5.3
Gjermania	11.3
Bullgaria	2.4
Maqedonia	4.2
Të tjera	8.3

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve, 168. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

VI. 2. Qëndrimi ndaj monedhave të huaja

VI. 2. 1. Monedha më e preferuar në përdorim.

Një element i rëndësishëm i analizës së këtij vërtimi është edhe niveli i preferencës së përdorimit të monedhave të ndryshme, problem që është eksploruar në grupin e bankave, të zyrave, të kambistëve dhe të bizneseve³². Në këtë pyetje u përgjigjën 218 të intervistuar, apo 100 për qind e tyre. Monedhat e huaja më të preferuara në përdorim janë dollari amerikan, lireta italiane dhe dhrahmia greke. Vihet re se, ndërsa gjeografia e transaksioneve tenton drejt

³¹ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetëtorin për bankat, pyetja 1; në pyetëtorin për zyrat, pyetja 1; në pyetëtorin për bizneset, pyetja 2.

³² Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetëtorin për bankat, pyetja 2; në pyetëtorin për zyrat, pyetja 2; në pyetëtorin për kambistët, pyetja 3; në pyetëtorin për bizneset, pyetja 3.

Italisë dhe Greqisë, monedha mbizotëruese për t'i kryer këto të fundit është **dollari amerikan**. Madje ai **vlerësohet të jetë dy herë më shumë i preferuar se lireta italiane në kryerjen e transaksioneve**.

Tabela 85: Shkalla e përdorimit të monedhave me të cilat kryhen transaksionet valutore.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	67.8
Lireta italiane	33.0
Marka gjermane	17.0
Dhrahmia greke	24.8
Të tjera	3.6

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve, 218. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Krahasuar me mesataren e përdorimit të nënfishave të euros, nga rezultatet e përbashkëta për grupet e lartpërmendura, rezulton se dollari amerikan ka një shpeshësi rreth 2.7 herë më të lartë se çdonjeri prej tyre mesatarisht, në kryerjen e transaksioneve valutore.

VI. 2. 2. Vlerësimi për monedhat e huaja më të qëndrueshme tek ne dhe për ato që kanë vlera orientuese në procesin e vendimmarrjes.

Në pyetësorët për bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset janë dhënë opinione edhe mbi nivelin e qëndrueshmërisë së monedhave të huaja dhe të aftësisë orientuese të tyre në aktivitetin përkatës të grupeve të lartpërmendura³³. Në këto pyetje u përgjigjën 218 të intervistuar apo 100 për qind e tyre.

Tabela 86: Shpërndarja e përgjigjeve sipas monedhave të qëndrueshme dhe orientuese.

Monedhat	Përgjigjet në (%)*	
	E qëndrueshme	Orientuese
Dollari amerikan	86.2	70.6
Lireta italiane	3.2	12.4
Marka gjermane	7.7	11.0
Dhrahmia greke	3.7	8.7
Të tjera	0.9	0.0

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigjurve, 218. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Dollari amerikan evidentohet si monedha më e qëndrueshme dhe njëkohësisht orientuese në procesin e vendimmarrjes për grupet e lartpërmendura. Madje, si i tillë ai kap vlera shumë të larta dhe mjaft të distancuara nga monedhat e tjera.

³³ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetjet 7 dhe 8; në pyetësorin për zyrat, pyetjet 7 dhe 9; në pyetësorin për kambistët, pyetjet 10 dhe 12; në pyetësorin për bizneset, pyetjet 9 dhe 11.

Nënfishat e euros konsiderohen pak të qëndrueshëm, krahasuar me dollarin.

Krahasuar me shkallën e qëndrueshmërisë, vërehet se nënfishat e euros luajnë një rol më të madh në aspektin e orientimit në aktivitetin e grupeve të intervistuar, ndonëse edhe në këtë pikë, ato qëndrojnë ende larg dollarit amerikan.

VI. 2. 3. Vlerësimi i ecurisë së preferencës për monedhat e huaja.

Për vitet 1999 dhe 2000, të gjithë të intervistuarit në këtë vrojtim kanë dhënë mendimin e tyre për preferencat ndaj monedhave të huaja³⁴. Për secilin moment kohor (vit) janë përgjigjur përkatësisht 94 dhe 94.3 për qind e tërësisë së mësipërme (318).

Tabela 87: Evolucionin e preferencës për monedhat e huaja.

Monedhat	Viti 1999*	Viti 2000**	Ndryshimi (në pikë përqindje)
Dollari amerikan	63.5	66.3	+2.8
Lireta italiane	19.0	17.7	-1.3
Marka gjermane	11.3	11.0	-0.3
Dhrahmia greke	13.3	12.7	-0.6

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigurve, 299. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

** Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigurve, 300. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

Vërehet se në tërësinë e të intervistuarve, **preferenca për monedhën amerikane është shumë më e lartë se për monedhat e tjera**. Ky është një fakt që spikat dukshëm për të dy vitet. Ndërkohë edhe ecuria e preferencave për monedhat e huaja gjatë viteve 1999-2000, qëndron në favor të dollarit amerikan.

Ky konkluzion i vrojtimit përputhet edhe me realitetin e ecurisë së valutave në tregun valutor. Kështu, periudha 1999-2000 është karakterizuar nga një nënçmim i euros, gjë që ka shkaktuar edhe orientimin e preferencave drejt monedhës amerikane.

VI. 2. 4. Monedha me të cilën banka qendrore duhet të kryejë transaksionet e shit-blerjeve valutore.

U përgjigjën 218 të intervistuarit nga tërësia e bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve, pra 100 për qind e kësaj tërësie³⁵. Nga përpunimi i përgjigjeve **evidentohet dollari amerikan si monedha më e përshtatshme për kryerjen e shit-blerjeve valutore nga ana e bankës qendrore**. Për më tepër kjo monedhë

³⁴ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 15; në pyetësorin për zyrat, pyetja 15; në pyetësorin për kambistët, pyetja 19; në pyetësorin për bizneset, pyetja 18; në pyetësorin për qytetarët, pyetja 14.

³⁵ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 22; në pyetësorin për zyrat, pyetja 23; në pyetësorin për kambistët, pyetja 26; në pyetësorin për bizneset, pyetja 25.

qëndron në një pozicion shumë superior krahasuar me monedhat e tjera, nënfisha të euros.

Tabela 88: Shpërndarja e përgjigjeve sipas monedhës/ave më të përshtatshme për të kryer shit-blerjet valutore.

Monedha	Përgjigjet (në %)*
Dollari amerikan	85.8
Lireta italiane	3.7
Marka gjermane	9.6
Dhrahmia greke	4.1

Shënim: *Përqindjet janë llogaritur mbi totalin e të përgjigurve, 218. Shuma nuk mund të rezultojë 100 për qind, për arsye se pyetja lejon zgjedhjen e më shumë se një varianti.

VI. 3. Preferenca ndaj operatorit për kryerjen e këmbimeve valutore.

Preferenca për operatorin e kryerjes së këmbimeve valutore, është element i përbashkët që ndeshet në të gjitha grupet e intervistuar të vrojtimit³⁶. Në këtë pyetje janë përgjigjur 315 të intervistuar, apo rreth 99.1 për qind e totalit. Nga përpunimi i përgjigjeve për këtë pyetje, rezultoi se **operatori më i preferuar është tregu jozyrtar** duke zënë rreth 38.7 për qind të preferencave në total. Bankat preferohen në masën 21.5 për qind, ndërsa zyrat rreth 10 pikë përqindjeje më pak se bankat (11.3 për qind). Kombinimi i operatorëve të mësipërm është një variant i preferueshëm në masën 28.5 për qind. Shpesh në rastet kur elementet e kombinimit janë specifikuar qartë, ka dalë se njëri prej operatorëve të kombinuar është tregu jozyrtar, pra në total vlerësohet se ky i fundit është akoma më i preferuar, se operatorët e tjerë.

Preferenca për tregun jozyrtar krahasuar me atë zyrtar (bankat dhe zyrat së bashku), qëndron rreth 6 pikë përqindjeje më lart.

Analiza e vrojtimit nënvizon tiparet dalluese, të cilat e bëjnë këtë treg më të preferuarin për kryerjen e këmbimeve valutore. Ndër to më të spikaturat janë:

- kosto më e ulët që ky treg u ofron operatorëve në këmbime valutore (leverdia ekonomike);
- shpejtësia e veprimit në këtë treg (kursim kohe);
- likuiditeti më lartë që ofron ky treg.

³⁶Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 5; në pyetësorin për zyrat, pyetja 5; në pyetësorin për kambistët, pyetja 8; në pyetësorin për bizneset, pyetja 7; në pyetësorin për qytetarët, pyetja 12.

VI. 4. Tregu jozyrtar i këmbimeve valutore.

VI. 4. 1. Nevoja për praninë e tregut jozyrtar krahas atij zyrtar.

A është apo jo i nevojshëm tregu jozyrtar i këmbimeve valutore? Për këtë problem kanë dhënë opinionin e tyre bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset³⁷. 218 të intervistuarit iu përgjigjën kësaj pyetjeje me natyrë delikate. **Rreth 67 për qind e tyre janë pro nevojës së ekzistencës së këtij tregu**, 15.1 për qind e tyre kundërshtojnë praninë e tij krahas tregut zyrtar të këmbimeve valutore dhe pjesa tjetër (17.9 për qind), kanë preferuar të mos shfaqin opinionin e tyre.

VI. 4. 2. Kursi i këmbimit në tregun jozyrtar.

Bashkësia e bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve kanë dhënë mendimet e tyre lidhur me mekanizmin e vendosjes së kursit të këmbimit në tregun jozyrtar³⁸. Numri total i të përgjigjurve në këtë pyetje rezultoi në 159 apo rreth 73 për qind e atyre që pritej t'i përgjigjeshin kësaj pyetjeje.

Duke përmbledhur rezultatet e këtij grupi të intervistuarish, do të veçonim si **elementin më të rëndësishëm të këtij mekanizmi, ecurinë e kursit në tregjet ndërkombëtare, për të cilin shprehen 69.2 për qind e të intervistuarve**. Ndërkohë që, element tjetër i rëndësishëm në vendosjen e kursit të këmbimit, konsiderohen edhe raportet që vendosen midis kërkesës dhe ofertës për valutë në këtë treg. Për këtë faktor janë shprehur rreth 20.1 për qind e të intervistuarve të përgjigjur. Faktorët e tjerë kanë peshë të përafërta, rreth 3 për qind.

VI. 4. 3. Evolucioni i vëllimit të transaksioneve të kryera në tregun jozyrtar në krahasim me vëllimin e tyre të kryer në banka.

Gjatë dy viteve të fundit 1999 dhe 2000, është vlerësuar nga grupi i bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve se si ka qenë ecuria e raportit të operatorëve jozyrtar të krahasuar me bankat³⁹. Për dy vitet përkatësisht janë përgjigjur 99.5 dhe 99.1 për qind e të intervistuarve.

Tabela 89: Evolucioni i vëllimit të transaksioneve në tregun jozyrtar në raport me vëllimin e tyre në banka.

Vlerësimi	Viti 1999	Viti 2000	Ndryshimi (në pikë për qindje)
Më i madh	28.6	29.6	+1
Më i vogël	27.6	29.6	+2
Nuk ka ndryshuar	19.4	16.3	-3.1
Nuk e di	24.4	24.4	0.0

³⁷Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 9; në pyetësorin për zyrat, pyetja 10; në pyetësorin për kambistët, pyetja 13; në pyetësorin për bizneset, pyetja 12.

³⁸Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 11; në pyetësorin për zyrat, pyetja 12; në pyetësorin për kambistët, pyetja 15; në pyetësorin për bizneset, pyetja 14.

³⁹Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetjet 12 dhe 13; në pyetësorin për zyrat, pyetjet 13 dhe 14; në pyetësorin për kambistët, pyetjet 16 dhe 17; në pyetësorin për bizneset, pyetjet 15 dhe 16.

Nga të dhënat e tabelës vërehet në tërësi, një situatë pothuajse e qëndrueshme, pa ndryshime të spikatura strukturore në kryerjen e transaksioneve valutore në tregun jozyrtar krahasuar me ato të kryera pranë bankave. Vërehet një tendencë shumë e lehtë në uljen e aktivitetit të tregut jozyrtar me rreth 1 pikë përqindje, krahasuar me bankat, por ky ndryshim paraqitet krejtësisht i papërfillshëm, ose ndoshta i rastësishëm, kur kemi parasysh, dominimin në tërësi të preferencës për këtë treg nga grupet e intervistuar.

Fakti që bankat ende nuk kanë predominuar dukshëm tregun jozyrtar është një sinjal jo i këndshëm për tërësinë e aktivitetit të tyre. Është tregu jozyrtar që pengon zhvillimin me ritme të shpejta të tregut ndërbankar.

VI. 5. Aktiviteti i zyrave të këmbimit valutor.

Në periudhën 1999-2000, lidhur me vëllimin e transaksioneve që zyrat kanë kryer, janë pyetur tërësia e bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve⁴⁰. Për dy momentet kohore të mësipërme janë përgjigjur përkatësisht 98.6 dhe 97.3 për qind e tërësisë.

Tabela 90: Evolucioni i vëllimit të transaksioneve të kryera nga zyrat e këmbimit valutor.

Vlerësimi	Viti 1999	Viti 2000	Ndryshimi (në pikë përqindje)
Në rritje	49.3	50.0	+0.7
Në rënie	13.0	14.2	+1.2
Nuk ka ndryshuar	16.3	14.2	-2.1
Nuk e di	21.4	21.7	+0.3

Kolona e fundit e tabelës dëshmon për ekzistencën e një opinioni që deri diku mbështet ecurinë në përkeqësim të aktivitetit të zyrave të këmbimit valutor (rënia e aktivitetit të tyre vlerësohet të jetë me rreth 0.5 pikë përqindje më e lartë se sa rritja e aktivitetit të tyre valutor) për periudhën 1999-2000, pikë të cilat mbeten të jenë më shumë në favor të tregut jozyrtar të këmbimeve valutore.

VI. 6. Regjimi i kursit të këmbimit dhe politika valutore e Bankës së Shqipërisë.

VI. 6. 1. Opinione lidhur me përshtatshmërinë e regjimit aktual të kursit të këmbimit.

Mbi përshtatshmërinë e regjimit aktual të kursit të këmbimit u intervistuan bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset⁴¹. Pranuan të përgjigjen 216 të intervistuar apo afro 99.1 për qind e kësaj tërësie. **39.4 për qind e të intervistuarve u shprehën pro,**

⁴⁰Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësin për bankat, pyetja 14; në pyetësin për zyrat, pyetja 15; në pyetësin për kambistët, pyetja 18; në pyetësin për bizneset, pyetja 17.

⁴¹Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësin për bankat, pyetja 16; në pyetësin për zyrat, pyetja 17; në pyetësin për kambistët, pyetja 20; në pyetësin për bizneset, pyetja 19.

regjimit aktual të kursit të këmbimit, ndërsa 23.1 për qind e kundërshtuan këtë regjim. Pjesa e të intervistuarve që nuk shprehën opinion rezulton të jetë e lartë 37.5 për qind, fakt që ndoshta, mund të lidhet edhe me mosnjohjen e kuptimit të regjimit të kursit të këmbimit nga ana e të intervistuarve.

VI. 6. 2. Përshtatshmëria e zgjedhjes së momentit kohor të kryerjes së shit-blerjeve valutore nga ana e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor.

A vepron në momentin e duhur banka qendrore në tregun valutor për të shmangur spekulimet? Janë bankat, zyrat, kambistët dhe bizneset që i përgjigjen kësaj pyetjeje⁴². Kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 100 për qind e të intervistuarve (218) dhe nga përgjigjet rezultoi se, **32.1 për qind e këtij grupi i vlerësojnë të përshtatshme këto veprime të bankës qendrore**, ndërsa 23.9 për qind e tij janë kundër këtyre veprimeve. Edhe në këtë pyetje pjesa e të intervistuarve që nuk kanë dhënë opinionin e tyre, vlerësohet të jetë e lartë, 44 për qind e totalit të këtij grupi.

VI. 6. 3. A e përmbush banka qendrore qëllimin e saj me anë të shit-blerjeve valutore që kryen?

217 të intervistuar apo 99.6 për qind e grupit të bankave, të zyrave, të kambistëve dhe të bizneseve janë përgjigjur në këtë pyetje⁴³. Ndër ta **39.6 për qind janë të mendimit se Banka e Shqipërisë ia arrin qëllimit**, 14.3 për qind mendojnë të kundërtën dhe 46.1 për qind nuk japin opinionin e tyre.

VI. 6. 4. Cili duhet të jetë qëllimi i kryerjes së këtyre shit-blerjeve nga ana e Bankës së Shqipërisë?

Ky është një problem për të cilin kanë dhënë opinionet e tyre 100 për qind e të intervistuarve në grupin e bankave, zyrave, kambistëve dhe bizneseve⁴⁴.

Opinionin e grupit të mësipërm është i konsoliduar në idenë se banka qendrore **duhet të veprojë për të mbajtur një kurs këmbimi sa më të stabilizuar** (76.1 për qind e tyre).

Ndërkohë që 5.5 për qind e tyre shprehën se banka qendrore duhet të veprojë në treg për zhvlerësim dhe 6.9 për qind për vlerësim, dy tendenca që pothuajse eliminojnë njëra-tjetën. Pjesa e mbetur e të intervistuarve, (11.5 për qind) nuk ka shprehur opinion rreth këtij problemi.

⁴²Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 18; në pyetësorin për zyrat, pyetja 19; në pyetësorin për kambistët, pyetja 22; në pyetësorin për bizneset, pyetja 21.

⁴³Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 20; në pyetësorin për zyrat, pyetja 21; në pyetësorin për kambistët, pyetja 24; në pyetësorin për bizneset, pyetja 23.

⁴⁴ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 23; në pyetësorin për zyrat, pyetja 24; në pyetësorin për kambistët, pyetja 27; në pyetësorin për bizneset, pyetja 26.

VI. 7. Opinioni mbi euron.

Nivelin e fuqizimit të euros, përgjatë periudhës 1999-2000, e vlerësojnë 218 të intervistuarit⁴⁵ dhe nga përpunimi i tërësisë së pyetësorëve të mësipërm rezultoi se:

- **monedha europiane në 65.6 për qind të rasteve nuk ka fuqizuar pozicionin e saj në vitin 2000 krahasuar me një vit më parë.** Ky fakt përputhet me të gjitha përfundimet e dala në favor të dukshëm lidhur me qëndrueshmërinë, forcën orientuese, shkallën dhe preferencën e përdorimit të monedhës amerikane, krahasuar me monedhat e tjera (nëfishat e euros);
- opinionin se euro ka fuqizuar pozitën e saj në vitin 2000 krahasuar me vitin 1999, e mbështesin vetëm 15.1 për qind e tërësisë;
- 4.1 për qind mendojnë se nuk ka patur ndryshime të pozitës së saj;
- 15.1 për qind nuk e dinë nëse ajo ka fuqizuar apo dobësuar pozitën e saj në tregun tonë të këmbimeve valutore.

Do të konkludonim se në Shqipëri, ndër monedhat e huaja, më e preferuara në përdorim dhe që njëkohësisht gëzon qëndrueshmëri dhe aftësi orientuese në vendimmarrje, evidentohet dukshëm të jetë dollari amerikan, ndërsa euro përgjatë periudhës 1999-2000 nuk e ka fuqizuar pozitën e saj.

Tërësia e analizës së këtij vrojtimi si edhe konkluzionet e nxjerra, evidentojnë disa **probleme**, të cilat duhen vlerësuar për të reflektuar përmirësime dhe përsosje në procesin e analizave të ardhshme.

Së pari, gjatë konkluzioneve përfundimtare u përpunuan të dhënat e të gjithë operatorëve të tregut, të cilët kanë dhënë opinionet e tyre rreth pyetjeve të drejtuara. Do të theksonim se, megjithëse struktura e zgjedhjes është në favor të bizneseve, kambistëve dhe qytetarëve, opinionet e operatorëve zyrtarë të tregut valutor (banka dhe zyra të këmbimit valutor), konsiderohen më cilësore nga pikëpamja profesionale dhe si të tilla marrin një rëndësi të veçantë.

Së dyti, për të siguruar vijueshmëri të analizës dhe për të kuptuar ndryshimin e tregut të brendshëm valutor nga njëri vit në tjetrin, vrojtimi ka nevojë të përsëritet, për të parë zhvillimet e tij gjatë vitit 2001, nën dritën e forcimit relativ të euros si edhe ndikimet e pritshme në këtë treg nga prania fizike e euros në vitin 2002. Përsëritja e vrojtimit në mënyrë të domosdoshme duhet të reflektojë edhe përmirësime që kanë të bëjnë me:

⁴⁵ Sipas pyetësorëve pyetjet korresponduese janë: në pyetësorin për bankat, pyetja 24; në pyetësorin për zyrat, pyetja 25; në pyetësorin për kambistët, pyetja 28; në pyetësorin për bizneset, pyetja 27.

- shtrirjen më të gjerë gjeografike të tij (kryesisht për grupin e bizneseve dhe të qytetarëve);
- hartimin e pyetësorëve, në të cilët disa nga pyetjet duhet të jenë më të qarta dhe precize, si edhe eliminimin në maksimum të pyetjeve që kërkojnë komente dhe dhënie arsyesh (me përgjigje të hapura).

Së treti, konkluzionet janë të vlefshme për të kuptuar sjelljen e operatorëve në mjedisin e tregut valutor si edhe lidhjen e fortë që ata kanë me monedhën amerikane.

Së katërti, rëndësi të veçantë në analizë merr edhe vlerësimi i tregut jozyrtar të këmbimeve valutore, përmasat si edhe karakteristikat kryesore të organizimit dhe funksionimit të tij. Do të theksojmë se megjithëse ai është një treg i paligjshëm, reduktimi i tij duhet bërë me kujdes, në bazë të një strategjie të studiuar dhe graduale. Nuk jemi të mendimit që të shkohet drejt eliminimit të tij me masa administrative dhe të menjëherëshme. Gjykojmë se, më e përshtatshme do të ishte ulja e efikasitetit këtij tregu nëpërmjet marrjes së masave për zbehjen në maksimum të nevojës ekonomike për të.

Së pesti, vërtetimi thekson në mënyrë të qartë, nevojën e një transparence më të madhe që Banka e Shqipërisë duhet të ketë përballë publikut, si edhe rritjen e rolit të saj edukues për probleme të rëndësishme të politikës që ajo ndjek dhe zbaton në përgjithësi dhe të politikës valutore në veçanti.